



# Kuvendi Komunal Gjilan


Municipal Assembly Gjilan

## Plani zhvillimor Urban i Gjilanit

### Urban Development Plan of Gjilan

2006 - 2015+

Drafti Final 07. 07. 2008



DREJTORIA PËR URBANIZËM, RINDËRTIM DHE AMBIENT THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT



Instituti i shkencës dhe teknologjisë  
Institute of science and technology



HessenAgentur

H.A. Hessen Agentur GmbH



INSTITUT WOHNEN UND UMWELT GmbH  
- Institute for Housing and Environment -

planungsgruppe 4





## **Deklaratë e Partneritetit**

Prishtinë, Maj 2008

### **Plani Zhvillimor Urban i Gjilanit 2006 -2015+**

Plani është hartuar bazuar në Ligjin e Planifikimit Hapësinorë dhe Urdhëresave Administrative të lëshuara nga MMPH, të dhënat dhe informacionet nga Drejtoritë e Kuvendit Komunal të Gjilanit, vizionin dhe strategjinë e Kuvendit Komunal të Gjilanit si dhe punën profesionale të ekspertëve nga partneriteti: Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë; Hessen Agentur Stadtentwicklungs-gesellschaft mbH, Wiesbaden; Institut Wohnen und Umwelt, Darmstadt dhe Planungsgruppe P4, Berlin.

Hartimi i planeve është bërë nën udhëheqjen e Institutit të Shkencës dhe Teknologjisë me mbikëqyrjen dhe menaxhimin nga Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient e komunës së Gjilanit.

Partneriteti, nën udhëheqjen e Institutit të Shkencës dhe Teknologjisë Prishtinë, obligohet që të japë sqarime dhe komente për planet si dhe të mbështes Komunën me këshillime profesionale për planet me qëllim të implementimit të këtij dokumenti.

Përfaqësuesi i Partneritetit

Shkëlzen Qorraj, Mr. Sc. Inxh  
Udhëheqës i projektit



**Republika e Kosovës  
Kuvendi Komunal Gjilan**

Prishtinë, Maj. 2008

**Deklaratë e pjesëmarrjes në hartimin e Planit Zhvillimor Urban të Gjilanit 2006-20015+**

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë (INTECH), Prishtinë është pjesëmarrës në hartimin e Planit Zhvillimor Urban të Gjilanit.

Projekti është hartuar, bazuar në Ligjin e Planifikimit Hapësinorë dhe Urdhëresave Administrative të lëshuara nga MMPH, dhe në partneritetit me Hessen Agentur Stadtentwicklungs-gesellschaft mbH, Wiesbaden; Institut Wohnen und Umwelt, Darmstadt dhe Planungsgruppe P4, Berlin.

Në hartimin e planit të sipërpërmendur nga Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë, kanë marrë pjesë aktive:

Prof. Dr. Isuf Krasniqi, inxhi. i dipl. i elektroteknikës,

Mr.sc. Shkëlzen Qorraj, inxhi. i dipl. i ndërtimtarisë,

Mr.sc. Driton Lleshi, inxhi. i dipl. i arkitekturës,

Bardh Hoxha, inxhi. i dipl. i elektroteknikës,

Lindita Rexhbeqaj, inxhi. i dipl. i arkitekturës,

Blertha Vula, inxhi. i dipl. i arkitekturës,

Edita Bunjaku, inxhi. i dipl. i arkitekturës,

Milot Qorraj, inxhi. i ndërtimtarisë.

Në hartimin e këtij projekti, kanë marrë pjesë edhe një numër i madh bashkëpunëtorëve të INTECH-ut. Aktiviteti i tyre ka qenë i pjesërishëm dhe për pjesë të caktuara të këtij dokumenti.

Me respekt,

Drejtori i Institutit

Prof. Dr. Isuf Krasniqi



HA Hessen Agentur GmbH - Abraham-Lincoln-Str. 38-42 - 65189 Wiesbaden

Abraham-Lincoln-Str. 38-42  
65189 Wiesbaden  
Tel. (0611) 774-81  
www.hessen-agentur.de

Ansprechpartner/in:  
Herr Schwarting  
Tel. (0611) 77 48-331  
Fax (0611) 7 74 58-331  
E-Mail:  
henning.schwarting@hessen-  
agentur.de

Wiesbaden, 6. Mai 2008

Kommune Gjilan

## Bestätigung der Mitwirkung am Projekt Municipal Development Plan und Urban Development Plan Gjilan

Sehr geehrte Damen und Herren,

hiermit bestätigen wir die Mitwirkung der Hessen Agentur an der Erstellung des Municipal Development Plan und des Urban Development Plan Gjilan. Die Projektbearbeitung erfolgte im Rahmen eines Konsortiums bestehend aus dem Instituti për Shkencë dhe Teknologjik (INTECH), dem Institut Wohnen und Umwelt (IWU) und der Planungsgruppe 4 Berlin (P4).

Die vorgelegte Planung entspricht den Vorgaben des Law on Spatial Planning für das Kosovo, den damit verbundenen Administrative Guidelines zu den Artikeln 13 und 14 des Law on Spatial Planning sowie dem Stand von Wissenschaft und Technik des Planungswesens in Europa.

Bei der Erstellung haben die folgenden Personen mitgewirkt:

Name: Herr Friedhelm Flug  
Position: Abteilungsleiter / Geschäftsführer HA Stadtentwicklungsgesellschaft  
Titel / Beruf: Bauassessor Städtebau, Dipl.-Ing. Stadt- und Regionalplanung, Stadtplaner AKH

Name: Herr Henning Schwarting  
Position: Projektleiter  
Titel / Beruf: Dipl.-Ing. Raum- und Umweltplanung, Stadtplaner AKH

Name: Herr Heiko Körner  
Position: Sachbearbeiter  
Titel / Beruf: Dipl.-Ing. Raum- und Umweltplanung

Mit freundlichen Grüßen

HA Hessen Agentur GmbH  
ppa.

i.V.

Anja Gauler

Henning Schwarting

**An Hessen führt kein Weg vorbei.**

Geschäftsführer:  
Martin H. Herkströter  
Dr. Dieter Kreuziger

Aufsichtsratsvorsitzender:  
Dr. Alois Rhiel

Sitz der Gesellschaft:  
Wiesbaden  
Amtsgericht Wiesbaden  
HRB 21418  
Ust.-IdNr. DE237911160  
Steuernr. 26 40235 03634

Nassauische Sparkasse  
Wiesbaden  
Kto.-Nr. 100 015 730  
BLZ 510 500 15  
IBAN: DE85 5105 0015 0100 0157 30  
BIC: NASSDE55XXX

SEB AG  
Wiesbaden  
Kto.-Nr. 10 191 999 00  
BLZ 510 101 11  
IBAN: DE97 5101 0111 1019 1999 00  
BIC: ESSEDE5F510

Municipality of Gjilan  
Republic of Kosova

INSTITUT WOHNEN  
UND UMWELT GmbH

Forschungseinrichtung  
des Landes Hessen und  
der Stadt Darmstadt

Annastraße 15  
64285 Darmstadt  
Tel. +49(0)6151/2904-0  
Fax: +49(0)6151/290497

Darmstadt, 07.05.2008

RG / Durchwahl: -51

info@iwu.de  
www.iwu.de

**Certification of Participation in the Joint Work on the Municipal Development Plan  
and Urban Development Plan of Gjilan**

*To whom it may concern*

We herewith certify that the Institut Wohnen und Umwelt GmbH, Darmstadt, participated in the work on the Municipal Development Plan and the Urban Development Plan of Gjilan. The work on the project was done jointly by the consortium consisting of Instituti për Shkencë dhe Teknologjik (INTECH), Prishtina, of HessenAgentur, Wiesbaden, of Planungsgruppe 4 (P4), Berlin, and Institut Wohnen und Umwelt (IWU), Darmstadt.

The planning documents submitted comply with the stipulations of the Law on Spatial Planning for Kosova, with the thereof dependent Administrative Guidelines related to Articles 13 and 14 of that law and with the state of the art of spatial planning in Europe.

The following members of our staff were involved in the work:

Dr. Rainer Greiff, Dipl.-Ing, architect and urban planner,  
Dr. Heinz Sautter, economist

Mit freundlichen Grüßen  
INSTITUT WOHNEN UND UMWELT GmbH



Prof. Dr. Dieter Rebitzer  
General Manager



Kommune Gjilan

Berlin, den 07.05.2008

**Bestätigung der Mitwirkung am Projekt Municipal Development Plan  
und Urban Development Plan Gjilan**

Sehr geehrte Damen und Herren,

hiermit bestätigen wir die Mitwirkung der Planungsgruppe 4 GmbH an der Erstellung des Municipal Development Plan und des Urban Development Plan Gjilan. Die Projektbearbeitung erfolgte im Rahmen eines Konsortiums bestehend aus dem Instituti për Shkencë dhe Teknologjik (INTECH), dem Institut Wohnen und Umwelt (IWU) und der Hessen Agentur.

Die vorgelegte Planung entspricht den Vorgaben des Law on Spatial Planning für das Kosovo, den damit verbundenen Administrative Guidelines zu den Artikeln 13 und 14 des Law on Spatial Planning sowie dem Stand von Wissenschaft und Technik des Planungswesens in Europa.

Bei der Erstellung haben die folgenden Personen mitgewirkt:

Name: Paul Lösse  
Position: Geschäftsführer  
Titel / Beruf: Dipl.-Ing. Architekt und Stadtplaner SRL

Name: Herr Christoffer Borin  
Position: Projektleiter  
Titel / Beruf: Tek. Mag. Stadtplanung

Name: Frau Arta Idrizi  
Position: Mitarbeiterin  
Titel / Beruf: Dipl.-Ing. Stadt- und Regionalplanung

Mit freundlichen Grüßen

(Dipl.-Ing. P. M. Lösse)  
Planungsgruppe 4 GmbH

Planungsgruppe 4 GmbH  
Architekten & Stadtplaner

Berlin • Frankfurt • Moskau • Almaty

Joachim-Friedrich-Stralle 37  
D-10711 Berlin  
Fon +49 30 896 80 80  
Fax +49 30 891 68 68  
p4@p4berlin.de  
www.p4berlin.de

Geschäftsführer:  
Dipl.-Ing. Paul M. Lösse  
Dipl.-Ing. W. Uwe Rilke

Gründungsgesellschafter:  
Dipl.-Ing. Peter Dittmer

Amtsgericht Berlin  
Charlottenburg HRB 54 888  
Ust-Id-Nr. DE 17 25 82 904  
Umsatzsteuer: 27/424/8155

Deutsche Bank  
BLZ 100 700 24  
Kontonr.: 467 60 03  
IBAN DE63100700240467600300  
SWIFT DEUTDE33HAN

Mitglied der Plan 4 21 E/WV  
European Consulting Coord.



QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVO/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË  
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY  
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE

**LICENCË KUALIFIKIMI**  
**LICENCE FOR QUALIFICATION**  
**LICENCA O KVALIFIKACIJI**

Nr./ No / Br. 0001

**Instituti për shkencë dhe teknologji "INTECH"**

Emri i biznesit/Name of Business/Naziv biznisa

**80687486**

Nr. i biznesit/Business No./Br. Biznisa

**"Kroi i bardhë" lokali nr. 101, Prishtinë**

Sëllim/Residence/Sjediste

**Prof. Dr. Isuf Krasniqi, Mr. Sc. Shkelzen Qorraj, Inxh. Dip. El. Bardh Hoxha**

Përfaqësuesi ligjor/Legal representative/Zastupnik

**Mr. Inxh. Ndërt. Shkelzen Qorraj**

Udhëheqësi teknik/Technical manager/Tehnicki rukovodilac

**Të gjitha kategoritë e projektimit në ndërtimtari: 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10**

Kategoritë dhe klasifikimi i kualifikimit/Categories and classification of qualification/Kategorija i vrsta kvalifikacije

**18.10.2005**

Data e lëshimit/Issued date/Datum izdavanja

**25.10.2005**

Data/Date/Datum



**Deri me 18.10.2008**

Vlefshmëria/Validity/Vazi do

Ministri/Ministar/Minister  
Mr. Bujar Dugolli



<p><b>1. PROJEKTEUSE URBANISTIKE</b></p> <p>a- Master plans - studime e plane rajonale Urbanistike.</p> <p>b- 1 - Plane rregullues të përgjithshme për qendra të banuara, 2 - Plane të qyteteve</p> <p>c- Studime pjesore Urbanistike.</p>	<p><b>2. PROJEKTEUSE ARKITEKTONIKE</b></p> <p>a- Objekte civile - industriale - turistike me etazhitet deri në B+ P + 4</p> <p>b- Objekte civile - industriale - turistike me etazhitet mbi B+ P + 4.</p> <p>c- Objekte sportive.</p> <p>d- Projektim interieri.</p> <p>e- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërues, lulishte e parqe.</p>
<p><b>3. PROJEKTEUSE KONSTRUKTIVE</b></p> <p>a- Objekte civile-industriale-turistike të tipit masiv apo skeletor me etazhitet deri në B+ P + 4.</p> <p>b- 1. Objekte civile - industriale - turistike me etazhitet mbi B+P+4</p> <p>2. Objekte me skelet metalik.</p> <p>c- 1. Objekte me shkallë të lartë veshitëse; - Beton armë, - metalike (Objekte në troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët)</p> <p>2. Objekte në troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.</p>	<p><b>4. PROJEKTEUSE INSTALATORE</b></p> <p>a- Instalime hidrosanitare.</p> <p>b- Instalime termoteknikë - ventilitimi - kondicionimi.</p> <p>c- Linja e rrjeta elektrike - telefonike - radiotelefoni - citofoni -sistem alarmi - televizion etj., për objekte civile, industriale, turistike.</p> <p>d- Sisteme komplekse të telekomunikacionit.</p> <p>e- Sisteme të furnizimit me gaz.</p>
<p><b>5. PROJEKTES VEPRA HIDRAULIKE</b></p> <p>a- Diga - galeri - tunele hidroaulike.</p> <p>b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.</p> <p>c- Ujësjellës kanalizime urbane - rurale.</p> <p>d- Vepra ujëtyje - kullimi - impiante vaditëse - diga deri 10m - damba.</p> <p>e- Vepra të trajtimit të ujit.</p> <p>f- Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi - kulla ekuilibri - porte - pontile.</p> <p>g- Vepra natësjellës - gazsjellës - voj sjellës etj.</p>	<p><b>6. PROJEKTEUSE E RRUGËVE - HEKURUDHAVE</b></p> <p>a- Rrugë auto kategoria V dhe IV.</p> <p>b- 1. Projektim rruge kategoria III dhe II</p> <p>2. Kategoria I.</p> <p>c- Shpresa rrugore e sistemim - asfaltimse.</p> <p>d- Autostrada - aeroporte - heliporte.</p> <p>e- Hekurudha - degëzime hekurudhore.</p>
<p><b>7. PROJEKTEUSE URAVE DHE VEPRAVE ARTI</b></p> <p>a- Ura dhe vepra arti të vogla deri në 10 m.</p> <p>b- Ura dhe vepra arti mbi 10 m - Estakada.</p> <p>c- Ura metalike.</p> <p>d- Tuncle rrugore - hekurudhore.</p>	<p><b>8. PROJEKTEUSE GJEODEZIKE</b></p> <p>a- Bazamente gjeodezike - rretime në të gjitha shkallët.</p> <p>b- Projektim fotogrametrik - hartografik - topografik.</p>
<p><b>9. STUDIM GJEOLGJEO INXHINIERIK - HIDROGJEOLGJIK</b></p> <p>a- Studim/Vlerësim gjeologjiko inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike me etazhitet deri në P + 4.</p> <p>b- Studim/Vlerësim gjeologjiko inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike me etazhitet mbi P+4.</p> <p>c- Studim/Vlerësim gjeologjiko inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/C, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.</p> <p>d- Studim/Vlerësim gjeologjiko inxhinierik i trojeve të bota dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.</p> <p>e- Studime e projektme hidro gjeologjike.</p>	<p><b>10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË</b></p> <p>a- Centrale hidraulike ,elektrik ( primare, sekondare).</p> <p>b- Centrale termike (primare, sekondare).</p> <p>c- Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike - diellore - era etj.</p> <p>d- Nënstacione elektrike, prisar sekondar - linja të tensionit të lartë.</p> <p>e- Kabina elektrike të rryjetit shpërndarës-linja të tensionit të ulët -të mesëm.</p>





## Hartues i Projektit - Partneriteti



Instituti i shkencës dhe teknologjisë  
Institute of science and technology



HessenAgentur

HA Hessen Agentur GmbH



INSTITUT WOHNEN UND UMWELT GmbH  
- Institute for Housing and Environment -

planungsgruppe 4

### Drejtor i Projektit:

Shkëlzen Qorra

### Stafi Profesional:

- 1.Fridhelm Flug
- 2.Driton Lleshi
- 3.Paul M. Lösse
- 4.Uwe Wulkopf
- 5.Isuf Krasniqi
- 6.Heinz Sautter
- 7.Reiner Greiff
- 8.Wolf Uwe Rilke
- 9.Bodo Fuhman
- 10.Bardh Hoxha
- 11.Christopher Borin
- 12.Henning Schwarting
- 13.Nikolaus Dieffenbach

## Ekipet Punuese Komunale

### Menaxhimi

Drejtoria për Urbanizëm Rindërtim dhe Ambient

### Menaxherët e Projektit

Sevdije Maliqi Hyseni - i.d.arkitektures  
Fadil Sherifi - i.d.arkitektures  
Omer Daku - i.d.ndertimtarisë

### Ekipi Bazë

Fadil Sherifi - i.d.arkitektures  
Sevdije Maliqi Hyseni - i.d.arkitektures  
Jashar Ramadani - specialist i pediatriisë  
Hylkije Gollupeni - eksperte e Planifikimit Urban  
Faton Deva - ekspert i Planifikimit Urban

**Komiteti Drejtues**

ecc Xhemail Hyseni  
ecc Zijadin Maliqi  
inxhi gj. Fehmi Agushi  
i.d.a. Selvije Shefkiu  
i.d.n-h.Kimete Salihu

**UNHABITAT –ti, Programi mbështetës për Planifikim Hapësinorë Komunal**

Ismail Baftjari	Këshilltar për Planifikim
Huig Deneef	Planing Advisor
Eric Feiler	Planing Advisor
Arden Abazi	Urban Planing Assistant

**Ekipi Komunal i Planifikimit “ E K P “**

Enver Muja	ekonomist	kryetar
Sevdije Maliqi - Hyseni	i.d.arkitektures	anëtare
Fadil Sherifi	i.d.arkitektures	anëtar
Jashar Ramadani	specialist i pediatriisë	anëtar
Agim Salihu	i.d.i elektroteknikes	anëtar
Murat Hoxha	i.d.i gjeodezisë	anëtar
Fitnete Mjaku	Ekonomiste e diplomuar	anëtar
Halil Bllaca	jurist	anëtar
Agim Rexhepi	jurist	anëtar
Hazir Mustafa	inxh.i tekstit	anëtar
Zvonko Petroviq	Inxh i bujqwsisë	anëtar
Xhelal Selmani	ekonomist	anëtar
Shpresa Hajdari	Sh.l.p. klasor	anëtar
Zyrja e Prokurimit		
Sherbimi i Inspeksionit		
Spektori për Banim dhe Zyrja për qështje gjinore		
Rushit Avdiu	Ecc. I dipl.	
Isah Bunjaku		
Shukri Sylejmani	IDM	
Jakup Bajrami	IDT	
Drita Maliqi	Sh.l.p. Matematikë-Fizikë	
Komiteti për Arsim		

**Grupi i Planerëve Urban**

Sevdije Maliqi – Hyseni	Arkitekthe
Fadil Sherifi	Arkitekt
Naser Sylejmani	Arkitekt
Mumin Kqiku	Jurist
Selvije Shefkiu	Arkitekthe
Hamdi Ismajli	i.d.ndertimtarisë
Bahrije Mahmuti	Arkitekthe
Qefsere Sadriu	Arkitekthe
Kimete Salihu	Id e ndertimtarisë-hidro
Hajrush Kqiku	Idi ndertimtarisë -hidro
Fehmi Agushi	Inxh.i gjellogjisë
Enver Biçku	Inxh.i komunikacionit
Dritë Bajrami	Inxh,e hidros
Dragan Janiq	Teknik i ndertimtarisë

**Grupi ndihmës i Planerëve**

Ejup Hajrullahu	Teknik i ndertimtarisë
Naser Elezi	Teknik i ekonomisë
Myrvete Kadriu	arhiviste
Selami Salihu	Ekonomisti diplomuar
Sllavica	
Jugosllav Kovaqeviq	

**Grupet Punuese:****1. Grupi për Demografi dhe Qështje sociale**

Jashar Ramadani	kryetar	Spec.i pediatriisë
Qefsere Sadriu	anëtare	Ark
Selvije Shefkiu	anëtare	Ark
Bahrije Mahmuti	anëtare	Ark
Agim Rexhepi	anëtar	Jurist
Xhevat Aliu	anëtar	Prof. Gjeografisë
Shpresa Hajdari	anëtare	Sh.l.p. klasor
Isah Bunjaku	anëtar	Sh.l.p. statistikës
Halil Bllaca	anëtar	Jurist



## **2. Grupi për Shfrytëzimin e Tokës dhe Mjedisi**

Murat Hoxha	kryetar	Inxh.i gjeodezisë
Fehmi Agushi	kordinator	Inxh.i gjelogjisë
Zvonko Petroviq	anëtar	Inxh.i bujqësisë
Shaban Terziu	anëtar	Inxh i bujqësisë
Mumin Kqiku	anëtar	jurist

## **3. Grupi për Zhvillim Ekonomik**

Xhelal Selmani	kryetar	Ekonomist
Hamdi Ismajli	kordinator	Idn
Fitnete Mjaku	anëtare	ekonomiste

## **4. Grupi për Infrastrukturë**

Agim Salihu	kryetar	idielektroteknikës
Kimete Salihu	kordinator	i.d.i ndert-hidro
Hazir Mustafa	anëtar	Inxh.i tekstillit

## **5. Drejtoritë Komunale**

Drejtoria për Ndërmarrje dhe Shërbime Publike	DNSHP
Drejtoria për Demografi dhe Qështje Sociale	DDQS
Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë	DSE
Drejtoria për Buxhet Financa dhe Investime	DBFI
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	DKRS
Drejtoria për Gjeodezi , Kadastër, Pronë dhe Banim	DGjKPB
Drejtoria për Ekonomi dhe Menagjment	DEM
Drejtoria për Bujqësi , Pylltari dhe Veterinë	DBP
Drejtoria për Administratë të Përgjithëshme	DAP
Drejtoria për Arsim	DA
Inspeksioni	

## **6. Subjektet Komunale**

Zyra e Prokurimit  
Zyra Lokale për komunitete  
Zyra Ligjore  
KRUK” Hidromorava”  
KM” Higjena “



KEK-u  
Qendra për punë Sociale  
SHPK  
TMK  
UNMIK  
KFOR  
Shoqatat Humanitare  
OJQ –të e Grave  
Enti I Statistikës  
Shoqata e Pensionistëve  
Shoqata e Peshkatarëve  
Oda ekonomike e Kosovës  
Inspeksioni I Punës  
Enti për Punësim  
Asambleja Komunale  
Komoteti për Politikë e Financa  
Bordi I Drejtorëve  
Asociacioni I Kryetarëve të Komunave  
Grupet e Komuniteteve  
Shoqatat e Zejtarëve  
Komiteti për Planifikim, Resurse dhe Ambient  
Komiteti për Pronë, Banim dhe Rindërtim  
Komiteti për Arsim  
Komiteti për Kulturë, Rini e Sport  
Zyra rajonale e trashëgimisë Kulturore  
Zyra rajonale e ministrisë së telekomunikacionit  
Zyra rajonale e Ministrisë së Bujqësisë  
Zyra rajonale e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

### **Anëtarët e angazhuar gjatë procesit në fazën kohore të vitit 2008**

Qemail Mustafa	IDE
Islam Zuzaku	Teknik i ekonomisë
Sami Salihu	Ekonomisti diplomuar
Omer Daku	IDN
Ismet Maliqi	Ekonomisti diplomuar
Ismail Kurteshi	Prof. I gjuhës Angleze
Mevlide Shaqiri	Akushere



### **Këshilli i ekspertëve**

Sabri Tahiri

Ali Arifi

Abdyl Hasani

Qefsere Sadriu

Abdyl Aliu

Ismet Mehmeti

Arben Dubova

Bujar Shkodra

Vebi salihu

Sevdije Hyseni

Zeqirja Rrahmani

**PËRMBAJTAJA**

<b>0</b>	<b>HYRJA</b>	<b>15</b>
<b>1</b>	<b>PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINORE DHE ANALIZA E GJENDJES</b>	<b>19</b>
1.1	PROFILI I GJENDJES SE QYTETIT	19
1.1.1	Informata përmbajtjesore mbi situatën	19
1.1.2	Pozita, rëndësia dhe çështje specifike për territorin e qytetit ne kontekst te PZHU dhe PHK	22
1.1.3	Përfshirja e informatave kyçe te raporteve dhe strategjive sektoriale ne dispozicion	25
1.1.4	Çështje kyçe te kontekstit me te gjere hapësinorë	26
1.2	VLERËSIMI I GJENDJES URBANE	28
1.2.a	DEMOGRAFIA DHE QESHTJET SOCIALE	28
1.2.b	ZHVILLIMI EKONOMIK	65
1.2.c	MJEDISI DHE SHFRYTEZIMI I TOKËS	73
1.2.d	INFRASTRUKTURA	97
1.2.1	Analiza e profilit	113
1.2.2	Analiza e ndërlidhjeve ne mes të çështjeve, politikave dhe programeve	113
1.3	VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTUESE	119
1.4	SFIDAT ZHVILLIMORE	121
<b>2</b>	<b>VIZIONI, PARIMET DHE CAQET</b>	<b>123</b>
2.1	VIZIONI PËR TE ARDHMEN E ZONËS URBANE	123
2.2	PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM	124
2.3	CAQET ZHVILLIMORE AFATGJATE	124
2.4	PRIORITETET STRATEGJIKE	128
<b>3</b>	<b>KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR URBAN</b>	<b>133</b>
3.1	KONCEPTET KRYESORE TE ZHVILLIMIT HAPËSINORE	133
3.2	STRUKTURA DHE LOKACIONI HAPËSINORE PER ZHVILLIMIN DHE ORGANIZIMIN E ARDHSHËM	137
3.2.1	Zhvillimi ekonomikë, regjenerimi, rekreacioni, tregtia	140
3.2.2	Infrastruktura – komunikimet	144



3.2.3	Popullsia, banimi, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgimia kulturore	155
3.3	SHËNJIMI I NDËRTIMEVE, ZONAVE APO PROJEKTEVE STRATEGJIKE TE APROVUAR NE PLANET PËR RAJONE ME TE GJERA	159
3.4	VLERËSIMI I NDIKIMIT TE KORNIZËS SE PROPOZUAR	161
<b>4</b>	<b>STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM</b>	<b>163</b>
4.1	STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT TE SHOQËRUARA ME KONCEPTET HAPËSINORE OSE PARIMET	163
4.2	VLERËSIMET E STRATEGJIVE BAZUAR NE KRITERET E PËRCAKTUARA ME PARIME, POLITIKA DHE LIGJE	173
4.3	AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZA INSTITUCIONALE	173
<b>5</b>	<b>DISPOZITAT PËR ZBATIM</b>	<b>179</b>
5.1	UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TE PLANIT ZHVILLIMOR URBAN GJATE HARTIMIT TE PLANEVE RREGULLUESE DHE PLANEVE TJERA	179
5.2	KUSHTE TE PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TE RËNDËSISHME PER ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NE ZONA URBANE	180
5.2.1	Kushtet për përcaktimin dhe përkufizimin e sipërfaqeve publike si dhe atyre me destinime tjera	180
5.2.2	Kushtet për rregullimin e hapësirës për objekte me rendësi për Kosovën dhe Komunën	180
5.2.3	Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive ekonomike	181
5.2.4	Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive publike	182
5.2.5	Kushtet dhe mënyra e ndërtimit të objekteve të banimit	183
5.2.6	Kushtet për përcaktimin e rrjetit të sipërfaqeve të korridoreve apo trasave telekomunikuese dhe rrjetit të infrastrukturës urbane	183
5.2.7	Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlerë të veçantë	184
5.2.8	Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike	184





5.2.9	Mënyra e trajtimit të hedhurinave (përpunimi, deponimi dhe bartja)	184
5.2.10	Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis	185
5.2.11	Masat për parandalimin e ndikimit negativ social	185
5.2.12	Masat për zbatimin e planit	185
5.3	DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN	186
5.4	DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E ZBATIMIT	187
5.5	ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TE MËTUTJESHËM	188

**LISTA E FIGURAVE**

Fig. 1: Gjiilan 1912 .....	20
Fig. 2: Plani Gjeneral Urban, 1980.....	22
Fig. 3: Plani rregullues Qarku .....	25
Fig. 4:Piramida e popullsisë së Kosovës.....	32
Fig. 5:Rajonet e analizuarra për balancimin e tyre të migrimit.....	35
Fig. 6: Formula për llogaritje .....	38
Fig. 7: Nevoja e llogaritur për tokë ndërtimore (fshatrat) .....	50
Fig. 8: Nevoja e llogaritur për tokë ndërtimore (komuna).....	51
Fig. 9: Teatri i Qytetit .....	60
Fig.10: Fabrika për prodhimin e konstruksioneve të çelikut "Çeliku".....	67
Fig.11:Parku i qytetit.....	76
Fig.12: Gjiilani qendra e qytetit .....	80
Fig.13: Pllakati për një fushatë nga Ministria e Kulturës.....	84
Fig.14: Burimi i i Sahit Ages në Gjiilan, Çezma e Sahit Agës .....	87
Fig.15: Ndërtesat e reja ndryshojnë karakterin urban historik përreth Atik xhamisë. ....	87
Fig.16: Ndërtesa e zyrës së Kryetarit të Gjiilanit, në kohën e turqve, Objekti i kajmekamit.....	87
Fig.17: Kisha ortodokse St. Nicolasi e Gjiilanit dhe Shillovës .....	88
Fig.18: ndërtesat banuese tradicionale.....	89
Fig.19: VBJF të identifikuarra nga zyrtarë komunal .....	95
Fig.20: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë.....	96
Fig.21: Trafiku në qendër të qytetit.....	99
Fig.22: Shtrirja hapësinore e rrjetit të ujësjellësit .....	101
Fig.23: Harta hidrologjike e Gjiilanit.....	102
Fig.24: Shtrirja hapësinore e rrjetit të kanalizimit .....	104
Fig.25: Rrjeti Elektrik i Kosovës.....	107
Fig.26: Nënstationet e reja 110/20(10)kV në Kosovë .....	108
Fig.27: Shtrirja hapësinore e rrjetit të Telefonisë fikse në Gjiilan.....	110
Fig.28: Harta e Iniciativës dhe Emblemi i sajë.....	114
Fig.29: Gjiilani,m qendra e trekëndëshit të dyfishtë.....	116
Fig.30: Potencialet zhvillimore të Gjiilanit.....	127
Fig.31: Harta e Vizionit nga punëtorja në Ohër.....	132
Fig.32: Linjat e transportit Urban të propozuara në Gjiilan.....	145
Fig.33: Puset e propozuara Gjiilan.....	148
Fig.34: Trafostacionet e reja ne Kosove .....	151
Fig.35: Renjet e Tensionit .....	152



Fig.36: Plani i Veprimit për prioritetin – Hartimi i Planeve Përkatëse.....	175
Fig.37: Plani i Veprimit për prioritetin – Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore .....	176
Fig.38: Plani i Veprimit për prioritetin – Infrastruktura Teknike .....	177
Fig.39: Plani i Veprimit për prioritetin – Demografia dhe çështjet Sociale .....	177
Fig.40: Plani i Veprimit për prioritetin – Zhvillimi Ekonomik.....	178

## LISA E TABELAVE

Tab. 1: Të dhënat mbi popullsinë e Gjiilanit dhe Kosovës.....	30
Tab. 2: Zhvillimi i Popullsisë në Gjiilan <sup>1/1</sup> dhe Përbërja Etnike .....	31
Tab. 3: Shkalla e lindjeve në Kosovë .....	33
Tab. 4: Shkalla e Shtimit të Popullsisë në Gjiilan .....	33
Tab. 5: Balancimi i migrimit .....	35
Tab. 6: Të Dhëna përgjithshme mbi Personat për Vendbanim dhe Sipërfaqe të Banimit në Kosovë .....	41
Tab. 7: Zhvillimet e Familjeve 2002 / 2020 (vlerësimi i përafërt) .....	42
Tab. 8: Familjet me numër të dhomave në Kosovë (zonat urbane/rurale .....	44
Tab. 9: Numri i Banorëve për Vendbanim në Gjiilan.....	44
Tab.10: Lloji I banimit në Gjiilan .....	45
Tab.11: Standardi teknik i vendbanimeve në Gjiilan.....	45
Tab.12: Përcaktuesit e Kërkesave për të Ardhmen .....	46
Tab.13: Çerdhet në Gjiilan.....	52
Tab.14: Shkollat Fillore në Komunë .....	52
Tab.15: Numri i shkollave fillore, nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e obligueshëm (klasat 1–9), 2005/6.....	53
Tab.16: Shkollat e mesme në Qytet .....	53
Tab.17: Numri i shkollave të mesme , nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e mesëm (klasat(X-XII), 2005/6.....	54
Tab.18: Personeli arsimor në arsimin e mesëm sipas pozitës (klasat (X-XII) 2005/6 .....	54
Tab.19: Tabela e të punësuarve sipas nivelit profesional, Burimi:Raportet Sektoriale .....	57
Tab.20: Numri i shtretërve sipas reparteve në Spitalin Rajonal të Gjiilanit, Burimi:Raportet Sektoriale .....	57
Tab.21: Numri i punëtorëve në institucionet shëndetësore.....	58
Tab.22: Organizatat rinore që veprojnë në Komunën e Gjiilanit.....	61
Tab.23: Regjistri I Klubeve Sportive dhe numri I anëtarëve sambas grupmoshave.....	63



Tab.24: Pasuria e ndërmarrjeve shoqërore.....	66
Tab.25:Numri i bizneseve të regjistruara në sektorin privat dhe shoqëror sipas seksionit të veprimtarisë .....	68
Tab.26: Lista e Monumenteve Historike të mbrojtura me ligj /1/ .....	85
Tab.27: Lisat e inventarizimit të Monumenteve Historike dhe Objekteve në Gjiçan sipas lokacioneve - Inventarizimi i Vlerave të Kulturës Materiale në Gjiçan sipas Tyre .....	86
Tab.28: Prodhimi mesatar i ujit në vitin 2004 .....	101
Tab.29: Gjatësia e rrjetit elektrodistributiv .....	107
Tab.30: Projektet në Arsim .....	117
Tab.31: Projektet në Shëndetësi .....	117
Tab.32: Projektet në Ujësjiellës dhe Mjedis.....	117
Tab.33: Projektet në Energjetikë, Telefoni dhe Komunikacion Rrugorë.....	117
Tab.34: Projektet në Kulturë, Rini dhe Sport .....	117
Tab.35: Projektet në Urbanizëm dhe Gjeodezi.....	118
Tab.36: Projektet në Ekonomi, Bujqësi dhe Pylltar .....	118
Tab.37: Projektet e Bashkëpunimit ndërkufitarë dhe ndërajonal .....	118
Tab.38: Puset e propozuara në Gjiçan.....	147
Tab.39: Kërkesat për banim në të ardhmen në Gjiçan, bazat e vlerësimit .....	155

**LISTA E PLANEVE**

Plan 1: Situacioni në qytet – Infrastruktura Sociale .....	64
Plan 2: Pozita e Qytetit – Peizazhi dhe Mjedisi.....	77
Plan 3: Situacioni i Qytetit – Shfrytëzimi i Tokës .....	81
Plan 4: Situacioni në Qytet – Trafiku dhe Infrastruktura Teknike .....	112
Plan 5: Skenarët hapësinorë për Gjilanin.....	136
Plan 6: Skenari D - Modeli Zhvillimorë Hapësinorë i Gjilanit .....	139
Plan 7: Potencialet e zhvillimit Ekonomik .....	141
Plan 8: Koncepti i gjelbërimit të qytetit .....	143
Plan 9: Plani konceptual i trafikut dhe infrastrukturës teknike të qytetit .....	154
Plan 10: Plani i Zhvillimit Hapësinorë Urban .....	160
Plan 11: Planet Rregulluese Urbane .....	166
Plan 12: Projektet kyçe .....	171



## 0 HYRJA

Gjiçani si qendër kryesore e zhvillimit demokratik, ekonomik dhe kulturore, konsiderohet si zemra e komunës. Për shkak të ndryshimeve dramatike që ndodhen në rajon, zhvillimi gjithëpërfshirës i qytetit duhet të adoptohet kërkesave të së ardhmes. Për ta drejtuar dhe kontrolluar procesin e adoptimit, Komuna ka vendosur që ta hartoi Planin Zhvillimor Urban për qytetin e Gjiçanit.

Detyra e planifikimit gjithëpërfshirës, kërkon, në të njëjtën kohë, aktivitete në shumë fusha të veprimit edhe për nivele të ndryshme të planifikimit. Në veçanti punët e planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë duhet të jenë të bazuara në njohuritë e ekspertëve të disiplinave të ndryshme shkencore e profesionale, sikur që edhe duhet të merren parasysh edhe i gjithë kompleksiteti i çështjeve urbane.

Plani zhvillimor Urban i Gjiçanit është përgatitur nën udhëheqjen e Drejtorisë për Urbanizëm Rindërtim dhe Ambient dhe drejtorive të tjera të komunale. Pikërisht për këtë, janë mbajtur disa Workshope, ku propozimet planifikuese janë diskutuar me stafin e drejtorisë komunale për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient, (shih figurën "procesi i punës").

Për përkrahje profesionale në procesin e hartimit të këtij plani, Komuna e Gjiçanit ka kontraktuar konsorciumin multidisiplinar i cili përbëhet nga: Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë (INTECH), Hessen Agentur GmbH (HA), Institut Wohnen und Umwelt GmbH (IWU) dhe Planungsgruppe 4 Berlin GmbH (P4). Ky konsorcium përfshinë të gjithë spektrin e detyrave planifikuese zhvillimore dhe urbane.

Siç kërkohet me Ligjin mbi Planifikim Hapësinor të Kosovës, PZHU i Gjiçanit është në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal. Pikërisht për këtë, PZHU është i gatshëm ti referohet në çdo kohë dokumentit të PZHK-së.

### Drejt një strukture të planifikimit të integruar

Planifikimi i integruar konsiderohet si një strukturë e artit në Evropë. Ai e përfshinë: integrimin e çështjeve zhvillimore në fushat relevante dhe përcakton bartësit e veprimeve të tyre. Për më tepër, ai e përfshinë bashkimin e niveleve të ndryshme të planifikimit. Mu për këtë planifikimi i integruar e përmirëson- ngritë nivelin dhe efikasitetin e planifikimit urban.



Plani Zhvillimor Urban i Gjiçanit i siguron komunës: një strategji të zhvillimit urban dhe këshilla të mëtutjeshme në çështjet fundamentale të planifikimit. Pas aprovimit të tij nga komuna, Plani Zhvillimor Urbanë do ta luan një rol vendimtar në tërheqjen dhe orientimin e investimeve private dhe komerciale. Për më tepër ky planë do të shërbej si bazë për punët e ardhshme të planifikimit.

## Procesi i Punës

Fillimi i këtij procesi ishte fundi i vitit 2005 – fillimi i vitit 2006 ku, nga Kuvendi komunal nxirren vendimet e ndara për hartimin e PZHK dhe PZHU, njëkohësisht obligohet DURA të jetë bartëse e dy planeve në fjalë.

Gjatë vitit 2005, u bënë përgatitjet e nevojshme dhe filloi puna në hartimin e detyrës projektuese për dy planet bazuar në ligjin e Planifikimit Hapësinor të hartuar në vitin 2003 nga MMPH dhe udhëzimeve administrative, të nxjerra më vonë, sipas këtij ligji. Për Hartimin e dy planeve, komuna ka shpallur Tender ndërkombëtar dhe në fund të vitit 2005 kontraktohet konsorciumi multidisiplinar në përbërje: Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë (INTECH), Hessen Agentur GmbH (HA), Institut Wohnen und Umwelt GmbH (IWU) dhe Planungsgruppe 4 Berlin GmbH (P4) si hartues i planeve të sipërpërmenduar respektivisht do të ndihmoj dhe përkrah profesionalisht stafin përkatës komunal gjatë tërë këtij procesi

U fillua me Profilin e zhvillimit hapësinor të pjesës Urbane dhe Komunale: Marrjen dhe mbledhjen e të gjitha informative gjeografike, fizike, mjedisore dhe socio-ekonomike nga Drejtoritë komunale dhe kompanitë publike. Në proces janë kyçur në mënyrë intensive të gjitha drejtoritë, e sidomos stafi profesional i tyre si dhe Ekipi komunal i Planifikimit i formuar më parë.

Në vazhdimësi janë siguruar raportet dhe strategjitë sektoriale nga drejtoritë dhe kompanitë publike rajonale në nivel komunal ku është paraqitur gjendja aktuale dhe specifikimi i nevojave përkatëse. Bazuar në këto të dhëna, është bërë SWOT-analiza, është hartuar vizioni për të ardhmen dhe prioritet strategjike në fusha tematike. Raportet e tilla janë të protokolluara dhe të regjistruara nga secila drejtori dhe si të tilla janë pjesë e dokumentacionit shtesë të këtij procesi planifikues.

Më pastaj janë formuar grupet punuese të ndara në fusha tematike, sipas ligjit për Planifikim Hapësinor dhe atë në fushat e:

- demografisë dhe çështjeve sociale,



- shfrytëzimit të tokës dhe mjedisit,
- infrastrukturës teknike,
- zhvillimit ekonomik si dhe grupi i pestë
- grupi i sinergjisë.

Secila fushë kishte kryetarin, koordinatorin dhe anëtarët, që e përbënin profesionistët e profilit përkatës.

Në mënyrë intensive vazhduan takimet me qytetarët e pjesës Urbane dhe rurale të ndara në pesë zona, ku me secilën zonë janë mbajtur së paku dy e më shumë takime. Takimet janë mbajtur edhe në viset e banuara me komunitetin serb me ndihmesë të KFOR-it, OSBE-s dhe UN-Habitatit.

Përveç takimeve të mbajtura me qytetarët e pjesës Urbane dhe asaj Rurale janë mbajtur edhe takime me përfaqësuesit e nivelit qendrorë, zyre rajonale të ministrive që veprojnë në komunë e veçmas me përfaqësuesit e MMPH respektivisht me IPMH, Sektorin Privat, Shoqëritë Civile, Organizatat joqeveritare, SHPK, TMK, KFOR-in, OSBE-në, nxënësit e shkollave fillore e takime tjera. Për të gjitha takimet të cilat janë mbajtur janë procesverbalet që dëshmojnë numrin e takimeve dhe pjesëmarrjes në këto takime.

Që nga fillimi i procesit e deri para shpalljes së shqyrtimit publik për të dy dokumentet, janë mbajtur dhe evidentuar më se 100 takime, kuptohet të niveleve të ndryshme.

Pas mbledhjes së të gjitha shënimeve, propozimeve, vërejtjeve, si dhe komenteve nga këto takime, në mënyrë intensive u fillua me analizën e gjendjes me metodën SWOT, së pari me grupet punuese e më pastaj me organizimin e WORKSHOP-it tre ditor së bashku me këto grupe.

Dokumenti edhe më tej u pasurua me mbajtjen e Workshopit 5 ditor në Ohër " Vizioni i Gjilanit 2015+" së bashku me shoqërinë civile, ekipi i planerëve komunal i organizuar dhe i përkrahur profesionalisht dhe materialisht nga UN-Habitat-i. Janë mbajtur edhe takimet tjera me tema të ndryshme, UN-Habitati, për ditën e parë botërore të tij, ka organizuar takime së bashku me nxënësit e shkollës fillore "Thimi MITKO" me temën se si e shohin fëmijët zhvillimin e Qytetit të GJILANIT deri në vitin 2015 e më tej dhe tema tjetër lidhur me sigurinë e përgjithshme në Qytet me çka dokumentin u begatua dhe fitoj edhe më shumë në cilësi.





Më pastaj u intensifikuan aktivitetet e grupet punuese të rrethit të ngushtë së bashku me kompaninë e në përkrahje nga UN-Habitat-i , Ky angazhim rezultojë me hartimin e draft dokumentit, që ishte rezultat i përpjekjeve të përbashkëta për një dokument sa më cilësor.



# 1 PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINORE DHE ANALIZA E GJENDJES

## 1.1 PROFILI I GJENDJES SE QYTETIT

### 1.1.1 Informata përmbajtjesore mbi situatën

#### **Sfondi Historik**

Gjiçani si vendbanim për herë të parë përmendet nga fundi i shek XIV – më saktësisht në vitin 1455 si vendbanim me 41 shtëpi ku jetonin edhe disa banorë të konfeksionit katolik .

Më vonë nga viti 1750 Gjiçani fillon të behët qendër Urbane që nga vendosja e familjes feudale e Gjinollëve (Bahti be Gjinolli), e cila familje kalon nga Artana ( Novobërda) në Gjiçan,

Në këtë kohë Gjiçani ishte Kaza – Rrethinë ( në kuadër të sanxhakut të Prishtinës ). Gjatë kësaj kohe qyteti i Gjiçanit kishte një infrastrukturë mjaft të pasur, e cila me kalimin e kohës do të shkatërrohet. Sipas udhëpërshkruesve gjerman, francez, austriak e të tjerë të gjysmës së shek XIX- të, Gjiçani kishte një Bezistan– çarshi të mbyllur me mur me afro 60 dyqane ( kjo ndodhej në pjesën e poshtme të Xhamisë së Madhe), një sahat Kullë ( afër kësaj Xhamie të rrënuar më 1922, ora e së cila edhe tani gjendet në kombnen e kishës ortodokse në Gjiçan ) , një Hamam , 11 qeshmë publike (më vonë kishte mbi 22 qeshmë publike), një teqe dhe disa tyrbe, 22 Hane, një Medrese, një shkollë “ Ruzhdije“,progjimnaz, disa shkolla iftidaje , një Kazermë , dy depo ushtarake (tani ndërtesa e LDK së ), një spital një Gazëhane etj.

Tani ku janë të ndërtuara ndërtesat e policisë, gjyqit dhe shkolla “Thimi Mitko” , kanë qenë Varrezat myslimane të qytetit. Qendra (çarshia ) e qytetit ishte pa banesa me dyqane të vogla zejtare e tregtare , rugët me kalldrëme etj.

Në vitin 1900/1 Gjiçani kishte 100 shtëpi me rreth 6000 banorë .

Në qytet kanë qenë këto mëhalla: Mëhalla e Çarshisë, Mëhalla e Xhamisë së vjetër, Mëhalla e re, Mëhalla e Varoshit, Mëhalla e poshtme dhe Mëhalla e romëve. Qyteti kishte karakter Turk-oriental. Shumica e rrugëve ishin të shtruara, shumë ndërtesa ishin të dekoruar me elemente të arkitekturës orientale. Shtëpitë ishin të rrethuara me kopshte dhe të mbrojtura me mure të larta. Gjiçani kishte 2 pazare, 2 xhamia, 1 kishë, spital, bazë ushtarake, më shumë se 242 zejtar, zyre administrative,



shkolle fetare dhe 6 shkolla fillore. Zejtaria dhe bujqësia ishin industria më e rëndësishme.

Më 1912 Gjiçani kishte rreth 10.000 banorë.

Gjiçani kishte një fond të begatshëm të trashëgimisë kulturore, me rëndësi për rajonin. Pas luftës së parë botërore, me vendosjen e pushtetit serb fillon rrënim i shumë objekteve, rrënim i cili kishte vazhदार edhe më vonë.

Fig. 1: Gjiçan 1912



Më 1912 Kosova është përfshi në shtetin e ri të Shqipërisë, por i është dhënë Serbisë vitin tjetër. Në këtë kohë kanë jetuar 10,000 banorë në Gjiçan. Pas luftës së parë botërore, më 1918, Kosova u bë pjesë e shtetit të ri të Jugosllavisë. Luftërat, rëniet ekonomike dhe emigrimet bënë që numri i banorëve të bie në qytet. Gjiçani mbeti me numër të vogël të banorëve deri në luftën e dytë botërore.

Mes dy luftërave botërore, Gjiçani kishte një termocentral të vogël i cili ka punuar për një kohë të shkurtër ( edhe pas luftës së dytë botërore, TC punoi për një kohë të shkurtër).

Pas vitit 1945, pamja e qytetit ndryshoi. Qendra e qytetit është rindërtuar sipas nevojave të kohës, me rrugë të gjëra dhe ndërtesa moderne. Ndërtesat publike dhe të banimit janë ndërtuar përreth bulevardit. Qendra shkollore (me shkolla fillore, të mesme dhe fakultete) e përcakton qytetin si qendër komunale. Ndërtimi i objekteve të reja ka përmirësuar standardin e banimit për shumë banorë të Gjiçanit, por kjo po ashtu bëri humbjen e shumë ndërtesave të vjetra.



Gjilani prej 1950 është zhvilluar në një qytet industrial. Përpunimi i prodhimeve industriale ka dominuar në fillim, me industrinë e cigareve dhe tekstitit si degët më të rëndësishme. Më vonë u zhvilluar edhe industria e rëndë si ajo për prodhimin e baterive dhe radiatorëve. Popullsia e Gjilanit është rritur gjatë industrializimit. Mes 1953 deri 1981 numri i banorëve është rritur prej 9.250 në 35,000 banorë.

Në krahasim me pjesët tjera të Kosovës, qyteti i Gjilanit nuk ka pësuar dëme të mëdha gjatë luftës së viteve 90's si vendbanimet tjera rurale të komunës.

Me 24 prill 2002 një tërmet ndodhi me epiqendër afër Gjilanit. Dëmi material ka qenë i konsiderueshëm. Në mesin e objekteve që u dëmtuan ishte edhe xhamia në qendër të Gjilanit e cila u shkatërrua tërësisht. Gërmadhat e objekteve të shkatërruar nga tërmeti ende mund të shihen në disa fshatra, por në qytetin e Gjilanit gati të gjitha dëmet janë riparuar.




### 1.1.2 Pozita, rëndësia dhe çështje specifike për territorin e qytetit ne kontekst te PZHU dhe PHK

#### Plani Gjeneral Urban 1980

Plani i cili e mbulon zonën complete urbane të Gjiçanit është Plani Gjeneral Urban (PGJU), i përgatitur në vitin 1980. Ky plan ka paraparë një qendër të lirë, të planifikuar, me infrastrukturë rugore të rregulluar. Me këtë plan, qyteti është i rrethuar me zona banuese të densitetit të ndryshëm. Zonat industriale janë paraparë në jug-lindje dhe veri-lindje. Është paraparë Sistemi i rrugëve unazore rreth qytetit dhe qendrës së tij në brendi.

PGJU ishte përgatitur në përputhje me kërkesat e kohës. Disa nga pjesët e planit janë zbatuar dhe disa nga to mund të barten edhe ne planin e ri Zhvillimor Urban PZHU. Sidoqoftë, pas 26 viteve situata sociale dhe ekonomike e Gjiçanit ka ndryshuar rrënjësisht, dhe shumica e pjesëve të PGJU janë të tejkaluara. Vendbanime të ndryshme janë rritur në mënyrë jo formale, dhe ndërtimi i disa rrugëve të planifikuara dhe zonave industriale tani është i pamundshëm.

Fig. 2: Plani Gjeneral Urban, 1980





Idetë bazike të PGJU do të mund të merren në konsideratë gjatë procesit të PZHU, dhe aty ku janë të përshtatshme të adoptohen në planin e ri zhvillimor urban.

### **Nevojitet hartimi i tërësishëm i planeve të reja për qytetin e Gjiçanit.**

Pasi që çdo ditë rritet numri i banorëve dhe me te rriten edhe kërkesat për hapësira të reja për banim, punë, objekte shëndetësore dhe rekreacion, në hartimin e planeve duhet të merret parasysh këto kërkesa të cilat imponojnë zgjerimin e kufijve të qytetit të paraparë me PGJU ekzistues.

Procesin e hartimit të planeve të reja e vështirëson mungesa e informatave të sakta për gjendjen faktike në terren (ndryshimet në terren ndryshojnë pothuaj për çdo çast), gjegjësisht shtrirja fizike e qytetit dhe mungesa e informacioneve bazë të domosdoshme për nevojat e planifikimit.

Gjiçani edhe më parë ka pasë PDU të një pjese të tij, por ato u inkorporuan në planet detale urbanistike pas aprovimit të PGJU. Planet Detale Urbanistike të cilat janë ende në fuqi të pjesës Urbane të Gjiçanit janë:

1. "Pjesa e vjetër e Qytetit" – 1973, ecila përfshinë anën e djathtë të qendrës duke filluar nga hoteli deri te rruga për Malishevë, duke përfshirë edhe tregun e gjelbërt deri te ish Autoshkolla për të vazhduar rrugës nga qendra deri te hoteli Kristal.
2. "Pjesa e vjetër e Qytetit" – 1974, e cila përfshinë anën e majtë nga Arhivi Historik deri te udhëkryqi, lumi Mirusha, pastaj nga Stadioni dhe kompleksi i shkollave deri te rruga e parë në lagjen "Dheu i Bardhë", rruga "A. Presheva", lumi Stanishor, ish INA e në drejtim të qytetit duke përcjellur rrugën kryesore deri te Arhivi Historik.
3. "Pjesa e vjetër e Qytetit" – 1974, ana e djathtë e qytetit nga Stacioni i Autobusëve drejt qendrës deri te hoteli Kristal, prej Xhamisë së vogël deri te udhëkryqi në lagjen "Iliria" dhe deri te Ndërtesa e zjarrfikësve drejt qendrës.
4. "Ekonomia e pyjeve" – 1970, në mes të Stadionit dhe "Dardania 2".
5. "Dardania 1" – 1973 dhe "Dardania 2" – 1976 vendimi i KK-Gjiçan nr.01-350-18/76-01, dt.09.06.1976, (g.z.K.nr. 31/76), 33.67 hektar.
6. Ndryshimi dhe plotësimi i PDU: "Dardania 1 dhe Dardania 2", vendimi i KK-Gjiçan, nr.01-350-51/81, dt.25.12.1981, (g.z.K.nr8/1981).



7. "Parku i epërm – Iliria, nr.01.350-17/76-01, dt.09.06/1976, (g.z.Kos.nr.31/76), 41.11 hektar.
8. "Nën Kodrën e Dëshmorëve" – Rruga Prishtinë-Gjiçan deri te udhëkryqi, prej qerdhes së fëmijëve duke vazhduar përpjet lumit Mirusha deri te qeshmja e Petigovcit.
9. "Kodra e Dëshmorëve 1 dhe Kodra e Dëshmorëve 2" – 1984,
10. "Dheu i Bardhë 1 dhe Dheu i Bardhë 2" – 1984,
11. "Arbëria 1 dhe Arbëria 2" – 1984,
12. "Spitali Rajonal – Kosova Petrolli" – 1984,
13. "Banja" – 1986,
14. "Zona Industriale", vendimi i KK-Gjiçan, nr.01-4732/020, dt.08.07.2002,
15. "Zona Perëndimore – Qarku", vendim i KK-Gjiçan nr.01-8030/020 dt.04.10.2002,
16. "Iliria" (pjesë e ish "Kamnikut"), 2004,
17. "Pjesa nën Hallën e sporteve", 2004,
18. "Varrezat e reja", në lagjen Zabel, vendimi i KK-Gjiçan, për qasjen e hartimit të PrrU nr.01-5028/020/1, dt.29.05.2003, 12.67 hektar,
19. "Projekti i Rregullimit të "Shtrati i lumit Mirusha", 2007.

### Plani Rregullues– Qarku

Një Plan i ri rregullues urban për një zonë të madhe për ca. 290 hektar "Qarku" është aprovuar kohët e fundit nga Kuvendi Komunal i Gjiçanit. Kjo zonë gjendet në pjesën periferike jug-perëndimore të qytetit, ndërmjet M25-2 drejt Prishtinës dhe M25-3 drejt Ferizajt (shiko planin 4, situata në qytet – përdorimi i tokës).

Ky Plan përcakton një korridor të gjelbër qendror i rrethuar me shkolla dhe komplekse hotelesh. Banimi individual është planifikuar kryesisht në zonat e qëndrueshme afër qytetit ekzistues. Për më tepër, në periferinë urbane është paraparë një zonë me ndërtesa apartamentesh shumëkatëshe. Tri rrugë kryesore shkojnë në drejtim të veri-jugut përmes kësaj zone, dhe atë; një rrugë e brendshme për afërsisht në vazhdim të rrugës anësore ekzistuese, një rrugë qendrore e rrethuar nga dyqanet e tregtisë me pakicë, dhe një rrugë harkore jashtë rrugës kryesore.




Fig. 3: Plani rregullues Qarku

### 1.1.3 Përfshirja e informatave kyçe të raporteve dhe strategjive sektoriale në dispozicion

Në Komunën e Gjiçanit janë hartuar 11 raporte dhe Strategji sektoriale nga këto drejtori:

- Administratë Komunale,
- Kulturë, Rini dhe Sport,
- Buxhet, Financa dhe Investime,
- Arsim,
- Shërbime Publike,
- Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient,
- Ekonomi dhe Menaxhment,
- Shëndetësi dhe Çështje Sociale,
- Siguri dhe Emergjencë
- Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi,
- Bujqësi dhe Pylltari,





Informatat kyçe te raporteve dhe strategjive sektoriale janë përfshire ne fusha tematike veç e veç.

#### 1.1.4 Çështje kyçe te kontekstit me te gjere hapësinorë

##### **Gjiçani ne rajonin e Anamoravës**

Gjiçani gjendet në pjesën juglindore të Kosovës, ne rajonin e Anamoravës. Pozita e mirë gjeografike që ka Gjiçani, i mundëson atij lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, njëherësh i mundëson të jetë qendër e rëndësishme në trekëndëshin Gjiçan-Preshevë- Kumanovë.

Anamorava nuk është drejtpërdrejtë brenda zonës së Prishtinës, por kryeqyteti i Kosovës është gjithmonë i rëndësishëm për rajonin. Ka lidhje direkte nga Gjiçani për në Prishtinë përmes dy rrugëve të ndryshme magjistrale. Gjithashtu, ekzistojnë lidhje të ngushta ekonomike dhe kulturore ndërmjet rajonit të Anamoravës dhe zonën përreth Bujanovcit dhe Preshevës në Serbi dhe Kumanovës në Maqedoni.

Gjiçani është qendra dominuese në Anamoravë. Është një nga qytetet më të mëdha në rajon dhe ka përqendrimin e funksioneve qendrore për administratë, edukim, kujdes shëndetësor dhe kulturë. Gjiçani gjithashtu është qendër ekonomike për rajonin, me përqendrimin e industrisë dhe tregtisë.

Komunat në afërsi të Gjiçanit në rrafshin e Anamoravës nuk kanë rëndësi të madhe ekonomike dhe nuk kanë numër të madh të banorëve. Një ndër qendrat klimaterike më të rëndësishme të Kosovës është e vendosur në Kllokot në Komunën e Vitisë, pjesa perëndimore e Gjiçanit. Ekziston një Fabrikë Birre në Kamenicë. Artana, në zonën malore të pjesës veriore të rrafshit të Anamoravës ka një histori që prej kohesh si qyteti për shfrytëzimin e Minierave.

Autostrada e planifikuar Nish– Tiranë nuk do ta përshkojë Anamoravën. Lidhja më e afërt me autostradën është e planifikuar në Shtime, afërsisht 50km nga Gjiçani. Rruga për transportin më të afërt ndërkombëtar është korridori transportues Pan- Evropian X përmes Serbisë. Kjo rrugë vetëm pjesërisht e ka standardin e autostradës, por është shumë e rëndësishme për lidhje me rrjetin e transportit evropian .

Ekzistojnë dy rrugë magjistrale që përshkojnë këtë rajon; M25-2 dhe M25-3. M25-2 e lidh Preshevën që gjendet në Serbi me Prishtinën. M25-3 e lidh Bujanovcin me Ferizajn. Këto dy rrugë magjistrale kryqëzohen njëra



me tjetrën në Gjiçan. Të gjitha rrugët magjistrale në rajon janë të asfaltuara, edhe pse krahasuar me kriteret dhe standardin evropian cilësia e asfaltimit nuk është e nivelit të duhur.

Nuk ka hekurudhë në Anamoravë. Linjat më të afërta janë në Bujanovc dhe Preshevë në lindje, dhe Ferizaj në perëndim. Në "Planin Hapësinor të Kosovës" ekziston propozimi që të ndërtohet një linjë hekurudhore prej Ferizajt për Bujanovc përmes Gjiçanit.

Gjiçani ka pozitë të zhvilluar në Rajon, por gjithashtu ka edhe disa pengesa në krahasim me pjesët tjera të Kosovës, të përmendur më sipër. Komuna mund të ketë leverdi nga komunikimi i mirë dhe përforcimi i bashkëpunimit me vendet fqinjë.



## 1.2 VLERËSIMI I GJENDJES URBANE

### 1.2.a DEMOGRAFIA DHE QESHTJET SOCIALE

#### Popullsia-Gjendja

Baza e të dhënave mbi popullsinë në Kosovë si tërësi, si dhe mbi popullsinë e qytetit dhe Komunës së Gjilanit, është relativisht e pandryshueshme. Regjistrimi i përgjithshëm i fundit në Kosovë ka qenë në vitin 1991, dhe të dhënat e prezantuara janë treguar të pasigurta. Regjistrimi i përgjithshëm më i sigurt daton nga viti 1981 dhe 1971<sup>1</sup>. Megjithatë, ato të dhëna nuk mund të merren si baza të mjaftueshme për ta vlerësuar shtimin e popullsisë mes asaj kohe dhe të tanishmes. Një regjistrim i ri i përgjithshëm mund të pritët më së shpejti në fund të vitit 2006<sup>2</sup>. Prandaj çfarëdo prognoze në lidhje me zhvillimin- shtimin e popullsisë mund të jetë i bazuar vetëm nga këto vlerësime dhe llogaritje. Megjithatë, prognozat e shtimit të popullsisë janë esenciale për çfarëdo planifikimi strategjik. Kështu për më tepër prognozat e prezantuara më poshtë mund të merren si të përkohshme dhe të përmirësohen menjëherë kur të jenë të gatshme të dhënat e sakta (tani jemi të vetëdijshëm mbi mungesën e bazës së të dhënave).

Vet fakti se, zhvillimi i ardhshëm i popullatës në Kosovë e gjithashtu edhe i Gjilanit, varët nga shumë faktor si ai ekonomik, shoqëror dhe politik ai nuk mund të parashikohet pa të dhënat e duhura statistike. Mu për këtë është marr në konsideratë koncepti i planifikimit hapësinor sipas një plani urbanistik të qëndrueshëm i cili zbatohet hap pas hapi e i bazuar në nevojave relative për banim, tregti ose ndërtimeve publike gjatë kohës.

<sup>1</sup> „...për shkak të ngjarjeve të historisë së fundit dhe nga vet fakti se nuk ka pasur regjistrim të përgjithshëm të popullsisë që nga viti 1981, dhe sistemi i regjistrimit civil nuk është i freskët, praktikisht është e pamundur që te jepen të dhëna absolute të sakta për numrin e popullsisë (të Kosovës) si tërësi ose pjesët e saj përbërëse (...).  
"cit.: Ara e Statistikave të Kosovës: Statistikat e Tregut të Punës 2004, Seria e 5: statistikave Sociale; p.13

<sup>2</sup> Draft ligji për regjistrimin e përgjithshëm ishte dërguar në Kuvendin e Kosovës më Maj të vitit 2003 dhe është aprovuar nga Kuvendi më 11, Korrik 2003. Megjithatë, në ligj, nuk është dhënë data se kur do të bëhet regjistrimi i përgjithshëm. Kjo duhet të vendoset nga Kuvendi. Ligji për regjistrimin e përgjithshëm ishte shpallur me disa amendamente më 13 Dhjetor të viti 2004 nga PSSP-ja (cf. SOK.org as of 10/02/06).faza e parë testues për regjistrimin të përgjithshëm është mbajtur në gjashtë komuna dhe është përfunduar në mes të Nëntorit të vitit 2005. mund të pritët se, regjistrimi i përgjithshëm do të mbahet në fund të vitit 2006 ose fillim të vitit 2007.



Vlerësimi i popullsisë së Kosovës i bërë nga OSBE-ja (2000) është një nga vlerësimet më të sakta. Ai është i bazuar në shtimin e madh të popullsisë, të njohur në dekada 1981 deri 1991. Ky shtim ka qenë rreth 23 për 1000 persona ose përafërsisht 2% e popullsisë vjetore. Vlerësimet tjera i marrin parasysh një shtimit më të vogël të popullsisë. Shifrat e paraqitura nga UNMIK-u në vitin 2002 (ESTAP) p.sh janë të bazuar në një shkallë të rritjes së reduktuar të popullsisë prej 1,1% për çdo vit, e cila është rreth gjysmë shkalle e rritjes, e supozuar nga OSBE-ja. Sipas të dhënave të paraqitura nga statistikat jetësore (Vital) (SOK 2004) shkalla e madhe e lindjes (i gjallë) në vitin 2003 ishte 13.2 për njëmijë dhe shtimi natyror ishte 10,5 për njëmijë, të cilat mund të jenë të barabarta me shtimin natyral vjetorë, ku numri i përgjithshëm i popullsisë arrijnë vlerën rreth 1.860.000 banorë në Kosovë.

Të dhënat e sigurta janë vetëm në paraqitjen strukturore të popullsisë ( e jo vetëm nga numri i popullsisë), që janë të mbledhur në analizat e mëposhtme:

- "Analiza Demografike Socio-ekonomike dhe shëndetësore 1999 / 2000" që është kryer me rreth 7.300 kryefamiljar dhe 41.0000 persona (SOK/UNPF/IOM 2000),
- Analiza e Masës së Standardit Jetësor (LSMS) që i siguron të dhënat bazë për vlerësimin e varfërisë , studim i vitit 2000 (Banka Botërore 2001),
- Sistemi i Statistikave Jetësore (SOK 2004) bazuar në të dhënat mbi lindje, vdekjet dhe martesat (i organizuar përsëri në vitin 2001),
- "Analiza Demografike dhe shëndetësore e Kosovës 2003" (SOK 2004) që i mbulon shembullin e përfaqësimit të rreth 3.200 shtëpiakëve me rreth 19.500 banorë, duke u barazuar në rreth një për qind të popullatës Kosovare,
- "Analiza e fuqisë punëtore (LFS) e vitit 2004" (SOK 2005) – duke e arritur suksesin e analizës së vitit 2001, 2002 dhe 2003 – i kryer me rreth 3.200 kryefamiljarë dhe 19.900 persona.

Në bazë të të dhënave të siguruar nga këto analiza mund të krijohet një pamje më reale e zhvillimit të popullsisë. Të dhënat mbi moshat grupore, të gjinive, shkalla e lindjes dhe informatat mbi migrimin, mund të sigurohen nga këto analiza (SOK/UNPF/IOM 2000; VSS dhe DHS, SOK 2004). Këto të dhëna të specifikuar janë përfshirë në parashikimin-prognozën mbi zhvillimin e popullsisë, të prezantuar në vijim. Vlen të



Vlen të potencohet se, studimet e lartpërmendura, nuk mund ti zëvendësojnë të dhënat reale mbi regjistrimin e përgjithshëm. Të dhënat e plota kërkojnë më shumë përpunim të prognozave mbi popullsinë dhe nevojat e banimit të saj.

Tab. 1: Të dhënat mbi popullsinë e Gjilanit dhe Kosovës

#	Burimi i të dhënave	Numri i banorëve			Bazat
		Zona urbane	Gjilan Komuna	Kosovë	
1	SOK 1981 <sup>/1/</sup>		84.085	1.584 440	Të dhënat nga regjistrimi i përgjithshëm të vlerësuara si të sigurta
2	SOK 1991 <sup>/2/</sup>		103.675	1.956.000	Të dhënat nga regjistrimi i fundit i përgjithshëm, të vlerësuara si të sigurta
3	OSCE 2000		90.870	2.364.000	Shkalla e argumentimit të shtimit të mëparshëm natyral në Kosovë 2%/ vit (1981 ff)
4	UNMIK 2002 <sup>/3/</sup>			2.073.000	Vlerësimi për 2.000
5	UNMIK 2002 <sup>/4/</sup>			1.960.000	Vlerësimi për 2.001
6	Buxhet 2003 <sup>/5/</sup>			1.860.000	
7	ESI <sup>/6/</sup>			1.700.000	Vlerësimi për 2004, indikator të ndryshëm specifik
8	Komuna e Gjilanit	79.000	139.558		Vlerësimi i vitit 2002
9	Komuna e Gjilanit		133.724		Vlerësimi i vitit 2002
10	Zyra e regjistrimit UNMIK		129.690		Vlerësimi në Gusht 2003
11	Komuna e Gjilanit	83.962	140.523		Argumentimi i vlerësimit të vitit 2002 deri 2005

**Burimet** :/1/ Kosova dhe popullsia e saj. Përshkrim i shkurtër (SOK 2003)

/2/ Kosova dhe popullsia e saj . Përshkrim i shkurtër (SOK 2003); Popis '91 (FRY/FSO 1993)

/3/ ESTAP (UNMIK 2002); nevojat për energji elektrike, draft raporti, Prill 2002; pp. 22, 24

/4/ ESTAP (UNMIK 2002); ESTAP përmbledhje ekzekutive; raporti i fundit , Shtator 2002; p. 14

/5/ Bazuar në të dhënat nga shumë burime (SOK, RIINVEST, Regjistri Civil i Kosovës et al.) që përfshinë rreth 190.000 të cilët lëvizin mbrapa dhe përpara ndërmjet Kosovës dhe jashtë vendit

(Qeveria e Kosovës 2003; 2)

/6/ Vlerësuar nga zyrtarët ESI



/7/ Baza e të dhënave Komunale (2002)

/8/ Burimi: Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim;

Zyra Rajonale për Statistikë-Gjiçan;

Përpunoi: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Gjiçan (2006)

## Numri dhe përbërja e banorëve në Gjiçan

Për vitin 2002 Komuna e ka paraqitur një vlerësim të saj së në këtë territor banojnë rreth 139.558 banorë, 79.000 në qytetin Gjiçanit dhe 60.558 në fshatra. Në Gusht të vitit 2003 sipas të dhënave zyrtare të UNMIK-ut, komuna e Gjiçanit ka pasur 129.690 banorë, pjesa më e madhe prej 116.000 Shqiptar Kosovarë (89,4%), 12.000 Serb Kosovar (9,5%), rreth 350 Romë (0,2%) dhe 1.005 banor tjerë (0,8%) (Profili Komunal i OSBE-së për Gjiçanin, Shkurt 2005). Vlerësimi i fundit së numri i banorëve në komunë rritet në 140.523 në vitin 2005 është i bazuar në burime të ndryshme, duke përfshirë të dhënat nga UNHCR, IOM, OSBE, HLSP-DIFID, OJQ dhe të dhënat e vlerësimet e mëhershme.

Tab. 2: Zhvillimi i Popullsisë në Gjiçan <sup>1/1</sup> dhe Përbërja Etnike

Popullsia	Numri i Shqiptarëve Kosovar		Numri i serbëve në Kosovë		Numri i Romëve		Tjerët		Numri total	
		%		%		%		%		%
1981	59.764	71,1	19.212	22,8	3.347	4	1.762	2,1	84.085	100
1991	79.357	76,5	19.370	18,7	3.477	3,4	1.471	1,4	103.675	100
Gusht 2003	116.000	89,4	12.300	9,5	350	0,2	1.005	0,8	129.690	100

**Vërejtje:** Përfshirë Personat e Zhvendosur nga Brenda

**Burimi:** OSBE 2005:

Për regjistrimin e përgjithshëm të vitit 1981 dhe 1991 ;Zyra Federale e Statistikave në Beograd

Për vitin 2003: UNMIK Gjiçan /Gnjilane

## Parashikimi i Popullsisë për Vitin 2020


### Zhvillimi i Popullsisë

Zhvillimi i popullsisë bazohet në dy komponentë :

- Shtimi Natyral dhe
- Migrimi,

Nga këta parametra, shtimi i popullsisë mundet me qenë pozitive dhe negative. Zhvillimi natyral i popullsisë mund të vlerësohet në mënyrë më precize, atëherë kur kushteve të zhvillimit janë optimale e kur shkalla e lindjes ndryshon jashtëzakonisht ngadalë gjatë kohës. Për kushtet e Kosovës megjithatë, periudhat e luftës dhe proceset e migrimit të

shkaktuara nga lufta, që kanë lënë gjurmët e tyre në shtimin e popullsisë, tregojnë rënie në moshën mesatare të popullsisë dhe zvogëlim në shkallën e shtimit të popullsisë (Ministria e Shëndetësisë 2003; 8). Zvogëlimi i shkallës së shtimit mund të arrihet me zvogëlimin e shtimit të popullsisë së Kosovës nga moshat grupore prej njëzet vjet e teposhtë. Procesi i migrimit i shkaktuar nga lufta ka rezultuar veç kësaj në pasigurinë e qëndrueshme të numrit të popullsisë. Një pjesë e rëndësishme e refugjatëve që e kanë lënë Kosovën për të dal jashtë vendit, janë kthyer, por është e paqartë se ku do ta gjejnë ata vendin e tyre përfundimtar për të qëndruar në Kosovë. Megjithatë paqartësitë e tilla shpresojmë se do të zvogëlohen kur të definohet dhe garantohet statusi final i Kosovës



Source: Demographic and Socio-economic Survey 1999.

Fig. 4:Piramida e popullsisë së Kosovës

### Shtimi Natyrorë

Numrat mbi lindjet dhe vdekjet në Kosovë për periudhën prej 1988 deri 2003 tregojnë se, shkalla e lindjes është duke rënë në mënyrë domethënëse, në së paku 23,0 lindje të gjalla për 1.000 banor. Niveli i shtimit natyral të viteve të mëparshme “është rezultat i zhvillimit të vogël ekonomik dhe social në Kosovë, aktivitetet e nivelit të ulët ekonomik dhe



papunësia, në veçanti e grave, niveli i ulët i standardit, pozita e gruas në shoqëri dhe familje (...)" (RIINVEST 2004).

Tab. 3: Shkalla e lindjeve në Kosovë

Periudha	Shkalla e lindjeve
1988 – 1993	27,0
1993 – 1998	24,9
1998 – 2003	23,0

**Burimet** : Analiza Demografike dhe Shëndetësore e Kosovës 2003 / KDHS 2003 (SOK 2004) p. 54

Edhe shkalla e vdekjes është nxjerr nga të dhënat e njëjta eksperimentale- 5,3 fatkeqësi për 1000 banorë. Kësaj shkalle duhet shtuar edhe të dhënat për vdekjen e personave në shtëpi gjatë vitit të fundit. Nëse merret në konsideratë informata shtesë, shkalla e vdekjes rritet nga 5,3 në 6 por edhe në për 1000 banorë. (KDHS 2003 / SOK 2004). Nga kjo del se, shtimi natyral vjetor në Kosovë mund të jetë 16 për 1.000 banorë. Një shkallë e shtimit prej 13 për 1.000 është dhënë nga MMPH-ja (2004; 8).

Në vitin 2004 numri i lindjeve në Gjilan ishte 1.790 dhe numri i vdekjes 433 (Statistikat jetësore; SOK 2004; Tabela. 1.17 dhe 2.11) kështu shtimi natyral ishte 1.357 persona në atë vit. Duke iu referuar popullsisë së 138.219 banorëve në Gjilan në vitin 2003, mund ti përgjigjet shtimit të popullsisë prej 9.8 persona për 1.000 banor në atë vit. Megjithëse shifrat e vetëm pak viteve nuk mund të jenë baza të sigurt për ta definuar tendencën, këto shifra megjithatë e reflektojnë tendencën e rënies së shtimit të mëparshëm të jashtëzakonshëm të popullsisë në Kosovë.

Tab. 4: Shkalla e Shtimit të Popullsisë në Gjilan

	Viti	Statistikat jetësore	1/1000 <sup>/1/</sup>	Përqindja <sup>/2/</sup>	Shkalla
Popullsia			133.724		
Lindjet		1.906	14,3		Shkalla e lindjes
vdekjet		373	2,8		Shkalla e vdekjes
	<b>2002</b>	<b>1.533</b>	<b>11,5</b>	<b>1,146</b>	<b>Shkalla e shtimit</b>
Popullsia			135.953		
Lindjet		1.648	12,1		Shkalla e lindjes
Vdekjet		429	3,2		Shkalla e vdekjes





	2003	1.219	9,0	0,897	Shkalla e shtimit
Popullsia			138.219		
lindjet		1.790	13,0		Shkalla e lindjes
vdekjet		433	3,1		Shkalla e vdekjes
	2004	1.357	9,8	0,982	Shkalla e shtimit

**Shënim:** /1/ Shtimi natyral i popullsisë: Banor shtesë për 1.000 banor të atij viti  
/2/ përqindja e popullsisë të atij viti sipas treguesve

**Burimet:** vlerësimi i popullsisë i vitit 2002 ff.: Instituti Kombëtar I Shëndetit Publik,  
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim; Zyra Rajonale për Statistikë-Gjilan;  
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Gjilan;  
vdekjet dhe lindjet: Statistikat jetësore të Kosovës 2002, 2003, 2004 (SOK 2004, 2005);  
shkallët: llogaritjet IWU

Zhvillimi i mënyrës së sjelljes së mirë të lindjes në Kosovë. P.sh. shkalla e shtimit natyral është bazë e rëndësishme e pasigurisë së prognozave mbi shtimin popullsisë. Sa për llogaritje, është përdorur shkalla e shtimit natyral të tanishëm, rezultatet e llogaritura mund ta përfshinë një mbivlerësim të zhvillimit të popullsisë nga parashikimi prej 15 viteve të ardhshme.

## Migrimi

Duke e marr parasysh perspektiven e paqartë të ekonomisë në Kosovë dhe në veçanti zhvillimin ekonomik në komunën e Gjilanit, është e vështirë që të identifikohet balancimi i migrimit në Gjilan dhe jashtë Gjilanit . Sipas shifrave të dhëna për migrim, të dhëna nga Analiza Demografike dhe Shëndetësore të vitit 2003 (SOK 2004) për shtat rajone<sup>3</sup> balancimi i migrimit brenda Kosovës ishte pozitiv në kuptimin e plotë vetëm në rajonin e Prishtinës.

<sup>3</sup> Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Peja, Prizreni, Prishtina dhe Ferizaj; Regjioni i Gjilanit përfshinë Kamenicën dhe Novobërdën



Burimi: UNFPA/SOK/IOM 2000

Fig. 5: Rajonet e analizuarra për balancimin e tyre të migrimit

Të dhënat për migrimin janë mbledhur për migrimin e tërë jetës, (personat që kanë lindur në një komunë tjetër dhe janë shpërngulur në vendin e tanishëm në cilëndo kohë të jetës deri më sot,) dhe migrimet e brendshme pesë vjeçare (p.sh. migrimet në vendet e tanishme gjatë pesë viteve të fundit, të dhënat e mbledhura për të gjithë personat pesë vjeç dhe më të vjetër. Nuk duhet të harrohet se, në krahasim me faktorët ekonomik, gjithashtu efektet e shtypjes etnike, trazirat civile dhe lufta në dekadën para viti 2000 e kanë shkaktuar migrim domethënës i cili është pasqyruar në shifrat e mbledhura nga SOK. Meqenëse kushtet për të ardhmen në këtë aspekt me shpresë janë të ndryshme, është e pamundur të nxirret evidenca për të ardhmen në kohën e matshme precize nga shifrat e dhëna nga SOK, mbi migrimin në Kosovë. Por megjithatë ato mund të japin orientim të sigurt.

Tab. 5: Balancimi i migrimit

Rajoni i lindjes	Neto Migrimi përfundimtar i jetës deri në vitin 2003	
<b>Renditja e rajoneve</b>		<b>Neto migrimi vjetor i gjallë periudha pesë vjeçare 1998 – 2003</b>
Gjilan	- 9.400	+ 300
Gjakovë	- 9.400	- 2.100
Mitrovica	- 6.700	- 6.200
Peja	+ 7.800	+ 3.300
Prizren	- 5.400	+ 500
Prishtina	+ 22.500	+ 7.000
Ferizaj	+ 600	- 2.800

Burimi: Analiza Demografike dhe Shëndetësore / KDHS 2003 (SOK 2004)



Në rajonin e Gjilanit jeta jashtë komunës është ndër më të lartat në Kosovë. Megjithatë, ka pasur një rritje të popullsisë në periudhën prej vitit 1998 – 2003, ndoshta ngase rajoni nuk ka pasur vuajtje nga lufta aq sa kanë pasur rajonet tjera, dhe si pasoj i ka tërhequr refugjatët nga zonat e luftës.

Shtimi i 300 personave nga migrimi që kanë ardhur në rajonin e Gjilanit-dhe madje më pakë në komunën e Gjilanit –në periudhën pesë vjeçare 1998 – 2003 nuk mund të jenë baza për identifikimin e tendencës për migrim. Megjithatë, shqetësimi i jashtëzakonshëm politik dhe ndryshimet fundamentale ekonomike që e shënojnë këtë periudhë, nuk e lejojnë që thjesht të zgjatën shifrat në të ardhmen. Rritja e popullsisë nga migrimi, megjithatë nuk është shumë i kënaqshëm. Por askush nuk e din sot se si do të zhvillohet migrimi.

Argumenti është sjell përpara atyre njerëzve në Kosovë që kërkojnë punë jashtë komunës së banimit të tyre të përhershëm, mund ti kërkojnë dhe gjejnë ato më tepër jashtë vendit se sa në rajonet e Gjilanit të zhvilluara më shumë ekonomikisht, p.sh. në zonën e Prishtinës dhe përreth. Ata nuk mund të lëvizin brenda Kosovës pa ofertë të qartë për punë, dhe më shumë shpresë për të gjetur një punë më të lehtë tjetërkund. Shifrat e fundit nga IES (Iniciativa Evropiane për Stabilitet) bazuar në studimet relative në komunitetet e vogla e provojnë këtë supozim. Ato tregojnë se njerëzit pa punë kanë përfitim nga rrjeti i të afërmeve në shtëpinë e tyre në fshat ose në qytet. Gjithashtu është supozuar se orientimi i bizneseve në Kosovë është më tepër lokal, dhe kështu ata preferojnë që të zhvillojnë vendet e caktuara sesa të shikojnë për më shumë vende qendrore. Si pasoj migrimi në rajonin e Prishtinës nuk mund të motivohet ose nxitet nga mungesa e zotimit të vetëm. Vetëm zhvillimi i biznesit aty dhe mundësit aktuale për punë mund ti stimulojnë ose tërheqin migrimin e motivuar ekonomik.

Nëse, një zhvillim ekonomik mund të ndodhë në Gjilan, është e paqartë nëse do mund ta tërheq imigrimin substancial. Mund të jetë vetëm një rast nëse bëhen investimet e mëdha industriale në Gjilan, dhe si pasoj krijohen mundësi të punësimit që mund ta tejkaloj kapacitetin e fuqisë punëtore në Gjilan, në llogari të sasisë dhe profesionit. Kjo më shumë është si në rast të përparimit të përgjithshëm ekonomik, rajonet tjera në Kosovë mund ta provojnë një zhvillim krahasues të përshtatshëm dhe që udhëhiqet nga rajoni i Prishtinës. Si shtesë shkalla e lartë e papunësisë dhe punësimit të pjesshëm duhet të merren në konsideratë. Kjo mund



të pritët që në një hapësirë të madhe, fuqia punëtore në Gjilan do të mund ti absorbojë shumicën e punëve lokale që krijohen.

Për më shumë, pritja e përgjithshme e statusit të ardhshëm të Kosovës është të jetë pak a shumë entitet i pavarur politik i anëtarësuar fuqishëm në BE. Kjo mund ta hap rrugën për një shtim jashtë migrimit të vendeve të lira të fuqisë punëtore dhe familjeve të tyre.

Duke e marr parasysh këtë mjedis të zhvillimit ekonomik të komunës së Gjilanit, ne e kemi supozuar një balancim negativ të migrimit, duke qenë më shumë si balancë i përshtatshëm sesa pozitiv, duke mos i ditur dimensionet e mundshme të migrimit të jashtëm. Brenda limiteve të komunës, ne e presim lëvizjen e njerëzve që jetojnë nëpër fshatra për në qytet, të cilët e provojnë dhe e fitojnë jetesën e tyre aty. Ky migrim i brendshëm nuk mund të llogaritet pasi që të dhënat substanciale nuk janë të gatshme. Megjithatë kjo mund të konsiderohet si kërkesë e ndërtimit por infrastruktura është shqetësuese.

Tri alternativa për balancimin e migrimit të komunës së Gjilanit janë llogaritur:

- Një barazim i balancimit të migrimit,
- Një migrim i jashtëm i 100 personave për një vit ose 0,7 persona për 1,000 banorë,
- Një migrim i jashtëm i 250 personave për një vit ose 1,8 persona për 1,000 banor.

Llogaritjet është bërë në bazë të të dhënave mbi popullsinë në tërë komunën, si të dhëna detale (mosha grupore dhe proporcioni i gjinisë) për qytetin e Gjilanit ose vetëm kur nuk janë të gatshme. Efekti numerik i migrimit ishte kombinuar me fitimin nga shtimi natyral të Gjilanit. Numri i banorëve për vitin bazë 2002 është marr nga baza e të dhënave të komunës: 139.558. Zhvillimi i popullsisë është shpërndarë ndërmjet qytetit dhe fshatit në proporcionin e dhënë për 2002 (79.000 deri 40.588).



## Llogaritjet

Për parashikimin e zhvillimit të popullsisë është aplikuar metoda biometrike. Moshat grupore për çdo vit të vetëm janë kryer përpara në llogaritje vit pas viti në lidhje me komponentët në vijim: lindjet, vdekjet, fitimet nga migrimit, humbjet nga migrimi. Metoda mund të përshkruhet nga formula në vijim:

Formula për llogaritje: numri i lindjeve në vitin e parë ( $a = 1$ ):

$$B_m(a)_{t+1} = G_m t+1$$

Duke qen

45

$$G_m t+1 = \sum_{a=1}^{45} B_w(a)_t * f_q(a)_t * q_{sex}$$

Formula për llogaritje: numri i lindjeve në vitet në vijim ( $a = 2$  deri në 100):

$$B_m(a)_{t+1} = B_m(a)_t * (1 - S_m(a)_t) + Z_m t * q_{zm}(a)_t - (B_m(a)_t * q_{fm}(a)_t)$$

$$B_w(a)_{t+1} = B_w(a)_t * (1 - S_w(a)_t) + Z_w t * q_{zw}(a)_t - (B_w(a)_t * q_{fw}(a)_t)$$

Fig. 6: Formula për llogaritje

**Burimi :** IWU

### Shpjegimet e simboleve:

$B_m(a)_t$  = proporcioni i gjinisë mashkullore i moshës grupore në vit  $t$

$B_w(a)_t$  = proporcioni gjinisë femërore i moshës grupore në vit  $t$

$B_m(a)_{t+1}$  = proporcioni i gjinisë mashkullore i moshës grupore  $a$  në vit  $t+1$

$B_w(a)_{t+1}$  = proporcioni i gjinisë femërore të moshës grupore  $a$  në vit  $t+1$

$G_m t+1$  = lindjet e gjinisë mashkullore në vit  $t+1$

$q_{sex}$  = faktorët për proporcionin e gjinisë

$S_m(a)_t$  = mundësia e mortalitetit të moshës së burrit  $a$  në vit  $t$

$S_w(a)_t$  = mundësia e mortalitetit të moshës së gruas  $a$  në vit  $t$

$Z_m t$  = imigracionet e personave të gjinisë mashkullore në vit  $t+1$

$Z_w t$  = imigracioni i personave të gjinisë femërore në vit  $t+1$

$q_{zm}(a)_t$  = proporcioni i burrave të imigruar të moshës së  $a$  i të gjithë burrave të imigruar

$q_{zq}(a)_t$  = proporcioni i gruas të imigruar të moshës  $a$  i të gjitha grave të emigruara

$q_{fm}(a)_t$  = mundësia e emigracionit të burrit të moshës  $a$  në vit  $t$

$q_{fw}(a)_t$  = mundësia e emigracionit të gruas të moshës  $a$  në vit  $t$

Si baza për konkluzionet e mëtejshme është marr vlera bazë prej 139.558 banor në vitin 2002, nga baza e të dhënave të Komunës së Gjiçanit si një vlerësim i atij viti. Për këtë shifër nuk kanë ekzistuar diferencim



demografik i mëtejme. Kështu që diferenca e moshave grupore prej pesë viteve dhe gjinia është bërë në vazhdim të të dhënave dhe proporcionit të dhënë nga IOM 2000<sup>4</sup>. Ndarja e mëtejme e grup moshave dhe gjinisë nga të dhënat pesëvjeçare në ato vjetore, është vlerësuar sipas mënyrës empirike Gjermane (bazuar në rajone, qyteti me fshatra, duke ju referuar situatës në Komunën e Gjiçanit).

Për parashikimin e lindjeve janë përdorur shkallët e lindjes, të ndryshuara me moshat e nënave. Përderisa këto të dhëna nuk ishin të gatshme për Gjiçanin, është aplikuar shkalla e lindjes së Gjermanisë Perëndimore, që është adoptuar në bazë të shifrave të lindjeve të gjalla në Gjiçan të dokumentuara në Statistikat Jetësore të Kosovës (SOK 2004).

Parashikimi i mortalitetit është i ngjashëm bazuar në shkallën e mortalitetit të Gjermanisë Perëndimore, duke qenë i ndryshëm për gjininë dhe moshat grupore një vjeçare. Për ta adoptuar probabilitetin e mortalitetit të situatës në Gjiçan, niveli i mortalitetit është korrigjuar respektivisht në bazë të shifrave të Gjiçanit në Statistikat Jetësore të Kosovës (SOK 2004).

- S** Përparësitë
- Shtimi natyral i popullsisë ka qenë shumë i lart në të kaluarën,
  - Megjithëse, gradualisht ka zbritur, në dekadat e fundit, në krahasim me vendet tjera në rajon, është shumë e lartë.
- W** Mangësitë
- n/a.
- O** Mundësitë
- Edhe pse një rënie substancial i banorëve duhet të përballet në vitet që vinë, popullsia në Gjiçan, ende është duke u rritur.
- T** Kërcënimet
- Gjendja e dobët e ekonomisë lokale, dhe mungesa e shkallës së lart të prodhimit të industrisë së mëparshme, ka shkaktuar mungesën e kushteve për punë, që mund ta detyroj pjesën substancialë të popullsisë aktive që ta lënë Gjiçanin ose edhe

<sup>4</sup> Organizata ndërkombëtare për migrim / IOM: Kosovo. Demographic, socio-economic and reproductive health survey. Basic results. May 2000; tab. 36, p. 81g;



## qëllimet

Kosovën, për ta fituar jetesën e tyre diku tjetër .

- Veprimi i rritjes së popullsisë është një sfidë për komunën që të kujdeset për kushte të përshtatshme të jetës, gjithashtu rritja e popullsisë për të gjetur kushte të përshtatshme për jetesë në Gjilan, dhe të mund ta fitojnë jetesën e tyre në vend.
- Prioritet i parë, si pasoj, merr mbështetjen e zhvillimit ekonomik, veçanërisht të SME-së, që mund të ketë efekte të fuqishëm, në shfaqjen e vendeve të reja të punës.
- Kërkesat e ardhshme për infrastrukturë sociale dhe teknike, duhet të parashihen, dhe duhet të sigurohen pajisje përkatëse dhe të instaluar.

## Banimit-Gjendja

### Numri i Familjeve

Ekzistojnë shumë paqartësi rreth numrit të familjeve në Gjilan. Nuk ka të dhëna aktuale të sigurt që janë të gatshme mbi familjet banues në Gjilan. Duke i marr parasysh efektet e shkatërrimit dhe banimit gjatë luftës, dhe rindërtimet e viteve të para të pas luftës, pa leje të ndërtimit dhe planifikimit regresi i të dhënave të vjetra mund të jetë edhe më çorientuese. Deri më tani janë të gatshme vetëm të dhëna shumë përgjithshme për kuptimin më të mirë të situatës së tanishme, që janë nxjerr nga disa analiza, dhe në shumicën e rasteve janë të bazuara në vlerësim ose i referohen Kosovës si tërësi .



Tab. 6: Të Dhëna përgjithshme mbi Personat për Vendbanim dhe Sipërfaqe të Banimit në Kosovë

Burimi i të dhënave		rural	urban	Kosovë
<b>Banka Botërore 2003</b>	Persona për Familje	7,1	6,1	6,7
<b>DHS 2003</b>	Persona për familje	6,8	5,5	6,4
<b>ESTAP 2002</b>	Persona për familje 2001			5,4
	Vlerësimi 2015 (shtimi i i lart/mesëm/i ulët )			4,0 / 4,5 / 5,0
<b>IWU</b>	Madhësia e vendbanimit		67 m <sup>2</sup>	74 m <sup>2</sup>
	Hapësira banuese për të mëdhenj		11 m <sup>2</sup>	11,5 m <sup>2</sup>

**Burimi:** Programi i Ndihmës Teknike në Sektorin e Energjisë (ESTAP) raporti Final; (UNMIK 2002)  
 Analiza Demografike dhe shëndetësore e Kosovës 2003 (SOK 2004)  
 vlerësimet e IWU për madhësinë e vendbanimit bazuar në numra në Rajonin e Prishtinës

Numri i anëtarëve për familje në Kosovë është 6,4; shifrat janë diçka më të vogla në zonat urbane (5,5) dhe pak më i lart në zonat rurale (6,8) (DHS 2003 / SOK 2004). Në një krahasim Evropian numri i përqindjes së personave për familje në Kosovë është shumë i lartë. Në UE 25 ndryshon rreth 2,2 – 2,5 persona për familje në një shtrirje ndërmjet 1.9 në Suedi dhe 3.0 më Qipro dhe Malta (Bordi Kombëtar i Suedisë 2004). Numri i personave për familje varet edhe prej standardeve kulturore dhe kushteve ekonomike. Ne e përjashtojmë atë si modeli tradicional i familjeve, duke qenë bazë për familje të mëdha të gjeneratave të ndryshme që jetojnë së bashku do të ndryshojnë. Në të ardhmen, me gjasë, njerëzit e ri preferojnë që të jetojnë vetëm nga vetvetja dhe të jenë të pavarur – prindërit dhe fëmijët – familja. Kjo tendencë, që është e pranueshme në tërë Evropën, dhe me sa duket edhe në Kosovë duhet të jetë shumë e fortë, nëse përmbajtjet ekonomike nuk i mbrojnë shumë njerëzit e ri që tanimë ti bëjnë atë në ditët e sotme. Shansi për njerëzit e ri që ti krijojnë familjet vetë, megjithatë, varet nga gjendja ekonomike. Sidoqoftë, sipas kushteve të shtimit të rëndë ekonomik në Kosovë, është supozuar se deri 2015 numri mesatar i familjeve nuk është i përshtatshëm, nuk bie më poshtë se 4.0 persona (ESTAP, UNMIK 2002).

Sipas Studimit Mozaik të Kosovës (UNDP 2003), numri i banorëve në familje në Gjiçan është më i vogël se sa i fshatrave përreth (pyetja D15). Në qytet një familje katër anëtarësh është më e zakonshme (24% në vetëm 9% në fshatra), përderisa në fshatra 19% e familjeve përbëhet





nga 8-9 persona (krahasuar me 7% në qytet ) dhe 11% i dhjet ose më shumë personave (krahasuar me 4% në qytet ). Numri i vogël relativ i banorëve të familjeve në zonat urbane krahasohet me ato në zonat rurale e që është në përputhje me rezultatet e Analizave Demografike në Kosovë në vitin 2003 (DHS 2004). Shifrat e dhëna në këto analiza janë një përqindje prej 6.4 persona për familje në Kosovë; për më tepër i caktuar prej 6.8 në zonat rurale dhe 5.5 persona për një familje në zonat urbane.

Tab. 7: Zhvillimet e Familjeve 2002 / 2020 (vlerësimi i përafërt)

Gjiçan	Banorët 2002 /1/	Personat për familje	Numri i familjeve	Banorët 2020 / Migrimi 0	Personat për familje /4/	Numri i vlerësuar për familje	Shtimi i pritur / i plotë
Komuna	<b>139.558</b>	5,9	23.723 ←	161.395	5	32.279	<b>8.500</b>
Qyteti	<b>79.000</b>	<b>5,5</b> /2/ →	14.364 ↑	91.361 ↑	4,5	20.302	<b>6.000</b>
Fshatrat	<b>40.558</b>	<b>6,5</b>	<b>9.359</b> /3/ ←	70.034 ↑	6	11.672	<b>2.300</b>

**Vërejtje:** /1/ vlerësimi i popullsisë 2002 nga komuna (baza e të dhënave ),  
/2/ personat për familjet urbane në Kosovë; cf. DHS (SOK 2003);  
Numri i familjeve në Komunë (duket i dyfishtë ) të kalkuluakan këtë shkallë  
/3/ shifrat e dhëna nga baza e të dhënave nga Komuna (vlerësimi 2002)  
/4/ personat për familje bazuar supozimet dhe krahasimet me kombësitë në Rajon  
**Burimet :** Banorët : Profili i komunës (OSCE 2005); personat për familje : DHS (SOK2003);  
Baza e të dhënave komunale (vlerësimi 2002); Ilogaritet e IWU

Përbërja e familjeve në Kosovë nuk është e kufizuar vetëm në prindër dhe fëmijë. Familjet me tri gjenerata janë plotësisht të përbashkëta dhe familjarët e pa martuar mund të integrohen në familje. Kjo mund të shpije në kritere të ndryshme për statistika në familje..

Sa për shkallën e personave në familje në Gjiçan, vlerësimi i Komunës i vitit 2002 (baza e të dhënave komunale) nuk janë në përputhje me përfundimin e Studimit të Mozaikut dhe me shkallën për Kosovën si tërësi. Megjithatë, numri i personave për familje i dhënë për fshatra është në harmoni me shifrat për Kosovën. Shifrat e dhëna për qytetin e Gjiçanit<sup>5</sup>, megjithatë, nuk duken me qenë të besueshme. Kështu që kemi vendosur

<sup>5</sup> Findings of the municipal data base / estimate of 2002:

	inhabitants	households (families)	persons / household
municipality	139.558	16.659	8,4
town	79.000	7.300	10,8
villages	40.558	9.359	6,5



ta bazojmë llogaritjen e zhvillimit të familjeve të qytetit të Gjilanit në shkallën e Kosovës.

Bazuar në shkallën e Kosovës (DHS 2003) dhe vlerësimin e Komunës të vitit 2002 (baza e të dhënave) i specifikuar për zonat urbane dhe rurale, numri i familjeve në Gjilan është 14.400 në qytet dhe 9.300 në fshatra, duke arritur shumën në 23.700 familje në komunë, të cilët mundën me genë të barabartë në një shkallë e përqindjes prej 5,9 persona në familje.

Nëse të arriturat për zhvillimin e familjeve janë të sakta, si rezultat i strukturës së zhvillimit të popullsisë dhe familjeve do të ketë kërkesa për vendbanime shtesë (duke iu referuar numrit të familjeve për vitin 2002) për rreth:

- 8.500 familje në komunë,
- 6.000 prej tyre në qytet dhe
- 2.300 në fshatra.

Shifrat përafërsisht do të ndryshojnë me këtë vlerë sipas shkallës së migrimit dhe strukturës së familjeve. Shtimi natyral është faktori i vetëm i zhvillimit bazuar në llogaritjet në më shumë ose më pak shifra të përshtatshme.

### Madhësia dhe standardi i vendbanimeve

Sipas Analizave Buxhetore të Familjeve prej vitit 2003 (SOK 2003), numri i përqindjes së dhomave të vendbanimit në Kosovë është 2,9 (në vendet urbane 2,7 dhe rurale 3,1). Vlerësimet paraprake të dhëna në "Analiza Demografike e Kosovës për vitin 2003" (SOK 2004), janë pak më të larta (zona urbane 3,0; zona rurale 3,4). Pyetja mbi numrin e dhomave e përdorur në dy hulumtime, megjithatë, nuk është saktësisht i njëjtë (SOK 2003, p.6); të dhënat mbi madhësinë e vendbanimit (sipërfaqja nga m<sup>2</sup>) nuk ishin përfshi në analiza. Të dhënat mbi hapësirën banuese për të rritur janë përfshi me studimin ESTAP të vitit 2002 (UNMIK/ESTAP/Banka Botërore 2002).



Tab. 8: Familjet me numër të dhomave në Kosovë (zonat urbane/rurale)

Numri i dhomave	Kosovë	Zonat urbane	Zonat rurale
1	10%	11%	9%
2	35%	41%	32%
3	25%	26%	25%
4	20%	16%	22%
5	4%	3%	5%
6	3%	2%	3%
7 dhe më shumë	2%	1%	3%
Totali	100%	100 %	100%

**burimi:** Analiza e Buxhetit të Familjeve të 2003 / banimi në Kosovë (SOK 2003)

Megjithëse disa të dhëna mbi standardin dhe numrin e dhomave të vendbanimit në Komunën e Gjiçanit janë dhënë nga Studimi Mozaik i vitit 2003, numri i vogël i përgjegjësve nuk mund të shpërndaj të dhënat përfaqësuese për tërë komunën e Gjiçanit. Rezultatet e analizave, megjithatë mund ta japin një përshtypje të gjendjes e cila është në harmoni me gjendjen në Kosovë. Të dhënë më lartë vërtetojnë se familjet janë më të mëdha në fshatra, si edhe vendbanimet. Lloji i banimit ekzistues nga larg është i veçantë, shtëpi e vetme familjare, është lloj ekskluziv i banimit në fshatra, përderisa, banimi kolektiv në shumicën e rasteve është i kufizuar në qytetin e Gjiçanit. Në vend standardi teknik i vendbanimeve është i ulët, tashmë pothuajse shumica e familjeve janë pajisur me energji elektrike.

Tab. 9: Numri i Banorëve për Vendbanim në Gjiçan

(baza e përgjegjësve)	Përgjegjësit total (200 persona )	Zonat rurale (80 persona)	Qytet/qytet-shtet (120persona)
1-2	3%	1%	3%
3	9%	10%	8%
4	18%	9%	24%
5	21%	19%	22%
6	17%	15%	18%
7	15%	16%	13%
8-9	12%	19%	7%
10 and more	7%	11%	4%

**Burimi:** Studim Mozaik Gjiçan (UNDP 2003). Pyetja D 15: Sa njerëz janë duke jetuar këtu tani?



Tab. 10: Lloji I banimit në Gjiçan

Baza e përgjegjësve)	Përgjegjësit total (200persona)	Zona rurale (80persona)	TQytet /Qytet, shtet (120persona)
Vendbanimet shumë- familjare	2%	-	3%
Shtëpitë e kufizuara për një familje të vetme	99%	100%	98%

**Burimi:** Studim Mozaik Gjiçan (UNDP 2003)

Tab. 11: Standardi teknik i vendbanimeve në Gjiçan

Baza e përgjegjësve))	Përgjegjësit total (200persona)	Zona rurale (80persona)	qytet /Qytet, shtet (120 persona )
Lidhja e furnizimit me ujë	58%	14%	88%
Ujërat e zeza /sistemi publik sanitar	61%	10%	94%
Nxemja qendrore	2%	-	3%
Energji elektrike	92%	99%	87%
Asnjërën	2%	1%	3%

**Burimi:** Studim Mozaik i Gjiçanit (UNDP 2003)

### Vlerësimi i Kërkesave të Banimit për të Ardhmen

Kërkesat e banimit për të ardhmen mund të identifikohen duke i përmbledhur kërkesat e ndryshme që janë kalkuluar në mënyrë të ndarë:



Tab. 12: Përcaktuesit e Kërkesave për të Ardhmen

<b>Kërkesa</b>	<b>I shkaktuar nga</b>	<b>Bazat kalkuluase</b>
Kërkesat e pakryera	Banimet që nuk i zgjedhin standardet e sotme të kërkesat	Numri i familjeve në kohën e tashme numri i vendbanimeve në kohën e tashme (boshllëku i tanishëm ndërmjet furnizimit dhe kërkesave standarde)
Kërkesat e reja	ritja e numrit të familjeve që kërkojnë vendbanime	Numri i familjeve aktualisht numri i familjeve në kohën e prognozave
Kërkesat e zëvendësuese	Zëvendësimi i banimit i marrur nga tregu – p.sh. jashtë përdorimit, të përdorura ndryshe ose të shkatërruara	Reduktimet vjetore të familjes banuese (përqindja)
Kërkesa më të mëdha për shkak të rritjes së të ardhurave	Të ardhurat më të larta i lejojnë vetes vendbanime më të mëdha për më shumë familje	Eksperienca afatgjate bazuar në seritë e kohës

Rezultatet e katër llogaritjeve të kërkesave janë përmbledhur për ta nxjerr shumën e kërkesave për të ardhmen. Si bazë për llogaritjet e më tutjeshme – numri aktual i vendbanimeve – është i panjohur. Supozime të prognozave në vazhdim mund të japin vetëm orientime të përafërta.

### Kërkesat e pakryera

Numri i njerëzve që jetojnë së bashku në një vendbanim është mjaft i madh. Sipas përfundimit të Studimit Mozaik, në dy të tretat e vendbanimit pesë dhe më shumë banor jetojnë së bashku. Edhe më shumë banor jetojnë në nëpër vendbanime në zonat rurale (UNDP 2003, D15). Nëse secila familje në Gjilan që dëshiron të jeton vetëm ka vendbanimin e vetë, atëherë numri i vendbanimeve duhet të jetë më i madh sesa që është tani. Mundet me qenë e pasigurt një shpërbërje radikale e familjeve tradicionale me shumë gjenerata në Kosovë, që është një objektivë e mundshme dhe e dëshirueshme për shumicën e popullsisë. Me sa duket tani për tani nuk ekzistojnë këtë rrethana.

Megjithatë, kushtet dhe niveli i të ardhurave familjare në Gjilan, nuk janë në gjendje të zhvillohen në atë mënyrë që vendbanimi privat i vetëm, mund ti lejon vetës që çdo njësi e vogël familjare, ose person i vetëm mbi moshën 20 vjeçare, së paku, si shtresë shoqërore me të ardhura të



vogla, janë shqetësuese. Edhe pse parashikimi bazohet në vlerësimin më optimist të zhvillimit ekonomik, kërkesat e pakryera do të jenë të kënaqshme vetëm pjesërisht, ose shumë pakë, nëse vlerësimi është bazuar në shtimin ekonomik më të ulët.

### Kërkesat e reja

Kërkesat e reja janë si rezultat i parashikimit të zhvillimit të numrit të familjeve (siç është paraqitur më lartë). Mund të supozohet se, numri i personave për familje do të rritet dhe hapësira e banimet do të shtohet. Kështu, numri i familjeve do të rritet diçka më shpejtë se popullsia. Në çfarë shkalle kjo kërkesë e re mund të jetë e kënaqshme, varët prej zhvillimit ekonomik. Një numër prej 4,5 personash për familje në vitin 2020, është supozuar për qytet, 6 për fshatra, dhe 5 për komunën në tërësi. Duke iu referuar rritjes së familjeve nga viti 2002 – 2020 familjet banuese do të rriten përafërsisht në 6.000 vendbanime në qytetin e Gjilanit dhe përafërsisht 8.500 vendbanime në tërë komunën.

### Kërkesat zëvendësuese

Varësisht nga zhvillimi i të ardhurave, kërkesat për banim për familje do të zhvillohen proporcionalisht. Një rritje e të ardhurave do të shkaktoj kërkesa më të larta në lidhje me pajisjet, kualitetin dhe gjendjen e vendbanimit. Një pjesë e vendbanimeve të familjeve banuese do të kthehen në vendbanime më të mëdha dhe më të gjëra. Disa do të përdoren për nevoja tjera por edhe për banim p.sh. pajisje komerciale, dhe disa do të shkatërrohen. Një ndërtim i ri do ta zëvendësoj të vjetrin. Ne e supozojmë shkallën e zëvendësimit të vendbanimit prej rreth 0,5% të familjes për çdo vit ose rreth 8 deri 10 % të familjeve banuese të tanishme mbi pesëmbëdhjetë vite. Megjithëse një pjesë e vendbanimeve që mund të zëvendësohet në të njëjtë tokë, do të krijoj kërkesa shtesë për tokë ndërtimore. Duke e marr parasysh dendësinë e ulët për zona të reja të vendbanimit dhe hapësirë më të madhe të vendbanimeve të reja, kërkesa e re për tokë ndërtimore mund të jetë rreth dimensioneve të tokës së zënë nga vendbanimet e zhdukura më parë.

### Kërkesat e larta për shkak të rritjes së të ardhurave

Kjo mund të jetë më shumë realiste në vend të një analize të nevojave, siç është provuar më lartë, për ta bazuar planifikimin strategjik në baza llogaritëse mbi analizat e përkrahjes së pushtetit. Për shkak të faktorëve



të ndryshëm që i kemi vlerësuar, GDP në Kosovë është pritur të stagnojë në vitet e ardhshme. Në përfundim, është pritur që ekonomia të rritet, së pari në mënyrë përmbajtjesore dhe pastaj më fuqishëm. Sidoqoftë këto pritje do të përmbushën vetëm nëse plani i veprimeve optimist i zhvillimit do të barazohet me realitetin më të mirë të së ardhmes. Në këtë rast mund të pritet që përqindja e hapësirës banuese për të rritur do të mund të rritej nga 11 metër katror sot në afërsisht 15 metra katror në fund të periudhës së paraparë.

### Perspektivat për Planifikim dhe Ndërtim

Aktivitetet për riparimin dhe ndërtimin e shtëpive të shkatërruar ose të rrënuara për shkak të rrethanave të luftës (EU/IMG 1999/2000), kanë filluar menjëherë pas përfundimit të saj. Një numër i dallueshëm i shtëpive të ndërtuara pas luftës dëshmojnë aftësitë e njerëzve dhe familjeve në Gjilan që të përballën me kushte shumë të vështira ekonomike dhe të ia dalin mbanë të bëjnë shtëpi të reja për qëllimet e tyre vetjake. Asnjë qeveri shtetërore nuk ka qenë e gatshme ti krijoj ato në kohën dhe sasi të njëjtë. Për shkak të arritjes së ndërtimit me vetë-ndihmë dhe mungesa e mbështetjes profesionale dhe mbikëqyrjes cilësore, megjithatë, në të gjitha rastet nuk mund ti prekin standardet profesionale të ndërtimit. Një problem tjetër gjerë i shpërndarë është mungesa e standardeve të planeve urbane, veçanërisht menjëherë pas luftë planet rregulluese nuk janë respektuar, ose ndërtimet ishin vendosur në zonat ku nuk ekzistonin planet rregulluese, zona të cilat nuk ishin të lejuara për ndërtim.

Është më shumë e evidente, se me ndihmën e ndërsjellë të familjeve një pjesë domethënëse e popullatës kanë qenë të zotët të ndërtojnë shtëpitë e tyre, duke e siguruar sistemimin e tokës së nevojshme për ndërtim. Në fshatrat ku janë shtëpitë e vetme, forma ekzistuese e pjesës së ndërtimit të vendbanimeve për shtëpi shtesë mund të përgatitet më lehtë brenda strukturës ekzistuese të vendbanimit ose në periferitë e tyre. Megjithatë, në qytet, është i nevojshëm ndryshimi i ndërtesave të banimit. Në hapësirat e mëdha, familjet mund të ndërtojnë shtëpitë e tyre në mënyrë të vetme të pavarur ose gjysmë të varur, por megjithatë prapë ekziston nevoja e banimit kolektiv, qiradhënies dhe bashkëpronësisë, veçanërisht për familje të vogla, të cilët nuk janë në gjendje të ndërtojnë shtëpitë e tyre të veta. Megjithatë për ndërtimin e ndërtesave për banim kolektive janë të nevojshëm investitorët dhe mjeshtërit profesionale. Çfarëdo zhvillimi i mëtutjeshëm i vendbanimit në qytet duhet të orientohet në planet rregulluese urbane me qëllim të



organizimit më të mirë të ndarjes së llojeve të ndryshme të ndërtesave banuese, për të pas shpresa për tokën ndërtimore dhe vlerën e investimeve.

Prognozat më precize, mund të merren në bazë të dhënave të sakta të regjistrimit të përgjithshëm duke iu referuar vetëm popullsisë dhe familjeve ekzistuese banuese. Deri më sot nuk ka të dhëna të gatshme mbi sasinë e tepër të madhe të ndërtimeve të reja të kryera pas luftës. Me sa duket shumica e tyre janë akoma në ndërtim dhe nuk janë në përdorim ose vetëm pjesërisht janë të uzurpuara. Sasia e këtyre rezervave ë banimit potencial është e panjohur dhe vetëm mund të vlerësohet.

Nga të dhënat e mësipërme mbi popullsinë, madhësia e familjes dhe hapësira për banim supozime komplementare janë marrë:

- Indeks i mesatar i sipërfaqes prej 0.8 në zonë të qytetit
- Indeks i mesatar i sipërfaqes prej 0.4 në zona të fshatrave,
- Një raport mesatar neto / bruto të tokës ndërtimore prej 0.7 (qytete dhe fshatra).

Përfundimisht, numri i njësive për banim, që për momentin janë në ndërtim ose janë të zbrastë për arsye tjera, janë vlerësuar përafërsisht 5%. Kjo përqindje është nxjerr prej kërkesave të kalkuluar në të gjitha vlerësimet.

Për shkak të planifikimit urban, nevoja për tokë në qytetin e Gjiçanit dhe fshatrave përreth duhet shqyrtuar ndaras. Pika kritike për shpërndarjen e nevojës për tokë në qytet dhe fshatra është faktor i migrimit ndër komunal (migrimi prej fshatrave në qytet). Sipas ekspertëve lokal, është një trend konstant i migrimit prej fshatrave në qytet. Sasia e migrimit ende nuk është e ditur.

Si pasojë e dallimit ekonomik në mes qytetit dhe fshatrave si dhe struktura e moshës së popullsisë në fshatra, parashihet një migrim ndër komunal prej 10% të popullsisë. Kjo konsideratë është inkorporuar në llogarinë e shpërndarjes së tokës.


Nevoja për tokë ndërtimore në **fshatra** të komunës së Gjiçanit pritet deri 2020:





- 172 ha, nëse bilanci i migrimit të jashtëm është i njëjlojtë (i.e. migrimi në dhe prej komunës së Gjilanit),
- 163 ha sipas mesatares prej 100 persona migrimi jashtë komunës së Gjilanit për vit, ose
- 150 ha sipas mesatares prej 250 persona migrimi jashtë komunës së Gjilanit për vit.


Fig. 7: Nevoja e llogaritur për tokë ndërtimore (fshatrat)



Nevoja totale për tokë ndërtimore në **komunën e Gjilanit** deri më 2020 është:

- 364 ha, nëse bilanci i migrimit të jashtëm është i njëjlojtë (i.e. migrimi në dhe prej komunës së Gjilanit),
- 350 ha sipas mesatares prej 100 persona migrimi jashtë komunës së Gjilanit për vit, ose
- 328 ha sipas mesatares prej 250 persona migrimi jashtë komunës së Gjilanit për vit.

Fig. 8: Nevoja e llogaritur për tokë ndërtimore (komuna)



Duhet theksuar se llogaritë e mësipërme varen në rritjen aktuale të popullsisë në komunë dhe në llogaritë e varura nga faktorët kritik për nevojat e ardhshme. Si rezultat i ndërrimeve potenciale të modelit socio-demografik, llogaritë duhet përshtatur nevoja t ardhshme.

#### **S** Përparësitë

- Bazuar në strukturat tradicionale të familjeve me vetë-ndihmë dhe ndihmë të ndërsjellë, një sasi e konsiderueshme e vendbanimeve është ndërtuar për ta lehtësuar mungesën e vendbanimeve menjëherë pas luftës, të acaruar nga shkatërrimet dhe rrënimet si dhe nga refugjatët që kërkonin strehim.

#### **W** Mangësitë

- Në lidhje me kombësitë tjera në rajon, ofrimin e standardit të banimit ende është i ulët. Mund të përmirësohet gradualisht me progresin ekonomik dhe prosperitetin.

#### **O** Mundësitë

- Mund të pritët që aktivitete individuale të ndërtimit të kontribuojnë në mënyrë domethënëse në përmirësimin e ofritit të banimit në Gjilan.

#### **T** kërcënimet

- Mund të supozohet se, modelet tradicionale të banimit në gjenerata më të mëdha familjare do ta ndryshojnë krijimin e kërkesave shtesë për vendbanim individual.

#### **→** Qëllimet

- Planet rregulluese do të sigurojnë përdorimin optimal të tokës ndërtimore dhe rregullimi i ndërtimit do të



siguroj standarde të kualitetit. Aktivitet e ndërtimit të popullsisë, megjithatë duhet të mbështetën nga ndihma profesionale.

## Arsimi

### Edukimi Parashkollorë

Në Qytetin e Gjilanit ekzistojnë 3 Çerdhe ku janë të vendosur 299 fëmijë dhe janë të punësuar 29 edukatore dhe 21 punëtorë tjerë administrativ dhe teknik.

Tab. 13: Çerdhet në Gjilan

Nr. rendor	Emri i çerdhës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i puntorëve
1.	Ardhmëria I Ardhmëria II	Gjilan	97 101	14 17
2.	Integj	Gjilan	101	19
3.	Shkollat fillore grupmosha prej 5 deri 6 vjeç - parashkollore		78	
	<b>Gjithsej:</b>		<b>299</b>	<b>50</b>

Burimi: Raportet Sektoriale

### Arsimi Fillorë dhe i Mesëm i Ulët (Arsimi i obligueshëm)

Siç është diskutuar më lartë, arsimi i obligueshëm është zgjatur në nëntë vite ku 5 vite janë arsim fillor dhe 4 vite arsim i mesëm i ulët. Paraqitja e klasës së 9-të në arsimin e obligueshëm përfshinë zhvillimin e plan-programit të ri dhe orientimin e mësimdhënësit. Viti shtesë "është vit orientimi" që u siguron nxënësve informata dhe këshilla në mënyrë që ata të kenë mundësi të zgjedhin se çfarë duan të studiojnë dhe të zgjedhin profesionin e tyre në të ardhmen.

Për numrin e nxënësve dhe shkollave në qytet merren informata më të sakta nga tabela në vijim.

Tab. 14: Shkollat Fillore në Komunë

Nr. rendor	Emri i shkollës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i punëtorëve
1.	Salami Hallaqi	Gjilan	2994	133 (6)
2.	Abaz Ajeti	Gjilan	2329	113 (3)
3.	Musa Zajmi	Gjilan	1523	73
4.	Thimi Mitko	Gjilan	3089	112 (4)



5.	Rexhep Elmazi	Gjilan	1433	64 (1)
	<b>Gjithsej:</b>		<b>11.368</b>	<b>495</b>

Burimi: Raportet Sektorale

Tab. 15: Numri i shkollave fillore, nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e obligueshëm (klasat 1-9), 2005/6

Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Proporcioni nxënës/shkollë
5	11368	2273.6

### Arsimi i mesëm i Lartë

Arsimi i mesëm i lartë përfshinë tri apo katër vite të shkollimit për nxënësit e grup-moshës 15 deri 18 vjeç.

Në Komunën e Gjilanit janë 12 shkolla të mesme dhe atë 6 në gjuhën shqipe me 6033 nxënës dhe 380 mësimdhënës, ndërsa 6 shkolla në gjuhën serbe me 799 nxënës dhe 107 mësimdhënës.

Tab. 16: Shkollat e mesme në Qytet

Nr. Rendor	Emri i shkollës	Lokacioni	Numri i nxënësve	Numri i puntorëve
1.	Zenel Hajdini – gjimnazi	Gjilan	1913	109
2.	Memet Isai – teknike		1047	73 (8)
3.	Marin Barleti – ekonomike		888	56 (1)
4.	Dr. Asllan Elezi – medicina		433	17 (2)
5.	Arbëria		632	52 (3)
6.	Muzikës		63	12 (1)
7.	Medicinës	Pasjan – Shillovë	227	16
8.	Ekonomike	Partesh Koretishtë	264	37
9.	Teknike	Kufcë	309	57
10.	Gjimnaz	Shillovë	86	25
11.	Zenel Hajdini – gjimnazi-komuniteti turk		33	4
	<b>Gjithsejt:</b>		<b>5.009</b>	<b>458</b>

Burimi: Raportet Sektorale



Tab. 17: Numri i shkollave të mesme , nxënësit dhe proporcioni nxënës/shkollë në arsimin e mesëm (klasat(X-XII), 2005/6

Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Proporcioni nxënës/shkollë
A (6+I par. e ndarë)	5009	834.83

Tab. 18: Personeli arsimor në arsimin e mesëm sipas pozitës (klasat (X-XII) 2005/6

Mësimdhënësit		Personeli administrativ		Personeli ndihmës		Gjithsej personel arsimor	
Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
266	84.98	15	4.79	32	10.22	313	100

Burimi: Raportet Sektoriale

## Universiteti

Në Gjiçan ka filluar punën Fakulteti i Edukimit me 104 studentë dhe 6 mësimdhënëës, ndërsa i vazhdojnë studimet edhe 629 studentë nga SHLP "Skënderbeu" me 19 punëtorë.

## Shkollat Speciale

Në Komunën e Gjiçanit nuk ka shkollë të veçantë speciale, por në shkollat fillore "Abaz Ajeti" dhe "Thimi Mitko" ekzistojnë klasë speciale për fëmijë të paaftë dhe me të meta mentale.

## **S** përparësitë

- Arsimi gjithëpërfshirës,
- Arsimi privat,
- Aplikimi i reformave,
- Numri i madh i nxënësve,
- Trajnimi i kuadrit arsimor,
- Numri i madh i profileve (shkollat e mesme ),
- Ekzistimi i këshillave të prindërve,
- Ligji mbi arsimin.

## **W** dobësitë

- Hapësira e pamjaftueshme në shkolla,
- Infrastruktura teknike e dobët,
- Kuadri arsimor i pamjaftueshëm,
- Stimulimi i dobët i arsimit,
- Mungesa e buxhetit,
- Shtirja e pavolitshme hapësinore e shkollave,



- Kapaciteti i vogël i arsimit parashkollor,
- Orari i shkurtër i enteve parashkollore.
- Mos përfshirja e të gjithë nxënësve nëpër shkolla,
- Prezenca e dukurive negative nëpër shkolla.



### **mundësitë**

- Mbrojtja dhe sigurimi i lokacioneve për shkollë,
- Trajnimi i kuadrit arsimor,
- Mundësia e financimit përmes pjesëmarrjes,
- Riaktivizimi i bibliotekës në shkolla,
- Kthimi i pedagogëve nëpër shkolla,
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore të të gjitha niveleve,
- Renovimi i objekteve ekzistuese shkollore.



### **Kërcënimet**

- Mos përfshirja e të gjithë nxënësve nëpër shkolla,
- Prezenca e dukurive negative nëpër shkolla.

## **Sistemi për përkujdesje shëndetësore**

### **Detyrat institucionale**

Rregulloret e përgjithshme të përkujdesjes shëndetësore në Kosovë janë përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë / në nivelin komunal përgjegjës është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Sa i përket sigurimit të shërbimeve dhe pajisjeve të programuara nga shteti dhe zyrtarët komunalë, pasojat që kanë të bëjnë me nevojën e hapësirës dhe përzgjedhja e lokacioneve duhet të koordinohen me Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizim në bazë të dispozitave të Planit Zhvillimor.

### **Problemet Ekzistuese**

Sektori i shëndetësisë në Kosovë ka pësuar jo vetëm nga shkatërrimi fizik i konflikteve të dhunshme, por edhe nga jo-investimet afatgjate në zhvillimin e stafit dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike dhe pajisjeve. Aktualisht çdo komunë ka një Qendër të Shëndetësisë Familjare (FHC apo shtëpia shëndetësore) për të mbikëqyrur rrjetin e Ambulantëve dhe barnatoreve (pajisjet primare të përkujdesjes shëndetësore dhe shërbimet në fshatra).

Sidoqoftë mundësitë e diagnostikimit të secilës qendër janë të kufizuara dhe shumë raste referohen nëpër spitale. Infrastruktura fizike e



përkujdesjes shëndetësore në Kosovë edhe pse nuk ka pësuar nga dëmet e luftës ka shumë nevojë për rinovim.

Çështja e dytë brengosësh në strategjinë për rehabilitimin e sektorit të shëndetësisë është mungesa e personelit të kualifikuar shëndetësor në kuadër të sistemit publik.

Në dhjetë vitet e fundit profesionistët shëndetësorë kanë pasur qasje të vogël në pajisjet e përtëritjes së njohurive apo ndryshime në teknologjinë mjekësore dhe në punët praktike.

### **Struktura e sistemit shëndetësor**

Sistemi i reformuar shëndetësor në Kosovë është projektuar të bazohet në "praktikën familjare" qasje në mjekë, motra medicinale dhe ekspertë tjerë shëndetësorë që punojnë si grup.

- **Përkujdesja Parësore Shëndetësore:** Është e organizuar në bazë të konceptit të mjekësisë Familjare si sistem i ri në Kosovën e pasluftës.
- Organizimi institucional i Mjekësisë Familjare është i organizuar me sa vijon:
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) – ofron shërbime shëndetësore 24 orë.
- Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) – ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës.
- AMF – ofrojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të caktuara (2 deri 3 herë brenda javës)
  
- **Përkujdesja Sekondare Shëndetësore:** Si spitale të përgjithshme korrespondojnë në nivelin sekondar të përkujdesjes shëndetësore, përfshirë Spitalin Universitar të Prishtinës.
  
- **Përkujdesja Terciare Shëndetësore:** Spitali Universitar i Prishtinës është spitali i vetëm i cili siguron përkujdesje terciare shëndetësore.
  
- **Kujdesi Privat Shëndetësorë:** Ofron shërbime të ndryshme ambulatorë dhe specialistike të profileve të ndryshme diagnostike dhe terapeutike.



## Kapacitetet e sistemit shëndetësor të Gjiçanit

- Spitali Rajonal,
- Komuna e Gjiçanit ka një spital rajonal me 17 Reparte: reparti i Gjinekologjisë, interno, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektivi, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë, oftalmologjia, laborator, transfuzioni i gjakut dhe materniteti. Në qendrën Spitalore janë të punësuar 525 punëtorë.

Tab. 19: Tabela e të punësuarve sipas nivelit profesional, Burimi:Raportet Sektoriale

Përgatitja shkollore	Gjinekologjia	Interna	Dializa	Njis.koronare	Pediatria	Neonatalogjia	Kirurgjia	Anesteziblogjia	Ortopedia	Urologjia	ORL	Oftalmologjia	Infektologjia	Pneumofiza	DAT	Emergjencia	Laboratoriumi	Transfuzioni	Rengeni	Neuropstaria	Dermatologjia	Samalorja	Drejtoria	Shërbëtorik	gjithsejt
Mjek specialist	10	7		2	6	3	7	4	4	2	5	2	5	4	1	3	2	1	3	2	2				75
Specializant	3	8					3	3	1	1		2	2						2	2					27
Punëtor me fakultet			1																						1
Shk. lartë medic.						1		1											2						4
teknik medicinal	40	20	10	11	10	13	14	20	10	10	7	2	11	10	3	20	13	8	7	10	2	1	4		287
teknik farmacist																									
teknik anestezilog							5																		5
teknik instrument								14																	14
laborant															2										2
lek. renigjeni														2											2
lek.transfuz.																									
Shk.mesme	5		3		1		1	1	1							4			2	1			16	41	79
Të kualifik.																								1	1
pa kualifikim	8	8	3	2	2	1	3	4	1	2	2		2	2	1	4	2	1		3			1	32	81
Gjithsejt:	66	48	22	15	24	13	28	38	17	15	14	6	20	16	9	33	17	10	16	23	4	1	21	74	573

Tab. 20: Numri i shtretërve sipas reparteve në Spitalin Rajonal të Gjiçanit, Burimi:Raportet Sektoriale

Repartet	Gjinekologjia	Interna	Dializa	Njis.koronare	Pediatria	Neonatalogjia	Kirurgjia	Ortopedia	Urologjia	ORL	Infektologjia	Opsterika	Reanimi	Emergjencia	Pulmologji	Neuropstaria	Intenzivja kirurgjike	Intenzivja atinekologjike	Observimi	gjithsejt
Shtretër	47	57	18	13	35	29	27	18	15	21	32	43	3	22	32	11	17	8	5	453





## Qendrat dhe Punktet e Mjekësisë familjare

- Institucionet shëndetësore bëjnë kontrollin dhe përkujdesjen e pacientëve. Në komunë është edhe shërbimi emergjent i cili ofron shërbimet e veta non-stop, në kuadër të Spitalit Rajonal sikur edhe ai në Shtëpinë e Shëndetit.

Gjendja e shëndetësisë në Qytet mund të shihet më qartë nga tabela në vijim.

Tab. 21: Numri i punëtorëve në institucionet shëndetësore

Lokacioni	Numri i punëtorëve						
	Mjekë	Tekni Medicinbal	Stomatolog	Admin.	Ngasës të autom	Punëtor ndihmës	Gjithsejt të punësuar
1. QKMF-ambulanca e qytetit	20	80	14	10	6	27	<b>157</b>
2. QMF – në lagjen "Dardania"	10	24	4		1	4	<b>43</b>
3. QMF - në lagjen "Arbëria"	4	8				2	<b>14</b>
4. QMF - Ish-emergjenca	6	15				2	<b>22</b>
5. QMF dheu i bardhë	2	3				1	<b>6</b>
<b>Gjithsejt:</b>	<b>42</b>	<b>130</b>	<b>18</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>36</b>	<b>340</b>

Burimi: Raportet Sektoriale

## Mbrojtja Sociale

Në Gjilan është një qendër për mirëqenie, që merret me çështje sociale, e cila ndihmohet dhe paguhet nga UNMIK-u. Ata gjithashtu do të paguajnë faturat e rrymës për rastet sociale, por tani për tani nuk kanë filluar, do të fillojnë nga shtatori. Ata ndihmojnë familjet me probleme për adoptim, shkurorëzim, gjejnë strehim për pleqtë, zakonisht ata i dërgojnë në Prishtinë. Janë të aftë të vendosin për këto çështje në mënyrë të drejtë. Ata kanë program për strehim, por për momentin nuk mund të sigurojnë strehim për askënd.



## Kryqi i Kuq Lokal

Në Komunën e Gjiçanit ekziston një zyre e Kryqit të Kuq. Ata distribuojnë me të mirat të cilat i marrin nga OJQ-të dhe organizatat tjera; ata dhurojnë pako higjienike për fëmijë, prej 6 muaj deri në 2 vjet; gjithashtu kanë një program t'i ndihmojnë fëmijët e shkollave.

### **S** përparësitë

- Kuadri i mjaftueshëm mjekësor,
- Nuk ka sëmundje epidemike
- Mjekësia familjare,
- Spitali rajonal,
- Ekzistimi i ordinancave private.

### **W** dobësitë

- Mossigurimi shëndetësor,
- Buxheti i pamjaftueshëm,
- Hapësira e pamjaftueshme,
- Mungesa e reparteve
- Pajisjet teknike mungojnë.

### **O** mundësitë

- Trajnimi i vazhdueshëm profesional,
- Sigurimi shëndetësor,
- Specializimi i kuadrit,
- Hapja e ambulancave të reja,
- Hapja e reparteve të reja të Spitalit.

### **T** kërcënimet

- Rritja e sëmundjeve ngjitëse
- Rritja e sëmundjes së varësisë,
- Largimi i kuadrit profesional nga instituti – komuna.

## Kultura, Rinia dhe Sporti

### Kultura

Për trashëgiminë kulturore, ka një interesim të shtuar pas luftës në Kosovë. Kurorëzim i këtij interesi për komunën e Gjiçanit paraqet themelimi i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në korrik të vitit 2004. Kushtimisht, janë krijuar kushtet që dëshira të zëvendësohet me angazhim konkret. Qysh gjatë fazës së inventarizimit, QRTK në Gjiçan ka konkretizuar evidentimin e objekteve me vlerë trashëguese në tërë komunën e Gjiçanit, me gjithsej 162 objekte me vlerë arkitektonike, arkeologjike, historike, të vjetërsisë, artistike, ambientale, rariteti, etj.



Objektet e Kulturës në Gjiçan janë:

1. Teatri Profesionist i Qytetit,
2. Biblioteka Publike Kombëtare me 10 Biblioteka nëpër fshatra, prej tyre 4 në vendbanimet serbe,
3. Arkivi Historik,
4. Qendra e Trashëgimisë Kulturore,
5. Shtëpi të Kulturës në 6 fshatra,
6. Stadiumi i Qytetit,
7. Pasuri tjera Trashëgimore dhe Shpirtërore.

Fig. 9: Teatri i Qytetit



Ekzistojnë edhe Manifestime Kulturore si Flaka e Janarit, Panairi i Librit dhe Takimet e Majit

Rinia

Në kuadër të zhvillimeve të gjertanishme, ballafaqimi me i madh dhe sfidues për shumicën e strukturës rinore në komunën e Gjiçanit është mungesa e hapësirave të mjaftueshme për të zhvilluar aktivitetet dhe veprimtaritë e tyre në lemë të ndryshme rinore dhe rekreative.

Niveli i përgatitjes së të rinjve në shkallë komune është i kënaqshëm por, jo në masën adekuate dhe të përgatitjes superiore apo vende vende, mungon edhe shkalla e përgatitjes së mesme shkollorë – kryesisht nëpër disa vendbanime të thella rurale.

Grupmoshat rinore prej pesëmbëdhjetë vjeç e deri në tetëmbëdhjetë janë të ndikuara nga zhvillimet negative në shoqëri e kryesisht mos



edukatës së mjaftueshme dhe lakmisë së tyre për të pasur qasje në 4 dukuri negative si: rrugaçëria , alkooli , prostituimi , dhe pjesëm të elementeve narkotike.

Në trend me zhvillimet në komunën e Gjiçanit , për momentin mundësitë e punësimit të rinjve janë të vogla dhe kryesisht një kyçje e tyre është e mundur vetëm në strukturat institucionale shërbyese dhe publike, si dhe në një pjesë të sektorit privat, por që është i përkohshëm dhe jo i qëndrueshëm plotësisht.

Përafërsisht 65% e popullatës së komunës përbëhet nga të rinjtë e të tri grupmoshave, megjithatë në strukturën e tyre organizative ekziston potencial dhe energji e madhe për t'u zhvilluar dhe promovuar edhe në arsimim e edhe në sfera të tjera. Duket e theksuar na paraqitet edhe dëshira për të migruar në vende të ndryshme euro perëndimore, pa dallim strukturën dhe kualifikimin e tyre.

Po ashtu edhe qendra sportive që ekzistojnë janë të pa mjaftueshme për të përmbushur nevojat e mëdha të të rinjve por edhe të vetë qytetarëve të grupmoshave të rritura.

Tab. 22: Organizatat rinore që veprojnë në Komunën e Gjiçanit

Nr.	Emri i organizates-subjektit rinor	Veprimtaria
1	Unioni i pavarur i Studentëve	Rinore -studentore
2	Rinia Shkollore	Rinore – shkollore në nivel komunal
3	Asociacioni për avansim të Rinisë	Promovim rinor -avansim
4	Q.R. – Gjiçan	Edukative -trajnuese
5	F. R – LDK-së	#####
6	RD-PDK-së	#####
7	AR-AAK-së	#####
8	RiniaPSHDK-së	#####
9	Rinia PReK	#####
10	Rinia e Kryqit të Kuqë	Humanitare angazhuese
11	“ Lands downe”Gjiçan	Multietnike-rinore
12	Piktorët e rinj “BOTART”	Promovuese -angazhuese
13	“Baro Amalipe “-romëve	Kult. Sport. -rome
14	KCIC-Gjiçan	Organizata multietnike rinore për Bashkëp. Nderko.

Sipas evidencës dhe angazhimeve deri më tani këto organizma rinore janë në veprimtari dhe kontakt me sektorin për rini, por edhe të tjera mund të ketë por nuk i posedojmë shënime ekzakta.

Në kuadër të sektorit për Rini dhe në përfaqësim të shumicës së organizatave dhe subjekteve rinore , që nga qershori 2003 ekziston Rrjeti



“VULLNETARËVE RINORË AKTIV” dhe është shumë funksional në veprimin me çdo aktivitet rinor dhe manifestim institucional ne nivel te komunës së Gjilanit.

Ndërsa ne kuadër të DKRS-së – Sektorit për Rini, funksionon Këshilli rinorë komunal që nga viti i kaluar. Ky është një organizëm rinorë si trup këshillëdhënës për zhvillimet ndër rinore , e ne te cilin përfaqësohen te gjitha organizatat dhe subjektet rinore pa dallime.

Bashkëpunimi ne mes te Komunës dhe Organizatave rinore është i kënaqshëm dhe kryesisht zhvillohet përmes rrjetit rinor vullnetarë dhe Këshillit Rinorë , por edhe me secilën Organizatë apo subjekte rinore veç e veç, duke promovuar potencialin rinor ne pjesëmarrje te disa organizatave dhe sektorit për rini gjatë zhvillimit te aktiviteteteve ne nivel te komunës duke përfshirë kohëve te fundit edhe pjesëmarrjen aktive te rinisë se Fshatrave .

Një nivel me i lartë i zhvillimeve do te jetë më i pëlqyer nëse do te zhvilloheshin dhe krijoheshin edhe më shumë hapësira rinore dhe nëse do te siguroheshin me shumë mjete financiare.

Prandaj, Gjilani është e vetmja komunë në Kosovë që ka një organizim të këtyre formave me organizmin rinor ne përgjithësi. Mu për këtë ky potencial rinor meriton të përkrahet institucionalisht.

Në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport ekziston zyrtari i sektorit të Sportit i cili koordinon punët në sferën e sportit, ai harton planet e zhvillimit të sportit, përcjell punën e organizatave sportive kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve sportive ekzistuese.

Asistenca e gjertanishme në këtë sferë.

Organizatave sportive janë ndihmuar nga KK me mjete materiale në mënyrë individuale në bazë të kërkesave dhe projekteve të tyre që i kanë bërë Drejtorisë. Gjithashtu në mënyrë indirekte KK ka ndihmuar Organizatat sportive me investimet që janë bërë në përmasimin e infrastrukturës sportive: në rregullimin e Stadiumit të qytetit si dhe në Palestrën e Sporteve. Këto dy objekte Klubet dhe Ekipet sportive i kanë shfrytëzuar për zhvillimin e aktiviteteteve të tyre pa kompensim.



Tab. 23: Regjistri I Klubeve Sportive dhe numri I anëtarëve sambas grupmoshave

Nr	Emri i ekipeve	Pioner	Kadet	Junior	Senior	Gjithsej
1	KF. Drita	50	50	60	30	190
2	KF. Gjiçani	50	50	60	30	190
3	KB.Drita (M)	50	/	100	15	165
4	KB.Drita (F)	/	/	100	15	115
5	KH.Drita (M)	/	/	50	25	75
6	KH.Drita (F)	/	/	100	25	125
7	KV.Drita (M)	/	/	30	15	45
8	KV.Drita (F)	/	/	30	15	45
9	KK.Drita	30	30	30	50	140
10	KK.Gjiçani	20	20	20	40	100
11	K.Bok.Drita	/	/	20	20	40
12	K.P.P. Drita	/	/	10	10	20
13	K.P.P.Gjiçani	/	/	10	10	20
14	K.SH.Drita	/	/	15	10	25
15	KBOD	/	/	/	20	20
16	KS. Gjiçani	/	/	/	20	20
17	KJ. Gjiçani	20	20	20	20	80
18	KM.Gjiçani	20	20	20	20	80
19	KA.Gjiçani	/	/	/	/	40
	<b>Gjithsej</b>	<b>240</b>	<b>190</b>	<b>675</b>	<b>400</b>	<b>1540</b>

**S** përparësitë

- Traditë teatrore 60 vjeçare,
- Popullsia të re me energji krijuese,
- Pasuria e trashëguar Kulturore e Natyrore.

**W** dobësitë

- Hapësira e pamjaftueshme,
- Objektet janë të vjetruara,
- Mungesa e një Muzeu,
- Mungesa e Fushave Rekreativo-Sportive dhe Parqeve,
- Mungesa e Buxhetit.

**O** mundësitë

- Ndërtimi I Një Muzeu,
- Renovimi I Objekteve të vjetra të Kulturës,
- Ndërtimi I një Biblioteke Moderne,
- Ndërtimi I Shtëpisë së Rinisë,
- Renovimi I Arkivit Historik.

**I** kërcënimet


- Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore.

**Kufiri kadastral**  
 kadastral border  
 kultura dhe feja culture and religion  
 teatri / shpëtia e kulturës  
 theatre / culture house  
 xhami / kishë  
 mosque / church  
 arkiva  
 archive  
 arsimi education  
 shkollë fillore, ekzistuese /  
 e planifikuar  
 primary school existing,  
 planned  
 shkollë e mesme, ekzistuese /  
 e planifikuar  
 secondary school, existing /  
 planned  
 konvikti për studentë /  
 institucionet parashkolore  
 student housing/day care centre  
 kujdesi shëndetsor health care  
 QKMF / OMF / AMF / Spital  
 MFMG/FMC/FMA/hospital  
 SHGJMSHM / QSHM/BBI  
 infrastrukturë sociale të tjera  
 other social infrastructure  
 administrata  
 administration  
 posta  
 post  
 gjyqi  
 court  
 KFOR/Policia + Burgu  
 TMK  
 KPC  
 fushat e sportit  
 sports field  
 sallat e sportive  
 sports hall  
 tregu  
 market

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
 Municipal Assembly Gjilan  
**Plani zhvillimor urban i Gjilanit**  
 Urban development plan and of Gjilan

**Pozita e qytetit - infrastruktura sociale**  
 Situation Town - Social Infrastructure  
 14.04.2008  
 Përpjesa:  
 Scale:  
 0 100m 500 1 km

Drejtoria për Urbanizim, Rindërtim dhe Ambient  
 THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT  
 IFECH  
 INSTITUTI I PLANIMIT DHE URBANIZIMIT  
 INSTITUTE OF URBANISM AND ENVIRONMENT





## 1.2.b ZHVILLIMI EKONOMIK

### Industria

Në qytetin e Gjilanit, industria ka qenë një faktorë i rëndësishëm ekonomik për zhvillimin e Komunës . Industria ka qenë e përfaqësuar nga shumë degë të prodhimit, si industria e përpunimit të çelikut, e duhanit, i radiatorëve të çeliktë, i baterive industriale, ndërtimore etj .

Shumica e këtyre ndërmarrjeve industriale punojnë me kapacitet shumë të vogla ose kanë ndërprerë aktivitetin e tyre prodhues për shkak të rrethanave të krijuara pas luftës në Kosovë .

Deri në vitet e 90-ta, Gjilani kishte një ekonomi relativisht stabile, dhe ajo përbëhej nga: Kombinati i Tekstilit, Kombinati i Duhanit, IBG, Fabrika e Radiatorëve, Çeliku, Grafikos, Elektrokosova, Morava e Binçës, Kosovatransi, PTK, Agrokultura, Veterinaria, Stacioni i Bujqësisë, Mirusha , Ekonomia e Pyjeve, 28 Nëntori, Anamorava, Qarkullimi, Teuta, Kristali, Drita, Hidroteknika, Ndërmarrja Komunale Publike, Kualiteti, Hekurishtja.

Mirëpo shfrytëzimi dhe administrimi jo i drejtë i këtyre kapaciteteve, gjatë dhjetë viteve të kaluara, periudhë kjo kur shqiptarët ishin privuar nga e drejta e punës, kanë bërë që riaktivizimi i tyre të jetë i vështirë. Megjithatë, në shumicën e tyre ka rifilluar prodhimtaria.

### Pasuria e Ndërmarrjeve shoqërore

Ne bazë të shënimeve të grumbulluara nga e ana e Drejtorisë për Ekonomi dhe Menaxhment, kemi nxjerr këto të dhëna lidhur me patundshmërinë e pronës komunale:

- Subjektet afariste / ndërmarrjet shoqërore/ me pasurinë e patundshme që disponojnë kanë këtë gjendje dhe atë 898 hektar e 77 ari e 81 m<sup>2</sup>, prej tyre objekte të mbuluara janë 235,956.65 m<sup>2</sup>.
- Përveç këtyre të dhënave Morava Binçës ka në shfrytëzim 129 hektar 46 ari e 88 m<sup>2</sup> dhe atë tek seperacioni Gllama, ndërsa Ekonomia e Pyjeve ka mbi 10,000 hektar vijues .





Tab. 24: Pasuria e ndërmarrjeve shoqërore

Nr.	Emri i subjektit	Sipërfaqej ae e tokës	Hallat	Depot dhe dyqanet m <sup>2</sup>	Zyrat	Objektet e mbuluara m <sup>2</sup>	Gjithesëjt				
			m <sup>2</sup>				/ 2+3+4=5 /		/ 1+ 5 /		
			1				2	3	4	5	ha
1	Industria e Textilit	24.00 00	62,325			62 325,00	30	23	0		
2	Industria e Duhanit	4.58 00	38, 000			38 000,00	8	38	0		
3	IBM Kualiteti	2.26 00	6, 005, 12	2 458,18	901,14	9 364,44	3	20	0		
4	Fabrika e Baterive	122.500				31 558,00	15	40	58		
5	Fabrika e Radiatorve	4.88 44					4	88	44		
6	Çeliku	50.000	6,2	4 028,00	2 184,00	12 412,00	6	24	12		
7	Grafikosi	0.38 00	943,5	307,45	227,5	1 478,45	0	52	78		
8	M. Binçës	11.64 50	6,353	501	3 358,00	10 212,00	12	66	62		
9	Kosovatransi	0.81 08					0	81	8		
10	Agrokultura	802.00 00	40, 800		2 270,00	43 070,00	806	30	7		
11	Stacioni i Bujqësis	17.00 00	22,325,50	427,05	390	23 141,00	19	31	41		
12	Mirusha	1.00	400	826	170	1 496,00	1	14	9		
13	Ekonomia e Pyejeve	1.80 87		2 040,00	200		2	8	82		
14	28 Nëntori	2.638		14 720	1025		4	21	25		
15	Anamorava	1.20 00		751,94	757,82	1509,76	1	35	9		
16	Qarkullimi	0.36 65		1,290,00	100	1390	1	50	55		
17	Hoteli " Kristal "	0.28 29	600				0	34	29		
18	Drita	1.84 53					1	84	53		
19	Hidroteknika	1.87 92					1	87	92		
20	Higjena	1.94 73					1	94	73		
<b>Totali</b>		<b>898,77 81</b>	<b>183 950,12</b>	<b>27,350,07</b>	<b>11,583,46</b>	<b>235 956,65</b>	<b>915</b>	<b>977</b>	<b>737</b>		

Burimi: Kuvendi Komunal

Ndërmarrjet që mendohet që janë bartëse të zhvillimit të ekonomisë së Gjilanit edhe pse tani disa prej tyre punojnë me një kapacitet të kufizuar. Besohet që ardhmëria e tyre qëndron në procesin e privatizimit i cili shkon me një ritëm shumë të ngadalshëm .

- Fabrika për prodhimin e konstruksioneve të çeliktë "Çeliku",
- Fabrika e radiatorëve dhe këmbyesve të nxehtësisë " Jugoterm ",
- Fabrika për përpunimin e duhanit "IDGJ",
- Kombinati i tekstilit "Integj "
- Fabrika për prodhimin e Baterive Industriale IBG,
- Ndërmarrja Hidro Ndërtimore Industriale "Morava e Binçës",
- Ndërmarrja shoqërore- Grafikos,
- Industria ushqimore N.Sh. „Kualiteti“,
- Fabrika për prodhimin e ujit natyral të gazuar " Dea ".



Fig. 10: Fabrika për prodhimin e konstruksioneve të çelikut "Çeliku"



## Biznesi

Në Komunën e Gjilanit sipas Regjistrimit të bizneseve në dhjetor 2002 kanë qenë 3,084 biznese të regjistruara me 9,961 të punësuar. Bizneset sipas seksionit të veprimtarisë janë si vijon: Tregtia me 1,730 biznese të regjistruara apo 56.1%, Industria përpunuese 277 apo 9.0 %, Transport dhe komunikacion 269 apo 8.7%, Hotelieri dhe restorante 256 apo 8.3 %, Ndërtimtari 166 apo 5.4 %, Afarizëm me pasuri të patundshme dhe shërbime të afarizmit 84 apo 2.7%, Arsim 45 apo 1.5%, Mbrojtje shëndetësore 36 apo 1.2 %, Bujqësi 30 apo 1.0 %, Industri minerale dhe ekstraktues 7 apo 0.2 %, Ndërmjetësim financiar 3 apo 0.1%, Furnizim me energji elektrike, gaz dhe ujë 2 apo 0.06 % dhe Veprimtari të tjera shoqërore 179 biznese të regjistruara përkatesisht 5.8 %.



Tab. 25: Numri i bizneseve të regjistruara në sektorin privat dhe shoqëror sipas seksionit të veprimtarisë

Lloji i Aktiviteteve	Gjithsej	A Bujqësia, Gjuetia dhe Pylltaria	B Peshkimi	C Industria e minerave dhe ekstraktues	D Industria Perpunuese	E Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe uje	F Ndertimtaria	G Tregtia me shumice dhe pakice, riparimi i automjeteve dhe .....motoçikleteave dhe artikujve per perdorim personal dhe shtepiak	H Hotelet dhe restorantet	I Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	J Ndermjetsimi financiar	K Afarizmi me patur i te patundshme, dhenja me qira dhe sherbimet e afarizmit	M Arsimi	N Mbrojtja shendetsore dhe sociale	O Veprimtarite te tjera shoqerore
Numri i Bizneseve sipas aktivitetit	3084	30	-	7	277	2	166	1730	256	269	3	84	45	36	179
Ndërmarrje	2422	22	-	6	206	2	153	1553	147	119	2	56	29	30	97
Nderrmarrës individuale	662	8	-	1	71	-	13	177	109	150	1	28	16	6	82
Të punësuar	9961	465	-	24	2983	75	1115	3455	635	425	7	175	142	65	395
Ndërmarrje me kapital te jashtem dhe perzier	36	1	-	-	6	-	3	19	2	-	-	1	2	2	-
Ndërmarrje që kanë nderprerë aktivitetin	124	-	-	-	12	-	4	59	12	28	-	1	-	-	8
Biznese me pronare femra (7.4 %)	231	2	-	-	16	-	8	157	2	-	1	-	7	6	32

Burimi: Kuvendi Komunal

### Ndërmarrjet Prodhuese

Fillet e zhvillimit të bizneseve prodhuese janë nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe modernizimit të tyre është bërë në 7 vitet e fundit.

Furnizimin me lëndë të para bëhet nga importi prej shteteve ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore dhe më pak nga tregu i brendshëm i Kosovës. Selitë e këtyre ndërmarrjeve prodhuese janë të vendosura



kryesisht në pjesët periferike të qytetit dhe i përkasin kryesisht kategorisë së bizneseve të vogla dhe të mesme.

Në këtë Komunë janë 97 ndërmarrje prodhuese, aktiviteti i tyre shtrihet në përpunimin e metaleve, përpunimin e drurit, tekstilit, industrisë ushqimore, etj.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 776 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 5,622,765 €/vit.

Kapacitetet e këtyre ndërmarrjeve janë të nivelit të vogël, ndërsa shfrytëzimi aktual i kapaciteteve është 50-70 %.

### **Ndërmarrjet zejtare**

Zejtaria në Komunën e Gjilanit tradicionalisht ushtrohet me decenie të tëra, mirëpo edhe në këtë segment të ekonomisë hovi i zhvillimit dhe i modernizimit është në 7 vitet e fundit. Lënda e parë kryesisht merret nga importi prej shteteve ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore dhe më pak nga tregu i brendshëm i Kosovës. Ndërsa shërbimet dhe prodhimet e tyre i ofrojnë për qytetarët e Komunës dhe më gjerë për tregun kosovar.

Në komunën e Gjilanit janë 498 punëtorë zejtare të cilat merren me përpunimin dhe ofrimin e këtyre shërbimeve si ato të: rrobaqepësisë, ondulimit, salloneve të bukuri dhe kozmetikës, fisnikërimit të metaleve, përpunimi i galanterisë së lëkurës, galanterisë së drurit, galanterisë së betonit dhe argjilës, etj. Selitë e punëtorëve zejtare janë të vendosura kryesisht në qytet dhe i përkasin kryesisht kategorisë së mikrobizneseve.

Në këto punëtorë janë të punësuar 1,250 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 6,516,130 €/vit.

Kapacitetet e këtyre punëtorëve karakterizohen me kapacitet të vogël përpunues.

### **Biznesi joformal**

Një numër i personave me zeje të ndryshme si elektroserviserë, mjeshtër të punëve të ndryshme ndërtimore dhe zejtare zhvillojnë aktivitetin pa u regjistruar fare. Numri i këtyre personave nuk dihet por sipas disa vlerësimeve mundë të jetë prej 150-200 persona.

### **Agrobiznesi**

Si pasojë e luftës dhe dëmtimeve që kanë pësuar, ekonomia bujqësore në sektorin shtetëror, janë joaktive dhe jashtë funksioni shumë kapacitete prodhuese dikur shumë rentabile si Kombinati Bujqësor- Agrikultura me njësitë e saj dhe Stacioni për Përparimin e Bujqësisë. Dikur, këto kompani



kanë qenë gjigante të mëdha që kanë siguruar të hyra të larta për punonjësit e tyre.

Prona e pazgjidhur, mungesa e investimeve dhe konflikti i kompetencave me Shtyllën e IV-të të UNMIK-ut dhe AKM, kanë sjellur këto kompani para shkatërrimit të pronës dhe mjeteve themelore të tyre.

## **Ndërtimtaria**

Fillet e zhvillimit të bizneseve ndërtimore dhe byrove projektuese janë nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të tyre është bërë në katër vitet e fundit. Selitë e ndërmarrjeve ndërtimore janë të vendosura kryesisht në pjesët periferike të qytetit, ndërsa byrotë projektuese janë më tepër të vendosura në brendi të qytetit.

Në Komunën e Gjiçanit janë 85 ndërmarrje ndërtimore dhe byro projektuese të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbimet: projektet ideore, projektet kryesore, realizimin e tyre (ndërtimin) dhe mbikëqyrjen e tyre. Furnizimin me materiale ndërtimore bëhet nga tregu i brendshëm i Kosovës dhe nga importi nga shtetet ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore.

Në komunën e Gjiçanit veprojnë edhe 6 gurëthyes.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 680 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 4,671,120 €/vit. Kapacitetet e ndërmarrjeve ndërtimore dhe byrove projektuese janë: 9,340 m<sup>2</sup>/vit sipërfaqe të ndërtuara të objekteve banimi dhe afariste.

## **Turizmi**

Në komunën e Gjiçanit janë 244 ndërmarrje dhe punëtori hoteliere të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbime të fjetjes, ushqimit, pijeve alkoolike dhe joalkoolike, ahengjeve familjare, banketeve, seminareve, trajnimeve dhe shërbimeve të tjera. Hoteleria furnizimin me mallra e bën nga tregu i brendshëm, mall i cili kryesisht është importuar nga shtetet ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore

Objektet hoteliere kryesisht janë të ndërtuara në brendi të qytetit dhe pjesërisht në pjesët periferike.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 976 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 4,762,409 €/vit. Kapacitetet e objekteve hoteliere janë 14,640 m<sup>2</sup>.

Fillet e zhvillimit të bizneseve hoteliere janë nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të hotelerisë është bërë në katër vitet e fundit.



## Tregtia

Në Komunën e Gjilanit janë 1,813 ndërmarrje dhe shitore tregtare të cilat iu ofrojnë konsumatorëve lloje të ndryshme të mallrave si që janë: mallra ushqimore, mallra të higjienës, tekstilit, galanterisë së lëkurës, aparateve të amvisërisë, mobilierisë dhe mallrave të tjera të konsumit të gjerë.

Zhvillimit i tregtisë private në komunën e Gjilanit ka filluar nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të tregtisë është bërë në 7 vitet e fundit. Mallrat kryesisht importohen nga Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Turqia, Greqia dhe shtetet tjera të Evropës perëndimore si dhe simbolikisht edhe nga tregu i Kosovës.

Objektet shitëse kryesisht janë të ndërtuara në brendi të qytetit dhe pjesërisht në periferi të qytetit si dhe në fshatrat e Komunës së Gjilanit.

Në këto ndërmarrje janë të punësuar 6,345 punëtorë, ndërsa qarkullimi vjetor në këto biznese është 64,915,597 Euro. Kapacitetet e objekteve shitëse janë 72,520 m<sup>2</sup>.

## Analiza e zhvillimit ekonomik

Sido që të jetë mund të konstatojmë se ekonomia e komunës së Gjilanit është vazhdimisht e ballafaquar me probleme të shumta të shpenzimeve të mirëmbajtjes investuese dhe normë të ulët të akumulimit, me punësim i cili ka stagnuar me vite dhe me probleme të transformimit të pronës. Orientimi kryesor permanent mbetet: zhvillimi ekonomik lokal nëpërmes procesit të privatizimit, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, realizimi i projekteve të reja dhe krijimi i kushteve për një ambientit të shëndoshë dhe të sigurt për thithjen e kapitalit të jashtëm dhe nxitjen e NVM-ve vendore në veprimtari prodhuese.

Vlen të theksojmë se regjistrimi i bizneseve duhet të kthehet prapë në kompetenca të zyrave për regjistrim të bizneseve në kuadër të qeverive komunale për arsye të saktësisë së shënimeve që disponojnë këto zyre dhe për arsye se në meset multietnike siç është komuna e Gjilanit minoritetet më parë i regjistruan bizneset e tyre në zyre komunale por që shumica e tyre nuk i regjistrojnë pasi që kjo kaloi në kompetenca të Ministrisë për Tregti dhe Industri.

**S** përparësitë

- Tradita industriale,
- Pozita e volitshme gjeografike,
- Ekzistimi i resurseve natyrore,
- Resurset njerëzore,
- Ekzistimi i zonave të veçanta Industriale-Prodhuese,
- Ekzistimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese,
- Procesi i privatizimit,
- Kuadër I mjaftueshëm profesional.

**Ë** dobësitë

- Infrastruktura,
- Struktura e pavolitshme e bizneseve,
- Shfrytëzimi i vogël i kapaciteteve industriale,
- Teknologjia e vjetruar,
- Buxheti i pamjaftueshëm,
- Politika fiskale dhe kreditore jo e volitshme,
- Shtimi i papunësisë.

**O** mundësitë

- Riaktivizimi i kapaciteteve ekzistuese,
- Riaftësimi i resurseve njerëzore- profesionale,
- Ristrukturimi i proceseve të prodhimit bazuar në fleksibilitet,
- Shfrytëzimi i kapaciteteve nga diaspora (joshja e investitorëve),
- Krijimi i partneriteteve.

**O** kërcënimet

- Largimi i kuadrit profesional nga komuna,
- Investimi I pamjaftueshëm në prodhimtari.



## 1.2.c MJEDISI DHE SHFRYTEZIMI I TOKËS

### Peizazhi dhe Mjedisi

Qyteti i Gjilanit shtrihet në një fushëgropë të gjerë natyrore të Anamoravës . Në juglindje ka malet e Karadakut si dhe një pjesë të Rrafshit të Kosovës – fushë pjellore.

Komuna e Gjilanit ka klimë të mesme kontinentale, me vera të nxehta dhe dimra të ftohtë. Temperatura mesatare e Janarit është - 0.9 shkallë celsius, ndërsa temperatura mesatare e Korrikut është + 21.5 gradë. Maksimumi absolut është shënuar në Gusht ( 37,10 °C ), ndërsa ai minimal në Janar ( - 32,5 °C ).

Në stinën e vjeshtës, këtu bien reshje të shirave, mesatarisht 177 mm, ndërsa në stinën e verës – 129 mm. Sasia e reshjeve në stinën e pranverës është 145 mm dhe në stinën e dimrit është – 130 mm. Të reshurat mesatare vjetore janë 596,01 mm.

Lagështia relative mesatare e ajrit është 76,8 % , kurse muaji më i thatë është gushti 66,2 % , ndërsa muajt me lagështi më të madhe janë: nëntori dhe dhjetori me 84,2 %.

Rrymat ajrore (erërat) më të shpeshta janë ato veriore ndërsa më të rralla jugperëndimore. Rrymat mesatare e ajrit është ajo e jugut ndërsa me intensitet më të vogël jugperëndimore.

Hapësirat e gjelbërua publike janë të rëndësishme për rekreacion dhe për vendet e bukura të qytetit, por gjithashtu edhe për mikroklimën në qytet.

Ekzistojnë disa parqe të ndryshme dhe hapësira tjera të gjelbëruara në Gjilan, shumica të përqendruara në pjesët e ndërtuara të shekullit 20-të. Në një lokacion në jug të qytetit fushat e sportit dhe varrezat janë kombinuar në një zonë të madhe të gjelbëruar, por në përgjithësi, hapësirat e hapura publike janë konceptuar në një ishull të vetëm, pa asnjë lidhje të brendshme.

“Parku i qytetit” është i vendosur në qendër të qytetit përgjatë rrugës kryesore të qytetit , është përcaktuar si një park që përfaqëson disa funksione publike qendrore, siç janë teatri i qytetit dhe shtëpia e kulturës, të cilat e formojnë një tërësi qendrore për rekreacion.

Parku për fëmijë mbi hallën e sporteve si dhe parku i kombinuar për të rritur dhe për fëmijë në lagjen “Iliria”

Ekzistojnë hapësirat sportive në tri lokacione të ndryshme të qytetit: në veri-perëndim, së bashku me qendrën e shkollave, në jug me shkolla dhe në veri-lindje në qendrën e Kampit të KFOR-it Monteith.





Dy lokacione të varrezave, njëra myslimane dhe tjetra krishtere ortodokse, të vendosura në jug-lindje afër fushës së sportit, janë gjithashtu të rëndësishme për strukturën e gjelbër të qytetit.

Gjithashtu ekziston një zonë e hapur publike gjelbëruese në jug-perëndim, në lokacionin e "Kodrës së Dëshmorëve ". Pamja nga kjo pikë është e mrekullueshme, por kjo zonë nuk është zhvilluar si një park, dhe një numër i vogël vizitorësh e gjejnë rrugën për atë vend. Në planin rregullues Qarku, i cili shtrihet në perëndim të qytetit, është planifikuar një sistem i parqeve me fusha të sportit për ta lidhur majën e " Kodrës së Dëshmorëve " me peizazhet bujqësore dhe periferinë. Dy lumenj kalojnë nëpër Gjiçan. Njëri nga ta përdoret për qëllime rekreative.

Të gjithë lumenjtë dhe derdhjet e tyre takohen në lindje të qytetit. Për momentin për rreth lumit kjo zonë është jashtëzakonisht tokë e lagësht, por që në të ardhmen mund të zhvillohet në një zonë shumë të rëndësishme rekreative në Gjiçan.

Gjendja e mjedisit në qytetin e Gjiçanit është serioze. Lumenjtë janë të ndotur, trafiku i rënduar kalon përgjatë qytetit të brendshëm, dhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza është jashtë funksionit.

Lumenjtë dhe derdhjet e tyre që kalojnë përgjatë qytetit janë të ndotura në shkallë të madhe .

Ata janë përdorur si depozita për mbeturinat e ngurta, dhe për shkak të mungesës së impiantit për trajtimin ujërave të zeza, në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte shkarkohen në ujërat e këtyre lumenjve . Një kërcënim tjetër i kualitet të ujit është vendosja e zonës industriale afër lumenjve. Nëse nuk ndërmerren veprime të shpejta, rreziku nga vajrat dhe substancave tjera të kontaminuese, që depërtojnë përmes ujit, do të jetë shumë i madh.

Deponia e mbeturinave e më hershme e qytetit në fshatin Pasjak është mbyllur, por për shkak të problemit me ujërat e kontaminuar duhet marrë seriozisht me trajtimin e saj . Një deponi e re e hedhurinave rajonale është ndërtuar sipas standardeve moderne, por që është e konceptuar vetëm për akumulimin e mbeturinave të thjeshta. Asnjë veprim nuk është ndërmarr në lidhje me riciklimin dhe djegien e mbeturinave të grumbulluara .

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 16.01.2004, aprovoi Rregulloren për Mbrojtjen e Mjedisit në komunën e Gjiçanit.

Në bazë të kësaj rregulloreje: Zhvillimi i Komunës duhet mbështetur në baza të shëndosha - qëndrueshme, në mënyrë që të krijohen kushte për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet e dëmshme për popullatën.



Detyrat primare do të jenë:

- Ruajtja e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit,
- Menaxhimi i suksesshëm i hedhurinave dhe
- Ruajtja e biodiversitetit

Për realizimin e këtyre detyrave, Kuvendi Komunal, duhet të ketë përkushtim më të madh në mënyrë që të krijojë një sistem të organizuar për menaxhim të tërësishëm të problemeve mjedisore.

Analizat SWOT për Ambientin dhe Mjedisin

**S** përparësitë

- Dy përrenj në zonën urbane,
- Parqe dhe fusha sportive gjenden brenda qytetit.

**W** dobësitë

- Parqet në qytet kanë standard të ulët,
- Përrenjtë nëpër qytet janë mbuluar,
- Disa aktivitete industriale dhe komerciale afër lumenjve,
- Mbeturinat dhe kanalizimi derdhen direkt në lumenj,
- Deponia e mbeturinave do të mbushet së shpejti, Nuk ka riciklim,
- Impianti i ujrave të zeze nuk funksionon.

**O** mundësitë

- Parqet dhe lumenjtë do të përdorën për të krijuar një hapësirë të bukur të qytetit dhe klimë të shëndetshme,
- Zona e lumit në lindje mund të zhvillohet në një park të madh të qytetit.

**T** kërcënimet

- Problemet ekonomike dhe vetëdijesimi i ulët i popullatës e pengojnë mbrojtjen e mjedisit.


**→** qëllimet

- ndalimi i ndotjes dhe pastrimi i lumenjve dhe përrenjve,
- Impianti për djegje dhe pastrimin e ujërave të zeza është i domosdoshëm,
- zhvillimi i konceptit për gjelbërimin e qytetit.



Fig. 11: Parku i qytetit





	<b>Kufiri kadastral</b> Kadastral border
	<b>hapsira e gjelbër publike</b> public green area existing/ planned
	<b>park</b>
	<b>fushë sporti/ sallë sporti</b> sportsfield / sports hall
	<b>vend vështrimi</b> viewpoint
	<b>varreza muslimane</b> cemeteries (islamic)
	<b>varreza ortodokse</b> cemeteries (orthodox)
	<b>pyll</b> forest
	<b>kryesisht bujqësi</b> mainly agriculture
	<b>hapstrat me kontaminim të mundshëm</b> possibly contaminated areas
	<b>gurorë</b> quarry
	<b>hapësirë e dikurshme ushtarake</b> former military area
	<b>deponi mbeturinash</b> landfill
	<b>lum/ rrjedhë</b> river / stream

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor urban i Gjilanit**  
Urban development plan and of Gjilan

**Pozita e qytetit-pejzazhi dhe ambientit**  
Situation Town-landscape and environment

14.04.2008

**Plan 2**  
Plan 2

**Përpjesa:**  
Scale:  
0 100m 500 1 km

**DREITORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT**  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

**IFECH**  
INSTITUTE FOR ENVIRONMENTAL RECONSTRUCTION AND URBANISM

**IMJ**  
INSTITUTE OF ARCHITECTURE AND URBANISM

**planingsgruppe 4**



## Shfrytëzimi i tokës

Qyteti i Gjiçanit ka një strukturë koncentrike. Distriktet e ndryshme të banimit dhe zonat industriale kanë pasur zhvillim rreth qendrës së qytetit.

Qyteti i vjetër i Gjiçanit është i vendosur në veri të qendrës së tanishme të qytetit. Ndërtesat e larta të qytetit janë rindërtuar pas Luftës së Dytë Botërore, por një numër i ndërtesave të vjetra ka mbetur ende. Vlen të përmendet se salla e qytetit që nga shekulli i 19-të ende është në përdorim. Qendra moderne e qytetit është ndërtuar gjatë viteve të 1950-ta dhe 1960-ta. Ndërtesat publike dhe blloqet e mëdha të apartamenteve e rrethojnë bulevardin qendror dhe parkun e qytetit.

Shumica e zonave të banimit janë zhvilluar në gjysmë rrethin perëndimor të qendrës. Dardania, në mes të rrugës për Koretishë dhe Prishtinë, ka një planifikim të rrjetit elektrik shumë të rregulluar. Shumica e distrikteve të qytetit kanë më shumë strukturë organike. Struktura e ndërtesave dominuese jashtë qendrës së qytetit janë ndërtesa dy deri katër katërshe.

Plani i ri rregullues- Qarku ka paraparë zhvillim të mëtutjeshëm të banimit dhe përdorimin e zonave të përziera në perëndim.

Shumë industri të mëdha janë të vendosura në pjesën jug-lindore të qendrës. Prodhimet pothuajse janë stopuar ose janë në nivel shumë të ulët. Fabrikat ishin ndërtuar në kohën kur kjo qendër ka qenë periferi e qytetit. Lagjja Arbëria në të njëjtën kohë ka shpërndarje shumë të afërt me qytetin, kështu që zonat banuese ekzistojnë menjëherë afër zonave industriale.

Gjithashtu ekziston një zonë industriale në veri-lindje të qendrës, rreth rrugës M25-3 drejt Bujanovcit. Prodhimi në shumë fabrika të mëdha gadi i ndërprerë, por shumë ndërmarrje të reja të vogla janë duke punuar në këtë zonë.

Baza e KFOR-it Kampi Monteith është i vendosur në bazën e armatës së ish-Jugosllavisë në këtë zonë. KFOR-i e ka lajmëruar mbylljen e kampit në fund të vitit 2006. Kjo mund të shkaktoj humbjen e vendeve të punës për shumë nëpunës civil, por gjithashtu do ta liroj një pjesë të madhe të zonës për zhvillim të qytetit.



Gurorja është e vendosur në rrugën për Artanë, në veri të qytetit. Ajo jo vetëm që krijon zhurmë dhe ndotje nga pluhuri, duke e shqetësuar zonën banuese në periferi, por gjithashtu e bllokoi në tërësi zhvillimin e qytetit në këtë drejtim.

Pjesët qendrore të qytetit kanë strukturë kompakte. Në disa pjesë të periferisë dhe përgjatë rrugëve kryesore dhe në lindje, është një strukturë e banimit shumë e shpërndarë.

#### **S** përparësitë

- Struktura urbane është kompakte,
- Qendra e qytetit është e fuqishme,
- Zonat për zhvillim në lokacione atraktive.

#### **W** dobësitë

- Zonat industriale pranë zonave të banimit – konflikti i shfrytëzimit të tokës,
- Shpërndarja urbane dhe shfrytëzimi joefikas në periferi

#### **O** mundësitë

- Zonat në fushat bregore në vendet atraktive mund të ri-zhvillohen në zona të reja banuese, dhe nga kjo lirohet shtypja e zhvillimit në tokat bujqësore.

#### **T** kërcënimet















- Pronat e paqarta mund ta pengojnë zhvillimin e preferuar.
- Ndërtimet pa leje përgjatë rrugës dhe miniera në pjesën veriore të qytetit mund ta bllokojnë zhvillimin e ardhshëm.

#### **→** qëllimet

- Shmangia e konfliktit të shfrytëzimit të tokës në mes zonës industriale dhe të banimit,
- Ndalja e shpërndarjes së pakontrolluar urbane,
- Zhvillimi i shëndoshë dhe i duhur i zonave të reja të banimit,
- Zhvillimi i zonave industriale në lokacione të përshtatshme.



Fig. 12: Gjiçë qendra e qytetit

	<b>Kufiri kadastral</b> Kadastral border
	<b>qendra e qytetit</b> city centre
	<b>hapsira me shfrytëzim kryesisht të përzier</b> mainly mixed use area
	<b>hapsira me shfrytëzim kryesisht shoqëror</b> mainly area for community use,
	<b>shkollë</b> school
	<b>institucionet parashkolore</b> day care centre
	<b>spital</b> hospital
	<b>hapsira me shfrytëzim kryesisht komercial/industrial</b> mainly commercial/industrial area
	<b>gurore</b> quarry
	<b>hapsira me shfrytëzim ushtarak</b> military area
	<b>bazë e KFOR-it</b> KFOR base
	<b>zonë rurale</b> village zone
	<b>park, ekzistues / i planifikuar</b> park, existing/planned
	<b>PVI</b> forest

 **Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor urban i Gjilanit**  
Urban development plan and of Gjilan

**Pozita e qytetit-shfrytëzimi i hapsirës**  
Situation Town-land use

14.04.2008

**Plan 3**  
Plan 3


**Përpjesa:**  
Scale:  
0 100m 500 1 km

**DIREKTORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT**  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

 **IFECH**  
INSTITUTE FOR CONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

 **IMU**  
INSTITUTE FOR URBANISM AND ENVIRONMENT

**planingsgruppe 4**







## Trashëgimia Kulturore

### Detyrat institucionale

Mbrojtja e monumenteve historike në Kosovë është përgjegjësi e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit. Detyra lidhur me identifikimin, dokumentimin, shqyrtimin, arkivimin dhe kujdesin për mbrojtjen e monumenteve historike në Kosovë i është dhënë Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës (IMMK) në Prishtinë. Krahas zyrave lokale të institutit ekziston edhe zyra e nivelit komunal, me seli në Gjiçan. Zyra Rajonale për Trashëgimi Kulturore është e vendosur në ndërtesën e teatrit në qendër të qytetit. Puna e instituti është e penguar nga fakti se të gjitha dokumentet mbi monumentet historike të prodhuara para luftës janë transferuar në Beograd.

Veprimtaria e stafit në Zyrën e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Gjiçan, është e përqendruar në identifikimin e llojeve të ndërtesave dhe strukturën e vendbanimeve si pjesë e trashëgimisë kulturore lokale. Këto njohuri do mundësojnë ruajtjen dhe ta bëjnë të mundur përdorimin më të mirë duke i ruajtur edhe vlerat kulturore nga e kaluara dhe ndihmojnë që të mbahen të gjalla për të ardhmen. Kjo normalisht është e siguruar, pasi që zyra është e përfshirë rregullisht në aplikimin e lejeve të planifikimit në qendrën historike të qytetit.

Për ti lehtësuar kushtet e punës së zyrave lokale, dhe për ta treguar rëndësinë e punës së saj është me interes që zyra të vendoset në një vend më të gjerë dhe të përshtatshëm për publikun. Sugjerohet që të përdoret ndërtesa Saraji i M. Pashës, e cila për momentin është duke u përdorur për Shkollë të Muzikës.

### Baza Ligjore

Deri në vitin 1949 në Kosovë si pjesë e ish Jugosllavisë, ishin identifikuar dhe klasifikuar ndërtesat me vlera historike si monumente historike. Gjithsej 426 objekte në Kosovë janë mbrojtur sipas Ligjit akoma të aplikueshëm të Kosovës mbi Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore të vitit 1977<sup>6</sup>. Në vitin 1992 dhe 1996 ishin miratuar ligje të reja në Serbi, por që nuk janë pranuar dhe shpallur në Kosovë; kështu, ligji i vitit 1977 është ende në fuqi. Pas viti 1968, megjithatë, asnjë ndërtesë më shumë nuk

<sup>6</sup> "Ligji mbi mbrojtjen e monumenteve kulturore"; Ligji i Kosovës nr. 19/77. në: përmbledhjen e Ligjeve: 1977



është atribuar për mbrojtje formale me ligj në Kosovë, vetëm sugjerime të objekteve relevante janë sistemuar përkohësisht. Për shkak të kushteve politike para luftës, mund të konsiderohet si e dyshimtë se zgjedhja e objekteve që duhet mbrojtur është bërë vetëm nga rëndësia shkencore. Preferencat kulturore, historike dhe vlerësimet nga këto pikëpamje duhen me qenë parësore.

Rëndësia e mbrojtjes së Monumenteve historike për zhvillimin komunal nuk është vetëm prosperiteti ekonomik, ai që krijon një qyteti modern, por gjithashtu faktorët e bukurisë së peizazhit të atij qyteti, llojlojshmëria e tij kulturore, indigjeni "shpirti" i lokacionit dhe tipari i tij i veçantë e i përfaqësuar në mes tjerash edhe nga ndërtesat e tij me historik. Në këtë këndvështrim, vetëdija e historisë lokale, daton matanë kohës së mesjetës, në origjinën Romane, Ilirike dhe madje parahistorike. Kështu që brenda një strategjie gjithëpërfshirëse për zhvillimin e komunës, ruajtja e vendqëndrimit të ndërtesave historike është më shumë se thjesht një çështje kulturore, e cila gjithashtu kontribuon në faktorët (e këndshëm) të zhvillimit komunal brenda një shoqërie moderne. "Trashëgimia kulturore dhe natyrore siguron ndjenjën e identiteti dhe ndihmon në dallimin e komuniteteve në atmosferën e globalizimit" MESP 2005, 14). Rëndësia e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Kosovë është e nënvizuar me notifikimin e tij në dokumentin zyrtar "Standardet për Kosovën" të cilët duhet të arrihen: "Trashëgimia kulturore e Kosovës është respektuar si pronë e përbashkët e të gjitha etnive, religjioneve dhe komuniteteve gjuhësore të Kosovës."<sup>7</sup>. Ky qëllim duhet të realizohet sipas standardeve të BE-së.



Fig. 13: Pllakati për një fushatë nga Ministria e Kulturës ka për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të publikut për trashëgimin kulturore.

Në komunën e Gjiçanit ekzistojnë shumëllojshmëri të ndërtesave historike që janë gjetur në qytet dhe në fshatrat e që e kanë mbijetuar rrjedhën e kohës, qoftë kur janë vlerësuar lartë vlerat të këtyre ndërtesave apo edhe periudhat e neglizhencës dhe shkatërrimit të tyre. Ato janë dëshmi të individualitetit kulturor lokal dhe rajonal, të ndërtuara në kushtet e veçanta historike, socio-ekonomike, etnike dhe fetare. Gjatë luftës së fundit Gjiçani luftës nuk i ka përjetuar dëmtimet të mëdha sikur rajonet tjera të Kosovës, kështu që edhe trashëgimia kulturore lokale nuk është dëmtuar aq shumë sa në vende tjera.

Asgjë nuk është ndërtuar përjetësisht, megjithatë, edhe substancat me të vogla historike duhet të pranohen. Sidoqoftë, për çfarëdo ndërjegje të shoqërisë, të së kaluarës së saj dhe origjinës së saj, është e domosdoshme që të definohet pozita e saj në kohën e tashme. Kjo ven veçanërisht për komunitetin shqiptar dhe kulturën e cila iu deshtë të bëjë ballë ndikimeve shekullore Otomane dhe serbe. Ruajtja e monumenteve kulturore e shqiptarëve ka qenë një bazë e rëndësishme për kohezionin e tyre. Kjo natyrisht vlen gjithashtu edhe për komunitetet e tjera etnike., edhe pse monumente të tilla historike të komuniteteve ne rajonin e Gjiçanit janë shumë të rralla. Për ta ruajtur atë që ka mbetur nga trashëgimia kulturore e ndërtesave historike dhe vendndodhjeve parahistorike, kjo çështje duhet të përfshihet edhe në një segment të planifikimit e tanishëm urban të qytetit dhe fshatrave të komunës së Gjiçanit.

Për Planin Zhvillimor qëllimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore, duhet të shndërrohet në veprime konkrete dhe duhet të



reflektohet se si të garantohet menaxhimi i duhur. Megjithëse prioritet i parë duhet të jetë aprovimi i një strategjie në ngritje e vlerave të këtyre objekteve, dhe përdorimi i tyre ,p.sh.

- Zgjerimin e hapësirave lokale për kohë të lirë,
- Prezantimi i vlerave kulturore dhe historike për tërheqjen e vizitorëve,
- Rritja e mirëkuptimit të ndërsjellë të komuniteteve të ndryshme,
- Tërheqja e investitorëve, sigurimi i punës etj.
- Mbështetja ekzistues e ndërtesave historike dhe mjedisi urban në Gjilan të llogaritura si trashëgimi kulturore (MMPH 2005, 15).

Ndonëse vendbanimi më i hershëm është dokumentuar se daton që nga shekulli i 14<sup>th</sup>, qyteti i tanishëm i Gjilanit është formuar në gjysmën e dytë të shekullit 18<sup>th</sup> nga familja Gjinaj. Kështu që qyteti është aq i "hershëm" sa edhe momentet e tij historike. Për shkak të situatës politike të mëparshme në Kosovë, dhe zgjedhja e njëanshme etnike e objekteve të trashëgimisë kulturore që mbrohen me ligj, është zvogëluar shumë numri i ndërtesa të tilla. Ka edhe objekte të rëndësishme historike që nuk janë të mbrojtura me ligj.

Tab. 26: Lista e Monumenteve Historike të mbrojtura me ligj /1/

#### Qarku I Kosovës dhe Anamoravës qyteti e Gjilanit

Nr.	Lokalitet		Shekull	
1.	Gjilan	Koleksion Ikonash në Kishën e Shën Nikollës	XIX,	nr.v. E.K. 02-153/80
2.	Gjilan	Shtëpi në Rr. Stojan Trajkoviqi, Nr. 19	XIX	nr.v. E.K. 02-254/80
3.	Gjilan	Atik Xhamia	XVII	nr.v. E.K. 02-156/80

**Shënim** /1/ Ligji mbi mbrojtjen e Monumenteve Kulturore nga Ish-Republika Federale e Jugosllavisë. (1977); cili ende është i aplikueshëm

**Burimi** : Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës

Me qëllim që të freskohet dhe kompletohet kjo listë e monumenteve historike, në vitet 2002 deri 2004 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, ka punuar në një inventarizim, duke i grumbulluar të dhënat mbi objektet me rëndësi kulturore në Kosovë, i cili mund të jetë një burim tjetër i informatave mbi ndërtesat që të radhiten në trashëgimin kulturore të vendit. Për më tepër ekzistojnë ndërtesa dhe vendqëndrime ose grupe ndërtesash me vlera historike dhe kulturore, tanimë të caktuara si ndërtesa historike, e të radhitura në bazën e të dhënave. Koj punë është realizuar nga Qendra Rajonale për Trashëgimi



Kulturore në Gjiçan. Të gjitha këto ndërtesa duhet të kujdesen në mënyrë të barabartë derisa të vendoset për më tepër për statusin e tyre ligjor për mbrojtje.

Tab. 27: Lisat e inventarizimit të Monumenteve Historike dhe Objekteve në Gjiçan sipas lokacioneve - Inventarizimi i Vlerave të Kulturës Materiale në Gjiçan sipas Tyre

Nr.	Komuna dhe vendi	Objekti	Periudha, Shekull, Viti
759	Gjiçan	Xhamia Qener Qeshme	Shekull XIX
758	Gjiçan	Xhamia Xhedit	Shekull XIX, Tani E Re
757	Gjiçan	Xhamia e Madhe	Shekull XIX – XX

**burimi:** Inventarizimi i trashëgimisë kulturore të objekteve në territorin e Kosovës (02); IKMMK Prishtina 2004 / 2006

**Shënim:** Puna e inventarizimit ende është në progres, e përgatitur nga Qendra Rajonale Për Trashëgimi Kulturorë e Gjiçanit

## Struktura e vendbanime historike dhe ndërtesave në qendrën urbane të Gjiçanit

Vlerësimi i objekteve të vlerave historike, megjithatë ndryshojnë gjatë kohës. Në tërë Evropën në vitet e 1960-ta ndërtimet tradicionale dhe modelet e vendbanimeve shpeshherë ishin kuptuar si shenja të prapambetura dhe ishin zëvendësuar më ndërtesa moderne për vendbanime. Kështu kishte ndodhur edhe me qendrën e Gjiçanit, duke i rrënuar ndërtesat e vjetra, ku qendra e qytetit ishte ri urbanizuar në vitet 1960-ta për krijimin e një sheshi të hapur të rrethuar me ndërtesa publike dhe banim kolektiv. (Sheshi i *Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës*).



Fig. 14: Burimi i Sahit Ages në Gjiçan, Çezma e Sahit Agës



Fig. 15: Ndërtesat e reja ndryshojnë karakterin urban historik përreth Atik xhamisë.



Fig. 16: Ndërtesa e zyrës së Kryetarit të Gjiçanit, në kohën e turqve, Objekti i kajmekamit.

Në vitet e fundit pas luftës, janë ndërtuar shumë objekte, shumica prej tyre ilegalisht, pa i respektuar kondita urbane të ndërtimit. Ka edhe raste që janë ndërtuar objekte të reje duke rrënuar ato të vjetrat pa marr në konsideratë as ndërtesat të cilat kanë pas vlerë kulturore dhe historike.



Për disa objekte fetare, xhamitë, teqetë ,tyrbet dhe kishat, një mjedis i rregulluar do të ishte i një interesi të veçantë.

Objektiva për zhvillimin e ardhshëm të qytetit duhet të jetë integrimi sa më adekuat i objekteve të trashëgimisë në strukturën e qytetit, duke i respektuar vlerat e tyre historike dhe kulturore, me objektet të reja për banim dhe veprimtari komerciale. Në këtë këndvështrim, vlen të përmendet inkorporimi i ndërtesës së kuvendit komunal,- Zyra e Kryetarit, Shkolla e Muzikës, Ndërtesa e vjetër e Gjykatës, dhe Depoja e Ushtrisë Osmane.

Objektivat e integritit të monumenteve historike në strukturën e qytetit, janë rregullimi adekuat i hapësirave përreth këtyre dhe ndërtimi i harmonizuar i objekteve të reja përreth. Kështu, një harmonizim i tillë do të rriste bukurinë e qytetit, ndërsa do ta rriste edhe hapësirën për dallim nga distanca e objekteve kulturore e historike. si për shembull pamja e Kishës ortodokse St. Nicolas të Parishit në Gjilan dhe Shillovë, që daton që nga viti 1861.



Fig. 17: Kisha ortodokse St. Nicolasi e Gjilanit dhe Shillovës e vendosur në një lokacion të qetë nga rruga e zmadhuar mbi çatitë e qytetit si karakteristik e pikës së referimit.

Edhe ndërtesave tjera me interes më shumë historik sesa kulturor dhe artistike duhet tu kushtohet kujdes i barabartë. P.sh. Fabrika e Duhanit e marrë si aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik në zonën e Gjilanit.

Shumë ndërtesa të vjetra të arkitekturës amtare të banimit që e kanë mbijetuar epokën e zhvillimit modern të qytetit nëpër vite ishin transformuar në objekte banimi pa asnjë udhëzim të planifikimit urban, veçanërisht në vitet e pas luftës, kur ishte urgjentisht nevoja për banimi. Ndonëse rindërtimi zakonisht ishte bërë brenda kornizës të strukturës së vjetër të vendbanimeve, volumi dhe madhësia e ndërtesave të reja



shumë shpesh i ka shkelur parimet më bazike të mbajtjes së standardit të mirë të ajrimit dhe ndriçimit të mjedisit. Vetëm një numër i ndërtesave me materialin origjinal të ndërtimit (mure argjile tjegulla murgu të çatave tra etj.) e kanë mbijetuar procesin e veprimeve të modernizimit pa i shkatërruar dhe modifikuar shenjat dhe mjedisin e tyre origjinal. Edhe disa shtëpi banimi si shenja të kulturës së jetesës së mëhershme në Gjilan dhe Kosovë, që i kanë mbijetuar kohës duhet të mbrohen me kujdes.



Fig. 18: ndërtesat banuese tradicionale

që janë mbajtur në pronën origjinale të ndërtimit. Në shtëpi në të majtë, ekziston një tavan i mrekullueshëm tradicional nga druri. Pronarëve duhet tu epet këshillë profesionale që ti mirëmbajnë këto monumente historike të arkitekturës amtare, për Gjilanin e vjetër.

Në rastet e tilla pronarëve duhet tu epet këshillë e mjaftueshme teknike dhe mbështetje profesionale, për ti mbajtur pronat e shtëpive të tyre si objekte të trashëgimisë kulturore të Gjilanit.

### Ndërtesat moderne të cilësisë së shkëlqyer të arkitekturës

Ndër shumë ndërtesa moderne në qendër të qytetit dhe ndërtesa e teatrit si dhe skulptura e madhe e bronzit përball tyre, e vendosur në sheshin qendror (*sheshi Rexhep Mala e Nuhi Berisha*), memorialin e dëshmorëve të rënë, ndonëse nuk është përmendur ende në asnjë listë, mund të duket si një objekt modern që kontribuon në trashëgiminë kulturore të Gjilanit.

Në kuptim të plotë trashëgimisë kulturore mund të shtohet edhe grumbullim i ndërtesave të shkëlqyeshme të cilat si kuotë duhet ti shtohet kujdes sepse edhe ato kanë një rendësi historike për qytetin. Kujdesi ndaj objekteve me vlera të caktuara është kulturë e gjeneratës së tanishme





për ato të ardhshme. Për revitalizimin e objekte me vlerë, të cilat janë dëmtuar gjatë kohës po krijohet një konkurrencë cilësore, duke zgjedhur projektin më të mirë dhe duke i shpërblye fituesit për dizajnë. Kostoja shtesë për konkurrencë do të kthehen në kualitet më të lartë të dizajnit dhe funksionalitetit të objekteve përkatëse.

### **S** përparësitë

- Disa struktura karakteristike të banimit të qytetit në mënyrë atraktive p.sh. kisha ortodokse dhe Xhamia Atike .
- Ndërtesat historike janë të shpërndara në tërë qytetin, përreth tyre mund të krijohet mjedisi atraktiv.

### **W** dobësitë

- Aktivitetet e pamasa të ndërtimeve në qytet pas luftës normalisht e kanë neglizhuar shkallën ekzistuese dhe strukturën e ndërtesave historike në rrethinë, duke i dëmtuar ato,
- Nuk ka qendër "historike " në të majtë me ndërtesa të mirëmbajtura nga ansamblet e tyre historike.

### **O** mundësitë

- Objektet historike do të mund të rinovohen në mënyrë profesionale nga Komuna, dhe do të mund të përdorën për qëllime publike.
- Vlera e gjësendeve të interesit kulturor dhe historik, p.sh. pjesët e objekteve të gjurmuar arkeologjike, nga të citat Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë i disponon, do të mund të shfaqën në muzetë historik. Kjo mund të shndërrohet në mënyrë përkryer në ndërtesë historike.

### **T** kërcënimet

- Veçanërisht ndërtesat banuese janë të rrezikuara, meqenëse pronarët mund të vendosin të ndërtojnë të reja, shtëpi më të rehatshme dhe më të mëdha për familjet e tyre.
- Meqenëse vetëm një numër i ndërtesave janë të mbrojtura me ligj, është e vështirë që të sigurohet mbrojtje e ndërtesave historike.
- Pronarët privat të objekteve të trashëgimisë kulture nuk dëshirojnë ti lënë të hapura pronat e tyre për vizitor.



## objektivat

- Duhet të ketë kujdes më shumë jo vetëm për objektet historike por gjithashtu edhe për rrethinat e tyre të afërta. Rindërtimi për ndërtesat në afërsi duhet domosdo duhet të merren në konsideratë dhe të iu ofrohen këshillave profesionale nga ekspertëve për pronarët e objekteve.
- Për ndërtesat e reja publike duhet të organizohet një konkurs për hartimin e planeve urbane dhe arkitekture për një funksionin më të mirë.

## Trashëgimia Natyrore

Mbrojtja e objekteve dhe zonave të trashëgimisë natyrore i është caktuar MMPH-së. Korniza ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë është siguruar me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit të vitit 2003. Sikurse trashëgimia kulturore gjithashtu edhe trashëgimia natyrore është një e mirë e përgjithshme, për tu shfrytëzuar dhe ruajtur nga të gjithë, të trashëgohet nga ne dhe gjenerata e ardhshme. Momentalisht vlerat e trashëguara natyrore janë të rrezikuara, pasi që pas luftës zonat e mëdha kishin qenë subjekte të zhvillimit të pakontrolluar për një të ardhme më të afërt dhe brenda tyre (MESP 2005-2, 59).



## **S** përparësitë

- I vendosur në mes të peizazhit të këndshëm, i cili është i duket nga brendia e qytetit, qyteti ka mjedis të përshtatshëm natyror.
- Përrenjtë që kalojnë përmes zonës së qytetit mund të kombinohen me zona të parqeve.
- Ekzistojnë shumë lisa në qytet që sigurojnë hije në kohët e nxehta të verës.

## **W** dobësitë

- Nuk ka zona të mëdha publike të gjelbra në qytet.
- Brigjet e lumenjve në qytet nuk janë të mirëmbajtura. Nuk ka shëtitore atraktive.

## **O** mundësitë

- Zona e gjelbër në qendër të qytetit mund të zhvillohet më tej në një zonë shumë atraktive për kohë të lirë.
- Më herët Gjilani ka qenë i njohur me burimet e ujit. Ato mund të riaktivizohen në zona të gjelbra publike.

## **T** kërcënimet

- Ende veprimet e ndërtimit tentojnë që ti shkatërrojnë zonat e gjelbra private për ndërtime të reja. Kjo gjithashtu ka efekt në sjelljen e ajrit cilësor në brendi të qytetit.

## **→** objektivat

- Krijimi i parqeve të gjelbra publike brenda distancave të trotuareve nga qendra e qytetit si zona për rekreacion dhe kohë të lirë.
- Të krijoj shëtitore përgjatë lumenjve të zbukuruara me lisa dhe të kombinuar me zona për kohë të lirë.
- Integrimin e objekteve natyrore si fontanave dhe burime në zonat e gjelbra publike.
- Siguroj zona të përshtatshme të hapura të gjelbra në prona private, për ta mënjeluar dendësinë e lartë. .

## **Vendbanimet Joformale(VBJF)**

Vendbanimet joformale janë definuar si vendbanime njerëzore të cilat, nuk u mundësojnë banorëve të vet t'i gëzojnë të drejtat e tyre për një



standard të jetesës, banim adekuat. Si të tilla ato shquhen me karakteristikat si vijon:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë,
- Qasje joadekuata ose privim nga shërbimet elementare,
- Pjesëmarrje joadekuata ose mospjesëmarrje në qeverisje
- Rrezikshmëria deri në diskriminim .

Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për Standardin 6 “E Drejta Pronësore në vendbanimet joformale”. Zbatimi i të drejtave pronësore është qenësor për të inkurajuar kthimet dhe trajtimin e barabartë të të gjitha bashkësive etnike.

Prandaj, Ministria e mjedisit, së bashku me Komunat, UN-Habitatin dhe Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës kanë bërë një hulumtim të VBJF në 4 qytete të Kosovës dhe atë në Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Gjiilan.

Në qytetin e Gjiilanit janë hulumtuar tri vendbanimet joformale të cilat janë zgjedhur nga klasifikimi i bërë nga grupi i interesit dhe OSCE si dhe nga identifikimi i zyrtarëve komunal të cilët janë bazuar në gjendjen aktuale kadastrale dhe të planeve ekzistuese urbane. Po ashtu janë marrë parasysh edhe karakteristikat ekzistuese të vendbanimeve joformale të përshkruara nga grupi i palëve të interesit për VBJF në Qeverinë e Kosovës. Këto tri lagje janë: lagjja “Abdullah Presheva”, rruga “Marie Shllaku”, dhe lagjja “Zabeli i Sahit Agës”.

Ndonëse shumica e vendbanime joformale në Kosovë nuk karakterizohen me pasigurinë e pronës, në vendbanimet e hulumtuara në Gjiilan, ekzistojnë raste të papërcaktuara të pronësisë, ku shfrytëzuesit nuk janë në posedim të pronës. Një numër i vogël i uzurpimeve të janë në proces të zgjidhjes.

Ajo që i karakterizon vendbanimet joformale në Gjiilan janë:

- Qasje joadekuata ose privim nga shërbimet elementare,
- Pjesëmarrje joadekuata ose mospjesëmarrje në qeverisje.

Mungesa e shërbimeve cilësore është arsyeja kryesore për pjesëmarrje joadekuata e qytetarëve ose mospjesëmarrje në qeverisje. Kur autoritetet nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbimet elementare të infrastrukturës teknike dhe sociale, banorët e humbin interesin të marrin pjesë në qeverisje.




Dy lagjet e para janë kryesisht të banuara me komunitetin rom dhe ato për shkak të vjetërsisë së tyre tanimë janë në pjesën qendrore të qytetit. Infrastruktura fizike në këto dy lagje edhe pse ekziston, ajo është joadekuate. Posaçërisht rrugët dhe hapësirat publike janë ato të cilat e vështirësojnë gjendjen.

Arsimi fillor dhe parashkollor paraqet problem të madh në tërë qytetin për shkak se hapësirat janë të pamjaftueshme. Mirëpo, në të dy këto lagje, shërbimet themelore janë në afërsi. Shkolla dhe objekti shëndetësor janë në afërsi, kurse arsimi parashkollor është në largësi shumë të madhe.

Lagjja "Zabeli i Sahit Agës" është e banuar kryesisht me shqiptarë. Lokacioni i saj është në periferi dhe ndërtimi i shtëpive është bërë në mënyrë të shpërndarë dhe me dendësi të vogël gjë që ndikon në vështirësimin e ofrimit të infrastrukturës. Sa i përket shërbimeve themelore, në këtë lagje nuk ka asnjë shërbim i cili mund ta karakterizojë vendbanimin si urban. Lidhjet me qytetin janë të kufizuara vetëm në transportin individual me automjete vetanake si dhe me shërbimin taksist i cili është efikas.

Përveç këtyre, nga zyrtarët komunal janë identifikuar edhe 9 vendbanime tjera joformale. Tani është e domosdoshme që të gjinden rregullore të aplikueshme për ndaljen e aktiviteteve dhe rregullimin e kushteve në këto vendbanime dhe zgjidhjen e statusit të tyre.

Fig. 19: VBJF të identifikuara nga zyrtarë komunal



### Katastrofat natyrore dhe te shkaktuara

Territori i komunës së Gjilanit, vazhdimisht është ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe aksidente të ndryshme, ku në masë të madhe shkaktohen dëme materiale si në pjesën urbane ashtu edhe në atë rurale. Shpesh herë nga fatkeqësitë aksidentale, pos dëmeve materiale, kemi edhe humbjen e jetës së njerëzve.

Kështu që Drejtoria e MC dhe Emergjencës ka përgjegjësi në menaxhimin e këtyre emergjencave, si që janë :

- Zjarret,
- Vërshimet,
- Tërmetet,
- Fatkeqësitë tjera elementare,



Fig 20: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë

Burimi Plani Hapësinor i Kosovës



## 1.2.d INFRASTRUKTURA

### Rrjeti rrugor dhe hekurudhor

Qytetit i Gjiçanit ka pozitë shumë të favorshme për kalimin e rrugëve magjistrale dhe rajonale. Përderisa të gjitha këto rrugë të drejtojnë drejtpërdrejt për në qytet, bllokimi i trafikut dhe rrugët e bllokuara janë të zakonshme. KFOR-i e ka ndërtuar një rrugë anësore në perëndim të qytetit, e cila e ka lehtësuar brendësin e qytetit nga trafiku përmes M25-2. Drejtimi për në Preshevë dhe rrugët për Malishevë dhe Pogradec nuk janë të lidhura në rrugën anësore.

Shumë pjesë të trafikut kanë destinacionin e vetë përbrenda qytetit, e cila e limiton efektin e rrugës anësore edhe më shumë. Ekziston një zonë e madhe industriale gjatë M25-2, në veri-jug të qytetit. Për momentin prodhimi është në shkallë shumë të ulët, por kjo zonë industriale normalisht mund ta tërheq shumë trafikun e ngarkuar .

Trafikun po e ngarkojnë edhe automjetet për shkarkimin e mbeturinave në deponinë rajonale në jug-lindje të qytetit. Rruga e kësaj deponie shkon në M25-2 përmes Arbërisë, dhe më tej në një rrugë lokale të kualitetit të dobët.

Shumica e trafikut shkaktohet nga ndërmarrje shumë të vogla të shpërndara nëpër gjithë qytetin. Shkallën e madhe të automjeteve për kokë banori po e rritë trafikun në qytet i cili trafik ka tendencë rritjeje edhe me të madhe. Këto probleme mund të zgjidhen pjesërisht me rrugët anësore efektive dhe rrugë tjera alternative jashtë qendrës së qytetit, por kapaciteti i rrugëve ekzistuese dhe kryqëzimeve duhen të rriten në të njëjtën kohë .

Një problem tjetër është mungesa e shumë parkingjeve publike në qytet. Kjo po shkakton parkim të egër nëpër rrugë duke e zvogëluar edhe më shumë kapacitetin e rrugëve në qytet.

### Transporti dhe Mobiliteti

Gjiçani nuk ka lidhje hekurudhore. Transporti publik kryhet me autobus, dhe përgjegjës për transport në Qytet është Drejtoria për Shërbime Publike. Ekziston një stacion qendror i autobusëve në jug të qendrës së qytetit. Transporti publik në Gjiçan është i ndare në:

- Transportin Urban ,





- Transportin Urban-Periferik dhe,

Transporti Urban në Gjilan kryhet me kombibusë dhe taksi të vegjël. Kjo nuk është rentabile dhe e ngarkon shumë trafikun në qytet

Transporti Publik në përgjithësi pengohet nga Rrugët e ngushta, Udhëkryqet joadekuate, mungesa e parkingjeve dhe stacioneve urbane, trasave rrugore të parapërcaktuara për autobusë lokale si dhe nga mungesa e shtigjeve për këmbësorë dhe atyre për çiklistë.

#### **S** përparësitë

- rruga by-pas në perëndim të qytetit e largon trafikun e rëndë prej qendrës së qytetit.

#### **W** dobësitë

- pozita e Gjilanit në kryqëzim të disa rrugëve magjistrale e ngarkon trafikun.
- probleme të mëdha të trafikut në qendër të qytetit,
- standardi i ulët i rrugëve e ul kapacitetin e tyre,
- trafiku prej drejtimit Preshevë dhe Pogradjë nuk mund ta kalojë qendrën e qytetit me rrugë by-pas ,
- mungesa e parkingjeve të mjaftueshme shkakton parkingun e egër.

#### **O** mundësitë

- Rruga By-pas ekzistuese mund të zgjerohet në një rrugë unazore komplete që ta mbaj trafikun që kalon përmes , jashtë brendësisë së qytetit dhe ta përmirësojë mundësin e hyrjes në qytet.

#### **T** kërcënimet

- Mbingarkimi i rrugëve.

#### **→** qëllimet

- largimi i trafikut përmes qendrës së qytetit,
- ngritja e kapacitetit dhe kualitetit të rrugëve ekzistuese,
- zgjidhja e probleme të parkingut në qytet.

Fig. 21: Trafiku në qendër të qytetit



### Infrastruktura Teknike

Në përgjithësi infrastruktura është në nivel jo të kënaqshëm dhe nuk i plotëson nevojat për banorët e Komunës, duke filluar nga sasia pamjaftueshme e ujit të pijes, kanalizim i pamjaftueshëm si dhe rrjeti i vjetruar i PTT-së. Prandaj është nevojë e domosdoshme investimi në evitimin e problemeve të cilat na rrjedhin si pasojë e mosfunksionimit të infrastrukturës.

Parakusht për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik është edhe modernizimi i infrastrukturës energjetike dhe të trafikut që nënkupton modernizimin e trafikut rrugor, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit , rrjetit energjetik dhe racionalizimin e komunikacionit dhe lidhjeve.

Shërbimet komunale të cilat iu ofrohen qytetarëve në Qytetin e Gjilanit janë:

- Furnizimi me ujë të pijes,
- Furnizimi me rrymë elektrike,
- Shërbimi i zjarrfikësve,
- Ndriçimi i rrugëve dhe i parqeve,
- Ndërmarrja për distribuimin e rrymës elektrike "KEK-Njësia Gjilan",
- Ndërmarrja për furnizim me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit "Hidromorava",
- Ndërmarrja për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike "Higjiena".



Transporti – Në Komunën e Gjilanit është një ndërmarrje transportuese shoqërore dhe 21 kompani private transportuese si dhe 136 autotaksi; nuk ka hekurudhë, stacioni më i afërt i trenave është në Ferizaj 33 km larg. Aeroporti më i afërt është në Prishtinë rreth 60 km larg nga Gjilani

### Ujësjellësi

Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit është mbi 70 km, me dimensione Ø50 - Ø400. Rreth 75-80 % e rrjetit e ka kaluar afatin e eksploatimit. Prej vitit 2000 janë punuar dy rrjete të reja, rrjeti i spitalit, 4 000 m gjatësi dhe rrjeti nëpër qytet 5100 m gjatësi. Vëllimi i pendës së Përlepticës është 4 000 000 m<sup>3</sup>, ndërsa vëllimi shfrytëzues është 3,200,000 m<sup>3</sup>. Kapaciteti maksimal i prodhimit është 300 l/s, ndërsa kapaciteti i prodhimit momental është 100 l/s. Në këtë ndikon rrjeti i ngushtë Ø 400 i ujësjellësit Përlepticë - Gjilan. "Guri i Hoxhës", varësisht nga stina, jep 60-80 l/s, ndërsa Baja e Qytetit, varësisht nga stina, jep 20-30 l/s. Prodhimi momental është 180-200 l/s. Por, të gjitha këto nuk mjaftojnë. Si rrjedhojë e instalimeve të vjetra, shumë ujë humbet gjatë qarkullimit. Gjithashtu, shumë zona nuk janë të lidhura në rrjet.

Ujërat e zeza nuk trajtohen fare në impiante, ato derdhen direkt në lumë. Gjatësia e këtij rrjeti është 60km, ndërsa e rrjetit atmosferik vetëm 4km. 80% e rrjetit të kanalizimit është e vjetër 20 vjet.

Për furnizim me ujë ujësjellësi i qytetit shfrytëzon këto burime kryesore:

- Akumulacioni "Penda" në Përlepticë, kapaciteti i prodhimit 110 – 120 l/s, distribuimi i ujit me gravitet.
- Kaptazha "Guri i Hoxhës", kapaciteti i shfrytëzimit 60-70 l/s, distribuimi i ujit me gravitet,
- Burimi "Baja" në qytet, kapaciteti 25-30 l/s, distribuimi i ujit me pompim.

Kompania "HIDROMORAVA" Gjilan menaxhon me këto asete:

- "Penda" në Përlepticë H=30 m e lartë, vëllimi akumulues V= 4 milion m<sup>3</sup> dhe duke përfshir arealin prej 33 ha,
- Fabrika për përpunimin e ujit në Përlepticë,
- Rezervuari i ujit në "Kodrën e Dëshmorëve" në qytet, me vëllim prej 500 m<sup>3</sup>,
- Kaptazha "Guri i Hoxhës", 3 km larg akumulacionit në Përlepticë,
- Stacioni i pompimit "Baja" në qytet.




Tab. 28: Prodhimi mesatar i ujit në vitin 2004

Burimi	Kapaciteti mesatar l/s	Prodhimi orë/ditë	Sasia vjetore m <sup>3</sup>	Humbjet	
				%	m <sup>3</sup>
“Penda”	100 – 120	24	3,421.440		
“Guri i Hoxhës”	60 –70	24	2.332.800		
“Baja”	25 – 30	24	855.360		
Gjithësej:	190 – 230		6,609.600	50	3,304.800

Burimi:Kuvendi Komunal

Fig. 22: Shtirija hapësinore e rrjetit të ujësjellësit






Duke pas parasysh nevojat për ujë të pijshëm që sillen prej 450 deri 550 l/s, është e qartë nevoja e gjetjes së mundësisë për mbulimin e nevojave për ujë. Për momentin, kapacitetet e furnizimit me ujë në Gjilan janë maksimalisht 230l/s.

Duke pasur parasysh rëndësinë e ujit të pijshëm, një nga projektet kyçe dhe më përparësi do të ishte hulumtimi i mundësisë së sigurimit të kapaciteteve të mjaftueshme për ujin e pijes.

Fig. 23: Harta hidrologjike e Gjilanit





## Kanalizimi

Gjiçani ka përafërsisht mbi 80.000 banorë, ndërsa për rrjet të kanalizimit nuk ka shënime të sakta, por vlerësohet se rrjeti i kanalizimit ka përafërsisht gjatësinë prej rreth 65 km.

Rrjeti ekzistues nuk i përmbush kërkesat e popullsisë. Mu për këtë qytetarët gjinden ashtu siç munden. Edhe ujërat fekale derdhen në lumenjtë ( Mirusha, Baja dhe Stanishori) që kalojnë nëpër qytet, të cilët janë mjaft të ndotur.

- Gjiçani disponon me rrjetin e ujërave të zeza ( ujërat teknologjik, fekale dhe ujërat atmosferike),
- Kanalizimi i ujërave atmosferike, edhe pse ka ekzistuar në disa pjesë: rrugën Medllin Ollbrajt, Gjon Sereqi dhe një pjesë e Dradanisë, është në gjendje shumë të keqe. Në këtë rrjet janë të kyçur edhe shumë qytetarë duke mos pas zgjidhje tjetër. Mu për këtë, Gjiçani nuk ka sistem të ndarë të kanalizimit.
- Rrjeti i kanalizimit të qytetit ka filluar të ndërtohet në vitin 1970- 1978 kur edhe është bërë pranimi teknik i tij. Sipas statistikë, Gjiçani në atë kohë ka pas 21258 banorë. Gjatësia e kanalizimit ka qenë rreth 25 km me diametër të gypave prej Ø 150- Ø 400. Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza edhe pse ishte ndërtuar në vendin e quajtur " Mulliri i Arapit", asnjëherë nuk ka funksionuar.
- Edhe ujërat fekale derdhen në lumenjtë pa ndonjë trajtim adekuat. Gjithashtu edhe kolektori kryesor derdhet në lum të vendi i quajtur "Mulliri i Arapit".



Fig. 24: Shtirja hapësinore e rjetit të kanalizimit



**S** përparësitë

- Hidrografia e pasur,
- Mundësia e zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Burime potenciale të ujit.

**W** dobësitë

- Mungon trajtimi i ujërave të zeza,
- Mungon kanalizimi i ujërave industrial,
- Shfrytëzimi jorracional i ujit të pijshëm,
- Mosekzistimi i kadastrit nëntokësor.

**O** mundësitë

- Rregullimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Ndërtimi i një impianti për trajtim të ujërave të zeza,
- Hulimtimi i burimeve të reja të ujit.
- Mbrojtja e zonave ujore.

**T** kërcënimet

- Ndotja e ambientit,
- Sëmundjet e rrezikshme,
- Mbyllja e koridoreve për zhvillim të mëtutjeshëm të rrjetit.

**Menaxhimi i Mbeturinave**

Kompania rajonale e grumbullimit të mbeturinave "Higjena"- Gjiçan i ka të punësuar 141 punëtorë në tri njësi punuese:

- Gjiçan,
- Viti dhe
- Kamenicë.

Vetëm në Gjiçan janë të punësuar 102 punëtorë të cilët bëjnë grumbullimin e mbeturinave nga kontenierë dhe mbeturinat e amvisërisë ( derë më derë), grumbullon mbeturina edhe të 15 fshatrave (Gjiçani ka 55 fshatra), bën pastrimin e rrugëve, trotuareve dhe shesheve si dhe pastron rrugët nga bora në sezonin e dimrit. Kjo kompani mirëmban sipërfaqet e gjelbëruara të Gjiçanit.

Në deponin rajonale të Gjiçanit, në vitin 2006 janë grumbulluar rreth 15 723 ton mbeturina.

**S** përparësitë

- Infrastruktura ligjore,
- Ekzistimi i ndërmarjes publike për menaxhim të mbeturinave,
- Ekzistimi i deponisë rajonale.



**W****dobësitë**

- Mos ekzistimi i deponive të ndara për mbeturina industriale, mjekësore dhe ndërtimore.
- Mostrajtimi i deponive të mbyllura ekzistuese,
- Deponitë ilegale.

**O****mundësitë**

- Përcaktimi i kompetencave në menaxhim,
- Vetëdijesimi i popullatës për problemet e mjedisit,
- Shpërndarja e shërbimit për mbledhjen e mbeturinave në zonat rurale,
- Ndërimi i mënyrës së mbledhjes së mbeturinave.

**T****kërcënimet**

- Mos definimi i kompetencave në menaxhim,
- Përhapja e ndonjë sëmundje të rrezikshme,
- Hapja e deponive të reja ilegale.

**Furnizimi me energji elektrike**

Komuna e Gjilanit furnizohet nga trafostacioni **Prishtina IV**, TS 2x150MVA, 220/110kV përmes largpërçuesit nr.184/1, Al-Qe 3x240mm<sup>2</sup>-35.3 që e furnizon TS110/35(20+31.5)MVA. Në Gjilan ekzistojnë 4 TS 35/10 kV: GL-1, GL-2, GL-3 dhe Lladova, 24 km lidhje kabllorike dhe 347 km lidhje ajrore me gjithsej 3 476 shtylla elektrike dhe 271 trafostacione 10/0.4 kV, me gjithsej 57 MVA fuqi instaluese 35/10(kV) dhe 51.5 MVA fuqi instaluese TS 110/35 (kV).

Edhe pse pas luftës janë bërë shumë investime në infrastrukturë nga donacionet për të forcuar rrjetin energjetik, akoma mbetet shumë për të bërë edhe në aspektet tjera të infrastrukturës fizike. Sikur edhe në pjesët tjera të Kosovës, ekziston mungesë e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë gjatë stinës së dimrit. Kjo është duke ndikuar negativisht në funksionimin e firmave biznesore. Derisa të gjendet një zgjidhje afatgjatë për sigurimin e energjisë elektrike jo vetëm për bizneset kosovare por edhe për spektrin e gjerë të konsumatorëve tonë, duhet marr parasysh kontratat speciale në mes të kompanisë së energjetikës dhe firmave të cilat konsumojnë sasi të mëdha të energjisë elektrike, për të cilat ndërprerja e energjisë elektrike do të kishte pasoja tepër të rënda në biznesin e tyre.

Tab. 29: Gjatësia e rrjetit elektrodistributiv

Rrjeta e Tensionit kV	Rrjeta Ajrore në Km							Rrjeta Kablllorike	Gjithsej
	Në shtylla të drurit			Në shtylla çelik-beton			Gjithsej		
	Të painp egrume	Të impregume	Gjithsej	çelik	Beton	Gjiths.	a + b		
110									
35				33.88	49	82.818	82.818	0,342	83.16
20		15.23	15.23	5.036	32.416	37.452	52.682	83	60.982
10	677.546		677.546	08. Mai	189.024	197.524	875.07	34.074	909.144
0.4							1,926.68	24.21	1950.89

Fig. 25: Rrjeti Elektrik i Kosovës



Burimi: Plani Hapësinorë i Kosovës

Fig. 26: Nënstacionet e reja 110/20(10)kV në Kosovë

**Nënstacionet e reja 110/20(10)kV në Kosovë**

Burimi:KEK

**S** përparësitë

- Mbulimi i tërë territorit me rrjet energjetik,
- Pozita e mirë gjeografike dhe afërsia me burime termoenergjetike,
- Ekzistimi i pasurisë pyjore,
- Ekzistimi i rrjetit energjetik rajonal.

**W** dobësitë

- Infrastruktura energjetike e vjetruar,
- Mosshfrytëzimi i mundësive alternative,
- Menaxhimi i dobët,
- Format joadekuate të shfrytëzimit të energjisë elektrike.

**O** mundësitë

- Ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore,
- Ndërtimi i rrjetit nëntokësor elektroenergjetik,
- Privatizimi,
- Organizimi i partneriteteve publik- privat.

**T** kërcënimet

- Ngecja e zhvillimit,
- Degradimi i ambientit dhe kualitetit të jetës,



## Telekomunikacioni

Kapaciteti i centralit telefonik në Gjilan është 10,000 numra. Viti i prodhimit 1980, viti i instalimit 1989. Numri i parapaguesve 9000. Numri i parapaguesve të Vala 900 është 10,000.

Numri i antenave në: Gjilan – 6 antena, Capar – 1, Livoq – 1, Maja e Gjelbërt – 1 dhe Miresh – 1. Numri shtyllave në Gjilan dhe fshatra është 785 copë.

Gjilani është një nga Qytetet që ka pasur një përfaqësim të kënaqshëm në shtyp dhe media. Pos klubit të korrespondentëve që raportojnë nga Gjilani në mediat qendrore të Kosovës, në Gjilan ekzistojnë edhe dy televizione të pavarura si dhe pesë radiostacione. Klubi i Gazetarëve: TV Vali, TV Men, Radio-Gjilani, Radio-Viktoria, Radio-Energji dhe Radio-Rinia.

Fig. 27: Shtirja hapësinore e rrjetit të Telefonisë fikse në Gjiçan

**S** përparësitë

- Kalimi i fibrës optike nëpër territorin e komunës,
- Teknologjia e avancuar (pjesërisht),
- Pozita strategjike e (volitshme) komunës
- Digjitalizimi i centraleve,
- Telefonia në pjesën më të madhe të qytetit.

**W** dobësitë

- Rrjeti i pavolitshëm i zyrave postare,
- Rrjeti i zgjatur telekomunikues,
- Mosmbulimi i territorit me rrjet të telefonisë,
- Rrjeti kabllor i vjetruar,
- Mos afrimi i shërbimeve në brezin e gjerë,

**O** mundësitë



- Përmirësimi i rrjetit kabllorë,
- Vendosija e centraleve periferike,
- Ofrimi i shërbimeve të brezit të gjerë,
- Vendosija e centraleve periferike.

#### **T** kërcënimet

- Monopoli në shërbime,
- Mungesa e kadastrit nëntokësor,
- Zhvillimi i paplanifikuar,

### **Transporti Publik**

Gjiçani nuk ka lidhje hekurudhore. Transporti publik kryhet me autobus, dhe përgjegjës për transport në Qytet është Drejtoria për Shërbime Publike. Ekziston një stacion qendror i autobusëve në jug të qendrës së qytetit. Transporti publik në Gjiçan është i ndarë në:

- Transportin Urban ,
- Transportin Urban-Periferik


Rrjeti i ujsjellësit



Rrjeti i kanalizimit



Rrjeti i telefonisë fikse



- Kufiri kadastral  
Katastral border
- rrugë magjistrale  
magistral road
- rrugë rajonale  
regional road
- rrugë kryesore e brendshme e qytetit ekzistuese / e planifikuar  
main inner-city street, existing/planned
- rrugë lokale, ekzistuese / e planifikuar  
local road, existing / planned
- deponi e ujërave të zeza (jashtë funksionit)  
Sewage plant (out of order)
- stacioni i autobusëve  
bus station
- Rezervoaret e ujit  
Water tank
- trafostacionet  
transformer stations  
SS 35-10 / SS 110-35  
SS 35-10 / SS 110-35

**Kuvendi Komunal Gjiilan**  
Municipal Assembly Gjiilan

**Plani zhvillimor urban i Gjiilanit**  
Urban development plan and of Gjiilan

**Pozita e qytetit - trafiku dhe infrastruktura teknike**  
Situation Town - Traffic and Technical Infrastructure  
14.04.2008

Plani 4  
Plan 4

Përpjesa: Scale:  
0 100m 500 1 km

DREJTORIA PËR URBANIZIM, RINDËRTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT



### 1.2.1 Analiza e profilit

Kjo analizë shqyrton ndikimin e çështjeve të hulumtuara të cilat në formë të përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve (SWOT analizat) paraqesin faktorët kryesorë për zhvillimet e ardhshme.

SWOT analizat janë të prezantuara veç e veç nëpër fushat tematike.

### 1.2.2 Analiza e ndërlidhjeve ne mes të çështjeve, politikave dhe programeve

#### Qeveria Lokale

Forma e qeverisjes lokale në Kosovë është Komuna. Komuna rregullon dhe udhëheq çështjet publike brenda territorit të saj për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët. Ajo kujdeset, gjithashtu, për çështje me interes të përgjithshëm që ndërlidhen me komunën dhe nuk mund të shqyrtohen vetëm nga pushteti qendror apo ndonjë organ tjetër.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i komunës, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në Komunën e Gjilanit Kuvendi ka sot 41 këshilltarë, që përfaqësojnë parti të ndryshme politike.

Veprimtaria e pushtetit lokal drejtohet nga Kryetari i Komunës dhe nga dy Nënkryetarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Komunës nga përbërja e këshilltarëve të tij.

Kjo veprimtari realizohet përmes administratës së komunës, e cila drejtohet nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve. Në Bordin e Drejtorëve bëjnë pjesë drejtorët e 11 Drejtorive, të cilat formojnë strukturën organizative të administratës së komunës. Këto Drejtori janë:

- Administratë Komunale,
- Kulturë, Rini dhe Sport,
- Buxhet, Financa dhe Investime,
- Arsim,
- Shërbime Publike,
- Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient,
- Ekonomi dhe Menaxhment,
- Shëndetësi dhe Çështje Sociale,
- Siguri dhe Emergjencë
- Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi,
- Bujqësi dhe Pylltari,
- Zyra për Komunitete Lokale.




Komuna e Gjilanit qeveriset sipas Rregullores së UNMIK 2000/45, e cila qartazi definon përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë. Mirëpo, ekzistojnë disa ligje dhe rregullore të tjera që janë miratuar nga pushtetit qendror e të cilat kanë krijuar konflikt interesash ndërmjet komunës dhe qeverisë qendrore në fushën e shërbimeve të kompanive publike, shërbimit civil të Kosovës, arsimit fillor dhe atij të mesëm, menaxhimit të tokës komunale dhe/ose shoqërore, ku problematika e fundit rrjedh nga fakti se në të kaluarën, në shumë raste, dallimi ndërmjet tokës në pronësi komunale dhe shoqërore nuk ka qenë i qartë.

### Bashkëpunimi Ndërkufitar

(Gjilan, Preshevë, Kumanovë)

Një iniciativë e parë e tillë u mbajti me 20 Nëntor, 2003 ne Preshevë, përderisa e dyta initiative është mbajtur me 16 Shkurt 2004 ne komunën e Gjilanit, që do të mirëpritet nga Qendra Rinore, e titulluar: "Roli Mikro-rajonat i të Rinjve në Zgjedhjen e Problemeve të tyre të Përbashkëta" (tryeze e rumbullaket).

Fig 28: Harta e Iniciativës dhe Emblemi i sajë



Kjo ngjarje e propozuar multietnike do të përgatitet ne bashkëpunim te ngushte me tri Grupet Punuese komunale dhe partneret e tyre lokal përkatës te cilët punojnë me te ritë e moshave 16-18 vjeçare (OJQ-të, klube te mediave, asociacionet e mësimdhënësve, zyrtaret e Komunitetit Lokal etj), nen kushte te favorshme te EWI-te menaxhuar TFC-Projekti ne Kosove.

Objektivat e bashkëpunimit ndërkufitar janë:



- Te ndihmojnë një kontakt të fillë të rëndësishëm pas konfliktit, ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme në mikro-rajon, me qëllim të kthimit të multi - etnicitetit me tepër se sa fjalë në letër;
- Të ofrojnë studentëve një forum të lartë bashkëveprues për diskutime në një përpjekje për të ofruar zgjedhje për të ardhmen për gjeneratat e së ardhmes;
- Të dëshmojë potencial për bashkëpunim bazë e cila tashmë ekziston në rajon me vullnetin e manifestuar nga zyrtarët lokal komunal;
- Të iu japin rast qe të rinjtë të ndërtojnë rrjetin ndërmjet tyre në mikro-rajon;
- Të fillojnë identifikimin e liderëve potencial të gjeneratës së re të mikro-rajonit dhe të iniciojnë modelin e bashkëpunimit ndërmjet tyre;
- Të zgjerojnë anëtarët e Grupeve Punuese përmes participimit direkt te OJQ-ve,të Rinjve dhe Asociacioneve të mësimdhënësve në ngjarje;
- Të vazhdojnë ta ngritin vetëdijen për realizimin e projektit, përmes participimit në media dhe buletine informative të shkollave.



Pjesëmarrës ishin 30 nxënës të shkollave të mesme të moshës 16-18, për të përfaqësuar komunën e Kumanovës, Preshevës dhe Gjiçanit në Tryezën e Rrumbullaket (7-10 nxënës nga secila komune); 3 mësimdhënës (1-2 mësimdhënës prej secilës komunë) të bashkëshoqërojnë nxënësit nga komunat përkatëse dhe 2 Përkthyes/delegacion komunal.

Fig 29: Gjiçani, qendra e trekëndëshit të dyfisht



### Programet zhvillimore

(E marrë si synim i Grupeve Punuese dhe Sektorit Privat dhe Publik nga „Agjenda Zhvillimore Komunale“)

**Vërjetje** : Për implementimin e suksesshëm të këtyre projekteve do të bëjmë përpjekje të arrihet përmes :

- Buxhetit vetanak,
- Ndihmës së Komunitetit Ndërkombëtarë / OJQ –ve ,Ndërkombëtare dhe Institucioneve të tjera
- Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.
- Donacionet dhe iniciativat afariste të qytetarëve të komunës.



Tab. 30: Projektet në Arsim

Ndërtimi i objekteve të shkollave filllore : -Qytet : Zabeli i Sahit Ages, Qarku, Tregu I gjelbërt
Meremetimi i objekteve ekzistuese
Ndërtimi i objektit të shkollës së mesme të muzikës

Tab. 31: Projektet në Shëndetësi

1	Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e medikamenteve farmaceutike,
2	Ndërtimi i qendrës për rehabilitim të familjes dhe fëmijëve
3	Ndërtimi i objektit për të Hendikepuar

Tab. 32: Projektet në Ujësjetës dhe Mjedis

1	Sistemi regjional i ujësjetës " LEPENC " Rregullimi i sistemit regjional të ujësjetës për Luginën e Moravës dhe pjesa e Kosovës
2	Rregullimi i rrjetit të kanalizimit për gjatë lumit Dobrusha dhe Stanishorka dhe rregullimi i shtratit të lumejve
3	Rregullimi i kolektorit të qytetit për neutralizimin e ujërave të zeza
4	Ndërtimi i pendës " Llapushnica " Ndërtimi i pendës në lumin " Llapushnica " me qëllim të furnizimit të komunës me ujë të pijshëm
5	Pyllëzimin dhe gjelbërimin i sipërfaqeve të reja
6	Organizimi i aksioneve me qytetarë për rregullimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit,

Tab. 33: Projektet në Energjetikë, Telefoni dhe Komunikacion Rrugorë

1	Shtimi i rrjetit të lartëpërquesve dhe modernizimi i rrjetit
2	Rregullimi i rrethërrotullimeve
3	Ndërtimi i rezervarit të ujit të pijshëm për nevojat e qytetit
4	Ndërtimi i rrjetit për ndriçim publik në qytet
5	Ndërtimi i rrjetit të telefonisë fikse në tërë territorin e Komunës së Gjilanit
6	Asfaltimi dhe sanimi i rrugëve në lagjet e qytetit

Tab. 34: Projektet në Kulturë, Rini dhe Sport

1	Përfundimi i punëve „ Fusha e Lirisë „ të qendrës rekreative sportive mbi Hallen e Sporteve
2	Themelimi i Muzeut Regjional dhe Ndërtimi i objektit të ri të Arkivit regjional
3	Mbrojtja dhe përkujdesja e objekteve të kultit fetar dhe monumenteve historike,
4	Ndërtimi i objektit të Bibliotekës Regjionale " F, Noli „ Gjilan



Tab. 35: Projektet në Urbanizëm dhe Gjeodezi

1	Përfundimi i punëve në ndërtimin e kazermes “Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha “
2	Ndërtimi i salles së Kuvendit dhe pajisja me inventar
3	Planifikimi dhe ekspropriimi i tokës me interes të përgjithshëm
4	Renovimi komplet i objektit të Gjeodezis
5	Rrjeti referent i rendit të tretë dhe inçizimi i rrugës qarkore / 7 km
6	Rregullimi i kulmeve të objekteve kolektive dhe të ashensorëve

Tab. 36: Projektet në Ekonomi, Bujqësi dhe Pylltar

1	Hartimi i Rregullores për thjeshtësimin/përgjysmimin e procedurave administrative biznesore
2	Promovimi i zhvillimit të ndërmarrjeve me pronësi private,
3	Inkurajimi i investimeve kapitale të mërgatës shqiptare dhe investorëve të huaj
4	Themelimi i zyrës për shërbime të shpejta biznesore (OSS or One-Stop-Shop)

Tab. 37: Projektet e Bashkëpunimit ndërkufitarë dhe ndërajonal

1	Organizimi i një panairit të përbashkët ndërkufitar / NVM
2	Organizimi i një konference të donatorëve për financimin e projekteve ndërkufitare
3	Bashkëpunimi me të gjitha organizatat dhe institucionet që e mbështesin projektet ndërkufitare
4	Sanimi i gjendjes së rrugës Gjilan – Presheve
5	Realizimi i projektit të rrugës Gjilan-Ponesh-Kishnapolë-Lypjan
6	Realizimi i projektit të rrugës Zhegër-Goden-Stubëll-Viti



### 1.3 VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTUESE

Kapacitetet investuese janë potencial i financimit të projekteve ekonomike etj. e që ndikojnë në vlerësimet brenda projekteve zhvillimore. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe investimet për projekte kapitale publike dhe private.

Në rrethanat aktuale në Kosovë, duke pas parasysh mundësitë e kufizuara financiare, sidomos vlerësimi i kapaciteteve investuese publike (sektorët dhe burimet), ka rëndësi të veçantë.

Kuvendi Komunal Gjilan 12/2006

#### INVESTIMET 2008-2017

Kapacitetet ndahen në ato ekzistuese dhe të mundshme.

1. Kapacitetet ekzistuese përfshijnë:

- Buxhetin Komunal,
- Sektorin privat,
- Sektorin publik,
- Burimet natyrore,
- Kapacitetet e infrastrukturës fizike (ndërtesat ),
- Potenciali njerëzor (rinia)

2. Ndërsa kapacitet e mundshme përfshijnë:

- investimet e mundshme të Qeverisë.
- Investimet nga jashtë,
- fondet ndërkombëtare,
- Pakti i Stabilitetit,
- BE dhe donacionet tjera Gjilan 09/2007
- kreditë dhe grantet.

#### Buxheti komunal

Në situatën aktuale vetëm buxheti komunal është i mundshëm të vlerësohet, ndërsa sektorin privat, publik apo donacionet mund të vlerësohen duke u bazuar në përqindjen e pjesëmarrjes së tyre mesatare në Kosovë (25%, 75%, 5%).

Komuna për vitin 2008 ka aprovuar buxhetin prej 10.842,000 €. Dhënia (grandi) qeveritar merr pjesë me 7.790,000 €, ndërsa të hyrat vetjake janë të vlerësuara prej 3,052,000 €.

Komuna ka aprovuar stafin maksimal prej 2488 punëtorëve, për të gjitha programet.



Komuna mbledh dhe merr të hyrat vetanake nga kontributet dhe taksat komunale, duke përfshi gjobat në trafik, tarifat administrative, licencat, tatimin në prone, lejet e ndërtimit. Normat e mbledhjes kanë qenë të ulëta deri tash. Ka pasur vetëm rritje të kufizuar në të hyrat vetanake krahasuar me llojet tjera të hyrave, kështu që komuna është shumë e varur nga dhëniet (grandet) e qeverisë qendrore. Punë substanciale është bërë për zbatimin e një sistemi të tatimit në pronë në komunë dhe kjo ka ofruar fushëveprimin më të madh të rritjes të hyrave vetanake komunale. Komuna në mënyrë aktive ka kërkuar mënyra për të zgjeruar bazën e të hyrave vetanake dhe për të përmirësuar inkasimin e të hyrave buxhetore. Burimi kryesor i të hyrave vetanake të komunës është tatimi në prone.

Vitet	Të hyrat	Pagat/mallrat/shërb.	Invest.kapitale
2008	10,842,000	8,604,000	2,238,000
2009	11,322,000	9,002,000	2,320,000
2010	11,564,000	9,018,000	2,546,000
2011	11,738,000	9,420,000	2,318,000
2012	12,048,000	9,447,000	2,601,000
2013	12,556,000	9,869,000	2,687,000
2014	13,176,000	9,893,000	3,283,000
2015	13,642,000	10,351,000	3,291,000
2016	13,946,000	10,380,000	3,566,000
2017	14,206,000	10,860,000	3,346,000
	125,040,000	96,844,000	28,196,000

Taksat për infrastrukturë të përmirësuar:

Vitet	Koncesionet	Lejet O.kolekive	Legalizimi ON.	Gjithësej
2008	3,100,000	210,000	2,500,000	5,810,000
2009		235,000	3,400,000	3,635,000
2010	2,980,000	254,000	3,700,000	6,934,000
2011	3,120,000	225,000	3,900,000	7,245,000
2012		300,000	4,200,000	4,500,000
2013	2,450,000	245,000	4,500,000	7,195,000
2014	3,200,000	187,000	5,000,000	8,387,000
2015	2,400,000	234,000	5,100,000	7,734,000



2016		190,000	4,900,000	5,090,000
2017	3,050,000	275,000	3,500,000	6,825,000
	20,300,000	2,353,000	40,700,000	63,353,000

Kapacitetet e mundshme:

Vitet	B.Ministror	Kredit	Donacionet	Diaspora	Gjithsej euro
2008	950,000		700,000	650,000	2,300,000
2009	4,225,000	8,000,000	680,000	1,500,000	14,405,000
2010	1,810,000		650,000	2,000,000	4,460,000
2011	4,590,000		900,000	2,400,000	7,890,000
2012	2,380,000		890,000	1,800,000	5,070,000
2013	2,570,000		550,000	1,100,000	4,220,000
2014	900,000		780,000	950,000	2,630,000
2015	4,540,000		840,000	2,100,000	7,480,000
2016	820,000	7,000,000	790,000	3,400,000	12,010,000
2017	2,770,000		920,000	4,900,000	8,590,000
<b>Totali</b>	<b>25,555,000</b>	<b>15,000,000</b>	<b>7,700,000</b>	<b>20,800,000</b>	<b>69,055,000</b>

#### 1.4 SFIDAT ZHVILLIMORE

##### Zhvillimi i paplanifikuar dhe shkalla e lartë e papunësisë

- I tërë zhvillimi në Qytet është bërë pa planifikim institucional ,është bërë dyfishimi i kapaciteteve dhe nuk janë shfrytëzuar resurset lokale dhe potencialet për zhvillim të qëndrueshëm.
- Gjate planifikimit duhet të përcaktohen mënyrat për institucionalizim (vënia nën kontroll) e këtij zhvillimi, dhe të planifikohet zhvillimi i ardhshëm duke u bazuar në potencialet lokale.

##### Shfrytëzimi joracional i hapësirës

- shumica e ndërtimeve janë bërë në tokë bujqësore (humbje e pa kthyeshme e tokës bujqësore) dhe përgjatë korridorit të rrugëve (pamundësi e zgjerimit të rrugëve ekzistuese)





- si mund t'i ndalojmë këto ndërtime dhe si të veprojmë me ato ekzistuese ?

### **Mjedisi**

- mjedisi jetësor ne zonën urbane dhe atë rurale është i kualitetit te dobët (shërbime jo te mjaftueshme ne mbledhjen e mbeturinave dhe mos trajtim i ujërave te zeza).
- gjate planifikimit duhet te përcaktohen mënyrat se si ti përparojmë këto shërbime që ta rrisim kualitetin e mjedisit jetësor.

### **Infrastruktura e dobët teknike**

- Infrastruktura teknike në përgjithësi në zonën urbane është e dobët si në aspektin kualitativ po ashtu edhe në atë kuantitativ.
- Si mundemi ti përshtatim korridoret ekzistuese zhvillimeve aktuale dhe ti planifikojmë korridoret e reja në harmoni me nevojat për zhvillimin të ardhshëm.

### **Trashëgimia natyrore**

- Trashëgimia natyrore është në shkatërrim e sipër,
- Gjatë planifikimit duhet te ketë parasysh shfrytëzimin e këtyre vlerave dhe mbrojtjen e tyre për brezat e ardhshëm.

### **Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore dhe sociale**

- Shërbimet shëndetësore dhe sociale në përgjithësi janë jo të kënaqshme në zonën urbane.
- Si mundemi që këto shërbime ti përmirësojmë që të jenë më afër banorëve.

### **Standardet, Normat dhe Parimet**

- Pjesa dërmuese e zhvillimeve janë bërë jashtë standardeve , normave dhe parimeve të aplikueshme të cilat janë obliguese edhe për ne.
- Si të planifikojmë zhvillimin për të ardhmen në mënyre që të arrihen standardet ndërkombëtare , transparenca si dhe pjesëmarrja në vendimmarrje.



## 2 VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

### 2.1 VIZIONI PËR TE ARDHMEN E ZONËS URBANE

Plani Zhvillimor Urban i Gjilanit është duke e përgatitur të ardhmen e komunës për vitet e ardhshme. Për këtë periudhë kohore, vizionet, parimet dhe qëllimet në vijim do ta udhëzojnë zhvillimin e komunës.

#### Gjilani – Forca lëvizëse në Anamoravë

Bazuar në burimet e tij të mineraleve, traditës industriale, dhe njohurive të teknologjisë të afërta me të, Gjilani do të funksionoj si qendër e madhe në rajonin e Anamoravës. Një politikë adekuate për tokën, dhe pajisjet e bashkëkohore të rrjetit të komunikacioni, do ti ndihmojnë Gjilanit që ta realizoj potencialin e rritjes ekonomike. Një bazë tjetër vitale për ekonomin e ardhshme të Gjilanit do të zhvillohet nga tregtia. Për ta arritur këtë qëllim, Gjilani duhet të shfrytëzoj sa më shumë afërsinë me Serbinë dhe Maqedonin, dhe lidhjet e tij të mira tradicionale me qytet e Bujanovcit, dhe Preshevës (në Serbi) dhe Kumanovë (në Maqedoni).

#### Gjilani – Kualiteti i jetës së banorëve dhe vizitorëve

Përmirësimi i zonave ekzistuese të banimit dhe zhvillimi i zonave të reja të tij, si dhe përmirësimi i pajisjeve të infrastrukturës teknike dhe sociale do ta zhvilloj Gjilanin si qytet atraktivë dhe të banueshëm.

Kualiteti i jetës në qytet gjithashtu është i influencuar nga vlerat rekreative të trashëgimisë së tij natyrore. Për sa i përket brendisë skenike të qytetit të Gjilanit dhe jetës kulturore, komuna mund të jetë si qendër rajonale për kohë të lirë dhe rekreacion.

#### Deklarata e Vizionit

**Gjilani qendër rajonale e urbanizuar dhe universitare në trekëndëshin e dyfishtë, i integruar dhe faktor në bashkëpunim ndërkombëtar me zhvillim modern, mjedis të qëndrueshëm, shërbime e infrastrukturë cilësore dhe identitet të fuqizuar.**



## 2.2 PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM

Vizioni i komunës së Gjilanit i vendos prioritetet e mësipërme përreth parimeve dhe qëllimeve të zhvillimit në vijim:

- Pajisjet e një infrastrukture adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve,
- Promovimin e ekonomisë së qëndrueshme të komunës, duke siguruar punë të mjaftueshme për banorët e qytetit.
- Promovimi i kohezionit territorial përmes zhvillimit socio-ekonomik më të balancuar të rajonit dhe përmirësimit të konkurrencës,
- Inkurajimi i zhvillimit të gjeneruar nga funksionet urbane dhe përmirësimi i raportit në mes të qytetit dhe fshatit,
- Ngritjen e kushteve të shëndetshme, banueshme dhe atraktive në zonat urbane,
- Furnizimin e mjedisit urban dhe fshatar të mjaftueshëm, duke kontribuar në përmirësimin e kualitet të jetës,
- Mundësimi i qasjes në informata dhe njohuri,
- Zvogëlimi i dëmeve mjedisore,
- Përparimi dhe mbrojtja e resurseve natyrore dhe të trashëgimisë natyrore,
- Promovimin e infrastrukturës për rekreacion dhe turizëm,
- Zhvillimin e sistemit të përshtatshëm të trafikut të/transportit të lëvizshëm / (duke siguruar qasje të mirë urbane)

## 2.3 CAQET ZHVILLIMORE AFATGJATE

Qëllimi i analizës situacionale nuk është vetëm gjetja e problemeve për ti përmirësuar ato, për më shumë gjetja e forcës investuese të komunës. Komuna ka burime të limituar në dispozicion. Megjithatë, është e rëndësishme që këto burime të përqendrohen në sektorët të cilët po e bëjnë Gjilanin të dallueshëm nga pjesët tjera të Kosovës, dhe të cilat kanë potencial që ta zhvillojnë komunën më tutje.

### - Gjilani, Kryeqytet Rajonal

Të gjitha rrugët në fushën e Anamoravës të fusin në Gjilan. Aty është i përqendruar shërbimi publik, administrata qendrore, dhe institucionet, por gjithashtu edhe shërbimet private, shitoret dhe vendet argëtuese. Centralizimi jo vetëm që ka dobi për qytetin e Gjilanit, por gjithashtu edhe për vendet tjera në rajon. Strategjia për Zhvillim Hapësinor të Kosovës ka për qëllim shpërndarjen në baza të barabarta të shërbimeve publike dhe zhvillimit ekonomik si dhe përforcimin e qendrave urbane



jashtë Prishtinës. Në frymën e decentralizimit, funksionet e ndryshme qendrore mund të zhvendosen nga kryeqyteti. Investimet private gjithashtu mund të kërkojnë vende tjera sesa zonat e grumbulluar të mbivlerësuara të Prishtinës. Duke qenë qendra e vetme e madhe në rajon, ka mundësi që ti tërheq funksionet e tilla të rëndësishme qendrore. Kjo mund të sjell punësim dhe pasuri për tërë rajonin.

Duhet të bëhen përpjekje për ti tërhequr investimet publike dhe ato private në Gjilan. Për ta përforcuar rajonin në konkurrencë brenda Kosovës. Funksionet qendrore duhet të lidhen me qytetin e Gjilanit.

#### - Gjilani, një Qendër Kulturore

Kultura luan një rol të rëndësishëm në Gjilan. Me teatrin dhe kinemanë në qytet, dhe shtëpi të ndryshme kulturore në komunë, popullit i ofrohet kulturë dhe argëtim. Trashëgimia kulturore në pjesët e ndryshme të komunës, shpeshherë është e braktisura, por mund të luaj rol të rëndësishëm për jetën kulturore në Gjilan.

Gjilani, si edhe shumë rajone tjera kufitare, ka një traditë të tolerancës dhe bashkëpunimit. Prezenca e grupeve të ndryshme të veçanta etnike në komunë, ka potencial për ta pasuruar jetën kulturore në përgjithësi.

Ekzistojnë shumë shkolla të niveleve të ndryshme në Gjilan, prej çerdheve të fëmijëve deri te fakultetet, dhe popullata e re është e edukuar mirë. Të ardhurat shpeshherë rriten me nivelin e edukimit. Popullsia e edukuar mirë e paraqet potencialin për zbutjen e varfërisë në qytet.

Qyteti i Gjilanit në të ardhmen mund të jetë një qendër kulturore e një rajoni tolerant dhe kufijve të hapur, me jetën kulturore të pasur dhe histori të konservuar.

Investimet në edukim, institucionet për kulturë nga e tashmja dhe e kaluara, si dhe bashkëpunimi matanë kufijve mund ti sjellin Gjilanit dobi për të ardhmen.

#### - Gjilani, Qyteti Industrial

Gjilani ka traditë të gjatë në industri dhe ndërmarrje. Shumë dyqane të vogla dhe SME-të tjera janë duke krijuar vende të reja pune në komunë. Bashkëpunimi ndër-kufitar i jep qasje qytetit të Gjilanit për tregti të jashtme. Popullsia e re, relativisht e edukuar mirë, siguron parakushte për punësim të kuadrit ri të kualifikuar në ndërmarrje. Komuna ka shumë



resurse natyrale që mund të shfrytëzohen. Shumë nga industritë ekzistuese janë të vjetruara dhe nuk janë mirëmbajtur për kohë të gjatë. Me investime të rregullta disa nga zonat industriale dhe pajisjet mund të ri-kultivohen. Ato mund të përdorën qoftë për prodhime ose ndërmarrje tjera të biznesit.

Një industri prodhuese moderne, e pastër dhe efektive mund të luaj një rolë të rëndësishëm për ekonomin e qytetit në të ardhmen.

Për ti arritur këto objektiva, qyteti duhet të jetë i përgatitur për ti rivlerësuar pajisjet dhe strukturat ekzistuese, të siguroj zona komerciale të madhësisë së përshtatshme dhe në vende të duhura, të filloj të promovoj SME-në dhe të krijoj mjedis të favorshëm për ti tërhequr investitorët.

#### - Gjilani, Qyteti i qytetarëve

Qyteti i hapur tolerant dhe me madhësi mesatare, Gjilanit ka mundësi që të ju ofroj të gjithë qytetarëve të saj një vend atraktivë për të jetuar. Për këtë qëllim, më shumë se sa vetëm nevojat të jetës, është i nevojshëm punësimi dhe ngritja adekuate e infrastrukturës teknike. Që të jetë fshati më shumë se sa vetëm një vend për të jetuar, janë të nevojshme plotësimi i kushteve për banim të përshtatshëm, me mundësi qasje në infrastrukturën shoqërore si shkolla, shtëpi shëndeti dhe të ketë një mjedis të shëndetshëm.



Fig. 30: Potencialet zhvillimore të Gjilanit



Synimet dhe Caqet për zhvillim afatgjatë janë:

- Ridefinimi i identitetit të qytetit, mbrojtja dhe rivendosja e monumenteve historike simbole të së kaluarës dhe të ardhmes,
- Zgjidhja e problemit të mungesës së hapësirave dhe objekteve në fushat kryesore të infrastrukturës publike dhe sociale,
- Përmirësimi i kualitetit dhe kushteve të jetesës në qytet për grupet e ndryshme të qytetarëve,
- Shfrytëzimi racional i tokës me qëllim të vendosjes së një organizimi të qëndrueshëm,
- Përmirësimi i kushteve mjedisore dhe një trajtim më i mirë i resurseve,
- Krijimi i Gjiilanit si një ndërlidhje dhe integrimi i tij një rrjetet ndërkombëtare të transportit,
- Implementimi i mobilitetit / lëvizshmërisë urbane të sigurt dhe atraktiv për të gjithë qytetarët .

## 2.4 PRIORITETET STRATEGJIKE

### PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I VENDBANIMEVE

#### Fushëveprimet

- Menaxhimi i shfrytëzimit të tokës ndërtimore,
- Trajtimi i vendbanimeve joformale,
- Bashkëpunimi ndërkufitar,
- Ndërtimi sipas standardeve në hapësirat jo të ndërtuara dhe masat mbrojtëse për reduktimin e pasojave nga tërmetet, erozionit etj.
- Partneriteti Publiko Privat ( PPP)
- Vënia në zbatim e rregullave të ndërtimit për banim në dobi të rritjes së dendësisë për sipërfaqe në zonat e banimit.
- Mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike .

#### Prioritetet Strategjike

- Hartimi i Planeve rregulluese,
- Revidimi i planeve ekzistuese,
- Trajtimi i vendbanimeve joformale,
- Trajtimi i hapësirave publike.



- Trajtimi i shtretërve të lumenjëve.

## DEMOGRAFIA DHE ÇËSHTJET SOCIALE

### Fushëveprimet

- Fushëlojrat dhe kopshtet për fëmijë
- Objekte dhe hapësira shkollore të reja për ciklin e ulët .
- Edukimi i avansuar (Shkollat e mesme : për bujqësi, mjekësi dhe fushat tjera).
- Zgjerimi i edukimit të lartë universitar.
- Qendër aktiviteteve për grupmosha të ndryshme.
- Qendra për asistencë, shërbime shëndetësore, sociale dhe strehim.
- Qendra të kulturës, (Teatër, Bibliotekë, Arkiv, Muze).

### Prioritetet Strategjike

- Krijimi i infrastrukturës për edukim të ulët dhe të mesëm.
- Sigurimi i lokacionit për edukim të lartë.
- Krijimi i infrastrukturës për objektet kulturore dhe sportive.
- Krijimi i infrastrukturës shëndetësore.

## SHFRYTËZIMI I TOKËS DHE MJEDISI

### Fushëveprimet

- Sigurim , mbrojtje, rigjenerim dhe shfrytëzim i tokës ndërtimore.
- Sistem i menaxhimit të tokës ndërtimore dhe fondi për këmbim të tokës ndërtimore
- Reduktim i ndotjeve dhe pastrim të lumenjëve
- Mbrojtje e zonave ujore
- Parandalim i vërshimeve
- Mbrojtje e hapësirave dhe objekteve me vlera natyrore
- Përmirësim dhe zgjerim i hapësirave të gjelbëruara publike.
- Ndërtimi dhe përmirësimi i fushëlojave dhe terreneve të vogla sportive





- Ndërtimi dhe përmirësimi i kualitetit të mjedisit të hapësirave të varrezave.

### Prioritetet Strategjike

- Realizimi i projektit të lumit Mirusha dhe trajtimi i lumenjëve tjerë
- Mbrojtja e strukturave dhe hapësirave gjelbëruese
- Trajtimi i mbeturinave
- Trajtimi i vendbanimeve joformale
- Trajtimi i zonave të banimit dhe infrastrukturës përcjellëse sipas normave dhe standardeve.
- Aplikimi i kriterëve sizmike.
- Krijim dhe përmirësim të kualitetit të hapësirave publike . (varrezat, stacioni i autobusëve, vendparkingjet, hapësirat e gjelbëruara, rehabilitimi i hapësirave tregtare )

### ZHVILLIMI EKONOMIK

#### Fushëveprimet

- Hapësira të reja industriale të paisura me infrastrukturë .
- Ndërtim të tregjeve
- Avancimi i inkubatorit të Biznesit.
- Qendra tregtare dhe zejtare.
- Akset rrugore dhe zonat për zhvillim ekonomik

### Prioritetet Strategjike

- Zonat e reja Industriale
- Funkcionalizimi dhe rihvillimi i hapësirave ekonomike aktive, gjysmë aktive dhe pasive .
- Zhvillimi i zonave rekreative—sportive.



## INFRASTRUKTURA TEKNIKE DHE RRUGORE

### Fushëveprimet

- Burimet dhe furnizimi me ujë
- Sistemi i kanalizimit
- Rregullimi i shtretërve të lumenjëve
- Mbledhja dhe trajtimi i mbeturinave
- Rrjeti energjetik
- Rrjeti i Telekomunikimit
- Ndriçimi publik
- Shfrytëzimi i burimeve të reja energjetike dhe energji efektive për sistemet e ngrohjes
- Rregullim adekuat i komunikacionit urban, vendparkimeve dhe masave mbrojtëse
- Transport publik (rrugor dhe hekurudhor)
- Trajtimi i lidhjeve ndër-regionale brenda zonës Urbane
- Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugëve dhe përmbajtjeve përcjellëse.
- Shtigje për këmbësorë, persona me aftësi të kufizuar dhe rrjeti për çiklistët.

### Prioritetet Strategjike

- Trajtimi qendror i ujit të pijshëm,
- Burimet dhe furnizimet me ujë
- Furnizimi me energji për ngrohje,
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike
- Përmirësim i rrjetit rrugor me infrastrukturë përcjellëse ,
- Trajtimi i rrugëve unazore me përmbajtje përcjellëse,
- Trajtimi i trasesë hekurudhore me përmbajtje përcjellëse,
- Mbështetje zhvillimit policentrik dhe lehtësim të qasjes nga pjesa urbane në drejtim të nën-qendrave,
- Siguri dhe rregullim të transportit urban.




Fig. 31: Harta e Vizionit nga punëtorja në Ohër



### 3 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR URBAN

#### Konceptet Hapësinore

Pikërisht sikur në Planin Zhvillimor komunal, udhëzimet e ndryshme bazike konceptuale, në lidhje me zhvillimin hapësinor të qytetit janë diskutuar para se të filloj puna me modelin zhvillimor hapësinor. Këto përqendrime janë paraqitur në tri plane hapësinore të veprimit, duke e treguar secila mundësi të ndryshme të zhvillimit.

#### 3.1 KONCEPTET KRYESORE TE ZHVILLIMIT HAPËSINORE

##### Skenari A “Zhvillimi linearë Ferizaj-Bujanovc”

- Një qarkore rrugore complete e liron qytetin prej transportit,
- Qarkorja krijon kufirin në mes qytetit dhe fshatrave: i gjithë zhvillimi ndodh brenda qarkores.
- Rruga e re gjysmë rrethore në lindje të qendrës është së bashku me rrugën perëndimore by-pass duke formuar qarkore të brendshme , duke liruar qendrën.
- Parqet e reja dhe ekzistuese janë kombinuar me korridoret e gjelbra, duke shkuar prej periferisë kah qendra.
- Korridoret e gjelbra ndërtojnë zhvillimin urban.
- Qyteti është i rrethuar me një brez gjelbërimi, përreth qarkores.
- Zhvillimi industrial është i vendosur në veri lindje të qytetit.
- Zonat industriale ekzistuese janë të lidhura me rrjetin rrugor më të lartë linja e qarkores së brendshme.
- Hekurudha e re është ndërtuar në pjesën lindore të qytetit, me stacionin e trenave afër qendrës



##### përparësitë

- Qarkoret e brendshme krijojnë lidhje të mira me qytetin,
- Asnjë trafik përmes qendrës së qytetit,
- Kufiri i pastër mes qytetit dhe fshatrave,
- Ndarja në mes zonave të banimit dhe industriale me gjelbërim,
- Trafiku prej zonave të industrisë drejtohet jashtë qytetit,
- Stacioni kryesor i trenave afër qendrës së qytetit,
- Gjelbërimi krijon lidhje direkt në mes parkut dhe periferisë.

**dobësitë**

- Qarkorja është e mundshme nëse gurorja largohet prej pjesës veriore të qytetit,
- Hekurudha kalon pjesërisht nëpër zonat kodrinore,
- Hekurudha është ndërtuar pjesërisht në tokë të dobët ndërtimore,
- Hekurudha mund të ndërtohet vetëm nëse mbyllet baza e KFOR-it kampi Monteith.

**konkluzion:**

- Ky skenar do të zhvillohet me kombinimin e skenarëve tjerë.

**Skenari B “Zhvillim i Koncentruar”**

- Qarkorja e jashtme me disa segmente të ndryshuara është ndërtuar përreth qytetit,
- Bashkë me qarkoret, disa lidhje të brendshme janë kombinuar në një qarkore të ndërruar,
- Parqet e reja dhe ekzistuese janë kombinuar me korridoret e gjelbra, duke shkuar prej periferisë kah qendra,
- Korridoret e gjelbra ndërtojnë zhvillimin urban,
- Zhvillimi industrial është i paraparë në veri të qytetit,
- Zonat industriale ekzistuese janë ri zhvilluar në zona të përziera edhe për banim,
- Hekurudha e re është ndërtuar në pjesën lindore të periferisë së qytetit, me stacionin e trenave në periferi,
- Qendra e qytetit zhvillohet në drejtim të stacionit të trenave.

**përparësitë**

- zhvendosja e qarkoreve e ndalojnë shpejtësinë,
- Lidhjet e brendshme krijojnë lidhje me qytetin,
- Ndarja në mes zonave të banimit dhe industriale,
- Asnjë zonë industriale brenda qytetit,
- Gjelbërimi krijon lidhje direkt në mes parkut dhe periferisë.

**dobësitë**

- Zhvendosja e qarkoreve e bën rrugën by-pas më të komplikuar dhe më pak atraktive për udhëtime të gjata,
- Zonat ekzistuese industriale duhet të mbyllen,



- Stacioni i trenave jashtë qendrës së qytetit.
- Hekurudha është ndërtuar pjesërisht në tokë të dobët ndërtimore.

**konkluzion:**

- Ky skenar do të zhvillohet me kombinimin e skenarëve tjerë.

**Skenari C “Zhvillimi përgjatë korridoreve”**

- Zhvillimi është i koncentruar në pjesën perëndimore të qytetit,
- Pjesa lindore është rezervuar për park,
- Një rrugë perëndimore by-pass iu ka shtuar rrugës ekzistuese, por ë një rreth më të gjerë,
- Parqet e reja dhe ekzistuese janë kombinuar me korridoret e gjelbra, duke shkuar prej periferisë kah qendra,
- Korridoret e gjelbra ndërtojnë zhvillimin urban,
- Zhvillimi industrial është i paraparë në veri të qytetit, lidhur me by – pas,
- Zonat industriale ekzistuese janë ri zhvilluar në zona të përziera edhe të banimit,
- Hekurudha e re është ndërtuar në pjesën perëndimore së qytetit me stacionin e trenave në rrugën për Prishtinë.

**përparësitë**

- Zonë e madhe rekreative në lindje,
- Shumica e udhëtimeve të gjata jashtë qytetit,
- Përdorimi efektiv i rrugëve by-pas ndërtohet në 2 anët,
- Ndarja në mes zonave të banimit dhe industriale,
- Asnjë zonë industriale brenda qytetit,
- Gjelbërimi krijon lidhje direkt në mes parkut dhe periferisë,
- Stacioni i trenave ka qasje të lehtë.


**dobësitë**

- Shumica e udhëtimeve të gjata kalojnë nëpër qytet,
- Zonat ekzistuese industriale duhet të mbyllen,
- Stacioni i trenave jashtë qendrës së qytetit.


**konkluzion:**

- Ky skenar do të zhvillohet me kombinimin e skenarëve tjerë.

Plani gjeneral urban 1980  
General Urban Plan 1980




Skenari A  
Scenario A



Skenari A "Rrugët unazore"

- Një qendër rurale complete e liron qytetin prej qendrës së vjetër.
- Qarkullimi krijon shtyllën me anë të qendrës së vjetër.
- Rrugët e reja gjyken rrethore në lidhje të qendrës së vjetër.
- Përveç formuarit qendror të brëndshëm dhe të jashtëm.
- Pazë e reja dhe elektrizuese janë kombinuar me kalim qendror.
- Korridorët e gjelbra ndërtojnë zhvillimin urban, përfshirë qendër, qendër me një nivel globalim, të vjetër, industrial dhe zhvilluar në veri lindje.
- Zona industriale elektrizuese janë të lidhura me "qendrën" dhe "qendrën" e re të vjetër dhe të re të vjetër, me stacionin e trenave afër qendrës së vjetër.


Skenari B  
Scenario B



Skenari B "Rrugët unazore të sponzuar"

- Qarkullimi i shtetës me ditë complete të ndërra është i ndërruar përmjet qendrës së vjetër.
- Përveç formuarit qendror të brëndshëm dhe të jashtëm.
- Pazë e reja dhe elektrizuese janë kombinuar me kalim qendror.
- Korridorët e gjelbra ndërtojnë zhvillimin urban, përfshirë qendër, qendër me një nivel globalim, të vjetër, industrial dhe zhvilluar në veri të qendrës.
- Zona industriale elektrizuese janë të lidhura me "qendrën" dhe "qendrën" e re të vjetër dhe të re të vjetër, me stacionin e trenave në qendër.

Skenari C  
Scenario C



Skenari C "Qyteti në përditësimin në lindje"

- Zhvillimi është i koncentruar në pjesën perëndimore të qytetit.
- Mesa lindore është rrethuar për pasqyrim të qendrës së vjetër.
- Rrugët e reja gjyken rrethore në lidhje të qendrës së vjetër.
- Korridorët e gjelbra, duke shikuar prap përveç qendrës së vjetër, industrial dhe zhvilluar në veri të qendrës.
- Zona industriale elektrizuese janë të lidhura me "qendrën" dhe "qendrën" e re të vjetër dhe të re të vjetër, me stacionin e trenave në qendër.

- qendra e qytetit  
city centre
- hapësira me shfrytëzim kryesisht të përzier, ekzistuese / në zgjerim  
mainly mixed use area, existing / extension
- hapësira me shfrytëzim kryesisht komercial dhe industrial, ekzistuese / në zgjerim  
mainly commercial and industrial area, existing / extension
- zonë rurale  
village zone
- park
- pyll  
forest
- rrijedhë  
stream
- unazë rrugore  
ring road
- udhëkryq lidhës  
cross link
- rrugë tjera kryesore  
other main street



### 3.2 STRUKTURA DHE LOKACIONI HAPËSINORE PER ZHVILLIMIN DHE ORGANIZIMIN E ARDHSHËM

Secili skenarë është analizuar veç e veç - në bazë të kriterëve siç janë: Popullsia, shtrirja hapësinore, largësia e lëvizjes, zhvillimi i infrastrukturës teknike dhe asaj sociale, kostoja e realizimit, ndikimi mjedisor, trendët e rritjes, ruajtja e tokës bujqësore etj, - për të ardhur kështu deri te zgjidhja e preferuar ose MODELI I ZHVILLIMIT HAPËSINORË I GJILANIT – ZHVILLIMI POLICENTRIK.

Modeli i zhvillimit hapësinor është i bazuar ne konkluzionet nga analizat situacionale, si dhe planin e veprimit hapësinor. Ai i tregon kualitetet bazë ne lidhje me zhvillimin hapësinor te qytetit. Pikat kryesore nga bazat e modelit te zhvillimit hapësinor janë si ne vijim:

#### **Një qendër e fortë e qytetit!**

Për ta ndihmuar identitetin urban te Gjilanit, është përforcuar qendra e qytetit. Te gjitha funksionet e rëndësishme janë te përqendruara aty. Dendësia dhe lartësia e ndërtesave është me e larte se ne zonat për rreth.

Pjesa qendrore e qytetit është parku i qytetit dhe sheshi qendror. Lumi i cili e kalon përmes sheshit është ri-natyrar dhe uji është përdorur për ta krijuar një gjendje atraktive urbane.

Për ti ofruar të gjitha pjesët e qytetit me shërbime dhe infrastrukturë shoqërore, dhe për ta liruuar presionin zhvillimor në qendër të qytetit, Dardania dhe Arbëria kanë funksione plotësuese qendrore.

#### **Zhvillimi dhe dendësia e tokës së kaftë!**

Toka e mirë bujqësore është një nga patundshmëritë më të rëndësishme të Kosovës. Shumica e tokës në Gjilan është e kualitetit të lartë, dhe mund të përdoret vetëm në raste të veçanta.

Prioriteti i parë për zhvillim urban duhet të jepet për zonat e liruara nga ushtria, zonat e përdorura industriale, dhe tokat tjera të kafta. Shumica e pjesëve të qytetit janë ndërtuar në mënyrë të shpërndarë. Dendësia e këtyre zonave gjithashtu do të mundësoj ndërtimin duke ruajtur tokën bujqësore me vlerë .





### Gishtërinjtë e gjelbër drejt qendrës!

Të gjitha hapësirat e lira publike në qytet janë kombinuar në koridore të gjelbra, duke arritur nga periferitë në qendër të qytetit. Korridoret kanë ose male ose peizazhe të hapura si pika fillestare, përderisa pika përfundimtare në qendër të qytetit është parku i qytetit.

Dy lumenjtë që kalojnë përgjatë Gjilanit janë rinatyruar dhe integruar në rrjetin e gjelbër. Tokat e lagështa në lindje të qytetit, ku dy lumenjtë lidhën, është zhvilluar në zonë rekreative.

### Trafiku brendshëm – jashtë qytetit!

Gjilani është i vendosur në udhëkryqin ndërmjet rrugëve kryesore, M25-2 ndërmjet Prishtinës dhe Preshevës dhe M25-3 ndërmjet Ferizajt dhe Bujanovcit. Vendosja e trafikut të favorshëm i ka edhe anët e saja negative sepse brendia qytetit është e stërngarkuar me trafik. Unaza e brendshme e qytetit e sidomos ajo e jashtme e tij do ta lirojnë qytetin dhe qendrën nga ky trafik.


Disa nga rrugët kryesore drejtohen nga rruga unazore për në qytet. Rruga anësore dhe një numër i lidhjeve tërthore, po e mbajnë trafikun jashtë nga qendra e qytetit.

### Linja hekurudhore për Gjilanin !

Një linjë e re hekurudhore përgjatë komunës , është propozuar në Planin Zhvillimor Urban. Ajo e kalon anën lindore të qytetit dhe bazës ushtarake të ri-zhvilluar. Ajo kalon gjatë zonës industriale nëpër M25-3. në këtë mënyrë janë të mundshme lidhjet e drejtpërdrejta nga zonat industriale në hekurudhë.

Stacioni qendrorë duhet të vendoset sa më afër qendrës së qytetit që është e mundur, duke e zhvendosur stacionin e autobusëve. Një qendër e re transite për autobusë dhe trena është krijuar afër rrugës anësore të qendrës së qytetit.

# Skenari D Skenari D



- Eshë përfunduar qendra e qytetit duke e theksuar edhe identitetin urban të qytetit.

- Pjesa qendrore e qytetit është shënuar në bashim qendror dhe parkun e qytetit.

- Lumi është hapur dhe rinaturuar dhe kështu është formuar një gjendje më e mirë ekologjike.

- Par të shikuar qendrën e qytetit, lagjet Dardania dhe Arbëria pranojnë funksione të infrastrukturës qendrore.

- Rruga uszore përreth qytetit e shikon trafikun tranzit përmes qytetit duke lehtësuar aksesin në qendër dhe në pjesë të tjera të qytetit.

- Unaza qendrore e shikuar qendrën e qytetit duke mundësuar kështu lëvizjen më të shpejtë të automjeteve.

- Parkingu janë të koncentruara përreth unazës qendrore - jashtë qendrës së qytetit.

- Hekurdhoret kalon në lindje të qytetit, përkrah rrugës uszore duke formuar kështu kushte ideale për Qendrën e Mobilitetit.

- Qendra e mobilitetit është vendosur në verifinoje të kampionit Monthit.

- Linja hekurudhore e furnizon edhe zonën tregëtare-industriale dhe së bashku me rrugën uszore formojnë një sistem të përbashkët për transportin e pasazheve dhe mallit.

- Të gjitha hapësirat e hapura publike në qytet janë kombnuar në koridore të gjelbra, duke aritur nga periferia e qendrës së qytetit. Koridoret kanë ose male ose pjesë të hapura si pika filluese, përdoren pika përfundimtare të hapura publike.

- Dy lumenjtë që kaljnë përgjatë Gjiçanit janë rinaturuar dhe integruar në mënyrë më të mirë me zonën rrethuese.

- Dy lumenjtë të qytetit, ku dy lumenjtë lëshen, është zhvilluar në zonë rekreative.

	qendra e qytetit (ekzistuese)		pyll
	qendra e qytetit (e planifikuar)		rrjedhë
	hapësira me shfrytëzim kryesisht të përzier (ekzistuese)		Unazë rrugore
	hapësira me shfrytëzim kryesisht përzier (e planifikuar)		rrugë përreth qendrës
	residential/mixed use area (planned)		rrugë tjera kryesore
	hapësira me shfrytëzim kryesisht komercial dhe industrial (ekzistuese)		hekurdhura
	hapësira me shfrytëzim kryesisht komercial dhe industrial (e planifikuar)		stacioni kryesor i autobusëve / stacioni kryesor i trenave
	mainly commercial and industrial area (planned)		central bypass station / railway station
	hapësirë e rrizhviluar		Zona e mbrojtur-rezerva të ujit të pijshëm
	zonë rurale		varreza muslimane/krishtere
	park me aktivitetë për kohën e lirë		
	parku qendror i Gjiçanit		
	sheshi qendror		
	fushë e krijuar nga vërshimi		
	lidhja e gjelbër		
	green connection		
	vend vështrimi		
	view point		
	pyll		
	rrjedhë		
	Unazë rrugore		
	rrugë përreth qendrës		
	rrugë tjera kryesore		
	hekurdhura		
	stacioni kryesor i autobusëve / stacioni kryesor i trenave		
	central bypass station / railway station		
	Zona e mbrojtur-rezerva të ujit të pijshëm		
	varreza muslimane/krishtere		

**Kuvendi Komunal Gjiçan**  
Municipal Assembly Gjiçan

**Plani zhvillimor urban i Gjiçanit**  
Urban development plan and of Gjiçan

**Skenari D-Modeli i zhvillimit hapësinorë**  
Scenario D-Spatial Development Model

14.04.2008

Plan 6  
Plan 6

Përpjesa:  
Scale:  
0 100m 500 1 km

DREITORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

**TECH**  
TECHNOLOGICAL CENTER FOR URBAN PLANNING AND DESIGN

**WU**  
WIRTSCHAFTS UNIVERSITÄT WIEN  
VIENNA UNIVERSITY OF ECONOMICS AND BUSINESS

**planungsgruppe 4**



### 3.2.1 Zhvillimi ekonomikë, regjenerimi, rekreacioni, tregtia


#### Industria jashtë qytetit!

Shpërndarë e industrisë në brendinë e qytetit, përballet me probleme të hapësirës. Veç kësaj, rregullimet moderne në lidhje me kontrollimin e ndotjes dhe zvogëlimin e zhurmës e benë lokacionin ndërmjet zonave banuese jo-atraktive. Për zonat banuese, industria në zonat e afërta do të thotë trafik i rënduar, ndotje e ambientit dhe shqetësime tjera.

Zonat industriale të vendosura në qendër dhe vende të zbrazëta, janë propozuara që të rivendosen në periferi të qytetit. Lokacionet e propozuar në verilindje afër rrugës unazore, ofrojnë mundësi për hapësirë të mirë dhe lidhje të shkëlqyeshme të trafikut.

Zonat e majta në brendinë e qendrës duhet të zhvillohen në zona urbane banuese dhe përdorim të përzier duke e kursyer tokën bujqësore për qëllime të ndërtimit.

# Zhvillimi Ekonomik i Gjilanit













Decent housing,  
Kushte të mira banimi  
**Jetë atraktive**  
Attractive Living  
Urban and Rural Living  
Jetesa urbane dhe rurale  
Social infrastructure  
Infrastruktura sociale

Entrepreneurial tradition  
Tradita ndërmarrëse  
Mines  
Minierat  
Research  
Hulumtime  
**Qytet industrial**  
Industrial Town  
Industrial production  
Prodhimtaria industriale  
Cross-border trade  
Tregtia ndërkufitare  
Employment  
Punë

Central institutions  
Institucionet qendrore  
Administration  
Administrata  
**Qendër rajonale**  
Regional Capital  
Service  
Shërbime  
Shopping  
Blerje

Education  
Asim  
Theatre  
Teatër  
**Qendër kulturore**  
Universitare  
Cinema  
Kinema  
Ethnic tolerance  
Culture houses  
Shtëpi kulturore

-  Qendra multifunktionale
-  Zona Industriale / Tregëtare
-  Zona e zhvillimit multifunksional
-  Zona për ripyllëzim
-  Rruga Uhozore
-  Zhvillimi i zones qendrore
-  Zhvill. I Ri indust./Tregëtarë
-  Fermat e shpezeve
-  Fabrikat jasht prodhimit


 **Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan


**Plani zhvillimor urban i Gjilanit**  
Urban development plan and of Gjilan


**Potencialet e zhvillimit ekonomik**  
Development Potentials


14.04.2008

Plani 7  
Plan 7

 **DREITORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT**  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

 **IFECH**  
INSTITUTE FOR URBAN AND ENVIRONMENTAL RESEARCH

 **IWU**  
INSTITUTE FOR URBAN AND ENVIRONMENTAL RESEARCH

 **planungsgruppe 4**



## Peizazhi dhe Mjedisi

Struktura e gjelbër e qytetit të Gjiçanit i favorizon kërkesat e banorëve për rekreacion. Zonat e hapura të lidhura me njëra tjetrën janë gjithashtu të rëndësishme për klimën lokale dhe florën e faunën. Shumica e parqeve, fushat e sportit, varrezat dhe hapësirat tjera të hapura në qytet janë të lidhura me njëra tjetrën, dhe e formojnë një rrejt të gjelbër.


Korridoret e gjelbra të drejtojnë nga peizazhi i hapur për në qendër të qytetit. Dy lumenjtë që kalojnë përgjatë qytetit janë qendra të dy korridoreve, të tjerat përbëhen nga parqet dhe fushat e sportit. Pika e fillimit të këtyre korridoreve është për më tepër një liqe, një pyll ose një peizazh i hapur bujqësorë. Pika përfundimtare për të gjitha është aksi i gjelbër i qendrës. Ky aks përbëhet nga parku i qytetit dhe sheshi në qendër të tij. Ai ka një dizajn të qëlluar dhe përfshinë pajisje të ndryshme për rekreacion për gjithë qytetin. Parqet tjera në qytet janë parqe fqinje. Ato ofrojnë rekreacion për zonat banuese përreth. Përqindja e gjelbërimit duhet të rritet edhe përmes rikonfigurimit të lagjeve gjatë hartimit të Planeve Rregulluese. Duhet të mbillet drunjë dekorativ edhe përgjatë rrugëve të qytetit.

Dy lumenj kalojnë përmes Gjiçanit, Mirusha dhe Stanishorka. Një pjesë e lumit Mirusha kalon përmes qendrës së qytetit. Kjo qendër duhet të përcaktohet me kujdes, për ta krijuar një gjendje atraktive urbane. Një zonë e plotë përgjatë shtratit të lumit duhet të lihet e lirë nga ndërtime rreth pjesëve tjera të lumenjve, dhe ta bëjnë një planifikim të orientuar të natyrës. Zonat e ruajtura gjatë dy lumenjve duhet të mbrohen.

Dy lumenjtë bashkohen në lindje të qytetit. Përrenjtë tjerë të vegjël i bashkojnë lumenjtë në këtë zonë. Është propozuar një liqe i ri për ta formuar një "Liqe park" të ri. Restorantet, një vaskë e hapur ajrore dhe pajisje tjera sportive janë paraparë në park.

Pyjet e rrethojnë qytetin në tri anë. Pyjet e formojnë pikën fillestare për disa korridore të gjelbërua. Pyjet janë të rëndësishme për rekreacion, për cilësinë e ajrit dhe për florën dhe faunën lokale.

■ ■ ■ ■ ■	<b>Kufiri i zonës urbane</b> Urban zone boundary
□	<b>hapsirat e ndërtuara</b> built-up areas
■	<b>qendra e qytetit</b> city-centre
■	<b>hapsirat e gjelbra publike</b> public green areas
⊕	<b>fushë sporti / sallë sportive</b> sportsfield / sports hall
⊕	<b>varreza (muslimane/ortodokse)</b> cemetery (Islamic / orthodox)
■	<b>lum me hapsirat mbrojtëse</b> river with retention areas
■	<b>pyll</b> forest
⊗	<b>vend vështrimi / restoran</b> viewpoint / restaurant
● ● ● ● ●	<b>shëtitore</b> avenue
■	<b>shesh publik</b> public square
⊕	<b>parku i qytetit / parqet përreth</b> city park / neighbourhood parks
⊕	<b>bazeni i hapur</b> open air bath
⊕	<b>Rrjeti i gjelbër i Gjilanit</b> Gjilan Green Network



**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor urban i Gjilanit**  
Urban development plan and of Gjilan

**Planifikimi i pejsazhit Qyteti Gjilan**  
Landscape Plan Gjilan Town

14.04.2008

Plan 8  
Plan 8

Përpjesa:  
Scale:  
0 100m 500 1 km

DREITORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

TECH  
INSTITUT FÜR URBANISME UND LÄNDEBAU

PLANUNGSGRUPPE 4





### 3.2.2 Infrastruktura – komunikimet

#### Rrjeti rrugor

Rrugët ekzistuese dhe të planifikuara të qendrës së qytetit janë lidhur në një rrugë unazore të brendshme. Të gjitha rrugët kryesore në pjesën e jashtme të qytetit janë të lidhura në një unazë të jashtme. Rruga e jashtme unazore gjithashtu e grumbullon dhe klasifikon trafikun lokal nga një drejtim i qytetit në tjetrin.

Rruga unazore nuk është një autostradë, por që ka më tepër karakterin e një rruge të plot të qytetit. Ajo kalon përgjatë zonës komerciale dhe industriale në verilindje, për të siguruar lidhje të mirë të trafikut në këtë pjesë të qytetit. Në veriperëndim dhe juglindje rruga unazore kalon në skaj të qytetit. Në veriperëndim Unaza kalon përskaq zonës Qarku për të cilën është bërë plani rregullues.

#### Rrjeti hekurudhor

Hekurudha është parapa që të kaloj përskaq pjesës lindore të qytetit, dhe përmes parkut për qendër të qytetit. Në pjesën veriore, ajo do të kaloj përmes zonës industriale dhe nëpër M25-3. Kjo e siguron mundësin e lidhjes së hekurudhës për ndërmarrjet industriale. Lidhja e hekurudhës dhe rrugës magjistrale gjithashtu po e minimizon burimin e zhurmës dhe shqetësimeve tjera. Hekurudha kalon rrjetin kryesor të rrugës në vende të ndryshme. Këto kalime të gjitha duhet të sigurohen me kalim në nivele të ndryshme qoftë me urë ose tunel.

#### Transporti publik dhe Mobiliteti

Për pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe ekonomike mund të thuhet se mobiliteti është kushti kryesor për të gjithë njerëzit.

Ky mobilitet duhet të planifikohet në atë mënyrë që të minimizojë ndikimet negative në ambient në njërën anë, ndërsa nga ana tjetër duhet ta rrisë qasshmërinë e qytetarëve në destinacione të dëshiruara duke ndikuar pozitivisht edhe në sigurinë në trafik dhe kualitetin e jetës.

Stacioni kryesor i trenit është planifikuar në skajin lindor të qytetit. Kjo mund ta bëjë stacionin që të arrihet lehtë nga qendra, shkolla, dhe qëllimet tjera të rëndësishme. Lokacioni afër rrugës anësore të qendrës së qytetit e bënë që ti qasen lehtë nga rrjeti i rrugëve.

Transporti publik në qytet dhe komunë është i bazuar në autobusë. Hapi i mëtejshëm nga autobusët lokal dhe urban në autobusë rajonal është i



mundshëm përmes stacionit qendror të autobusëve. Për ta lehtësuar hapin e mëtejshëm ndërmjet trenave dhe autobusëve, një lokacion i ri për stacionin qendror të autobusëve, është propozuar afër stacionit qendror të trenit. Kështu mbyllet qarku i një qendre të caktuar të Mobilitetit.

Drejtoria për shërbime Publike ka planifikuar një rrjet të ri të transportit publik urban i cili do ta shkarkonte trafikun tej mase dhe në këtë mënyrë do të ndikonte si në lëvizshmërinë e lirë të qytetarëve ashtu edhe në mbrojtje të ambientit. Drejtoria ka planifikuar 3 linja të prezantuara në figurën në vijim.




Fig. 32: Linjat e transportit Urban të propozuara në Gjilan

Veprimet e nevojshme për përmirësimin e mobilitetit:





- Rregullimi i Transportit Publik dhe masave të sigurisë në komunikacion,
- Linja të reja të transportit publik,
- Zgjerimi i rrugëve dhe krijimi i një trase për autobus lokal,
- Ndërtimi i stacioneve për ndalje të autobusëve lokal,
- Shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë
- Rregullimi i udhëkryqeve.

Prioritetet strategjike janë:

1. Përmirësimi i kualitetit fizik dhe zgjerimi i rrjetit rrugorë për një trakë për autobusë.
2. Ndërtimi i stacioneve për ndalje të sigurt të autobusëve lokal
3. Rritja e sigurisë në trafik (parkingjet, shtigjet për çiklistë dhe këmbësorë, shejzimi etj).

## Infrastruktura teknike

### Ujërat dhe Kanalizimi

Nevoja për ujë të pijes do të rritet në vitet e ardhshme. Duke e marrë parasysh këtë fakt, dhe se gjendja e rrjetit të furnizimit të ujit pjesërisht është e shkatërruar, është e qartë se është i nevojshëm përmirësimi i tyre. Për ta zvogëluar nevojën për ujë, duhet të promovohet shfrytëzimi sa më efikas i ujit.

Në muajin Prill të vitit 2006 kanë filluar hulumtimet gjeofizike të ujërave të pijshëm për komunën e Gjilanit dhe Ferizajt. Ky projekt është financuar nga Qeveria Zvicerane (7,5 milion euro) dhe implementimi i është besuar kompanisë EBP (Ernst Basler+Partner Ltd).

Hulumtimet ishin të drejtuara kryesisht në lokacionet dhe karakterizimet e sakta të vendeve të puseve, në hapësirat e identifikuara më parë në Studimin e Fizibilitetit të ZhRUKJ (Elektrowatt)

Hulumtimet gjeofizike me mjete bashkëkohore, në kuadër të projektit për zhvillimin e resurseve ujore në Kosovën Juglindore do të bëjnë identifikimin e ujërave nëntokësore që do të mund të shfrytëzoheshin për pije, në mënyrë që të shtohen kapacitetet e ujërave në komunat Gjilan dhe Ferizaj, ku tani ka mungesë të ndjeshme të ujit për pije.



Këto hulumtime përfunduan në Janar të vitit 2007, ndërsa raporti është bërë me 28 shkurt 2007. Në vazhdim po i shkëpusim konkluzionet dhe rekomandimet nga ky raport.

Sipas hulumtimeve të kryera, rekomandohet të ndërtohen 6 puse me specifikacionet në vijim:

Emri	X (UTM)	Y (UTM)	Diametri i Vrimës [mm]	Diametri i Gypit DN (Johnson Filter)	Thellësia e Parafatit [m]	$Q_{max}$ [l/s]	s [m]	R [m] O
Pusi 1	539547	4695740	700	450	40	14.5	5.75	133
Pusi 2	539514	4695672	700	450	40	14.5	5.9	137
Pusi 3	539119	4695574	700	450	38	17	5.4	151
Pusi 4	539257	4695510	700	450	38	10	5.0	140
Pusi 5	539411	4695168	700	450	30	11	4.0	123
Pusi 6	539478	4695353	700	450	33	9.5	5.1	121

Tab. 38: Puset e propozuara në Gjilan




Fig. 33: Puset e propozuara Gjiçan.

Pikat e kuqe tregojnë puset e propozuara 1-6. Pikat e zeza bold present një puset që janë aktualisht në përdorim nga fabrika RC Cola (RC) dhe Fabrika e Mishit.

Shkalla e propozuar e pompimit përfshin rreth 50% të shkallës maksimale të kalkuluar të tij, kështu që zvogëlohet ulja dhe minimizohet bashkëveprimi ndërmjet puseve të ndryshëm. Vendosija e dy puseve në anën e djathtë të Moravës ka edhe një përparësi më tepër, pasi që uji nëntokësor me mineralizim më të lartë nga ana e majtë e Moravës (që mund të përmbaj një sasi më të lartë të manganit dhe hekurit) do të përzihet. Figura në vijim tregon lokacionin e puseve të propozuara, piezometrave ekzistues dhe puseve që aktualisht janë në përdorim në këtë hapësirë.

Me interes të veçantë është pusi që përdoret nga Fabrika e Mishit, sipas bisedave gojore merret një sasi rreth 15 l/s (12-15 h/ditë; prej të Hënës deri të Premten ). Fabrika e mishit ndodhet në pjesën juglindore të hapësirës së puseve. Në Nëntor 2006 janë mbajtur bisedime me përfaqësuesit e Fabrikës së Mishit, AKM dhe Hidromoraves lidhur me mundësinë e kyçës të fabrikës në rrjetin e ujësjellësit të qytetit. Fabrika e mishit akoma e ka statusin e ndërmarrjes shoqërore dhe tani ndodhet në procesin e privatizimit. Përfaqësuesit e NSh nuk ishin në pozicion që të komentojnë një propozim të tillë. Bisedimet mund të rifillojnë vetëm



atëherë kur fabrika të privatizohet. Fabrika nuk ka akoma leje ujore për nxjerrjen e ujit nëntokësor.

Përafërsisht 600m në veri nga fusha e puseve, janë katër puse që përdoren nga fabrika RC Cola. Fabrika nuk ka leje ujore për asnjërin nga puset. Për arsye të rritjes së vazhdueshme të kërkesave për ujë, tani shumë vonë është ndërtuar edhe pusi i katërt. Në çfarë mase, nxjerrja afatgjate e ujit nëntokësor do të ndikoj në sasinë e ujit nëntokësor në fushën e puseve për ujë të pijshëm, aktualisht nuk është e njohur. Nivelit të ujërave nëntokësor tregojnë të paktën se edhe një sasi e ujit ti tillë rrjedh nga fusha e puseve të RC Coles në drejtim të aquiferit aluvial të Moravës. Prandaj një ndikim i tillë nuk mund të përjashtohet.

Sasia e ujërave të zeza që do të prodhohet në të ardhmen, do të rritet me shpejtësi të njëjtë sikurse nevoja për ujë të pijes.

Në lidhje me rritjen e nevojës, gjendja e shkatërruar pjesërisht e rrjetit të kanalit, dhe nga vet fakti se Gjilani nuk ka pajisje të punës për trajtimin e ujërave të zeza, është e evidente se sistemi për menaxhimin e ujërave të zeza duhet të riparohet.

Masa më urgjente është ndërtimi i një impianti të ri i ujërave të zeza për qytetin dhe komunën. Lokacioni në pikën më të ulët në pjesën juglindore të qytetit është propozuar në Planin Zhvillimor Urban. Shembuj të më tejme më të detajuar duhet të bëhen për ta vendosur nëse riparimi i impiantit të ujërave të zeza është i mundshëm, ose është i nevojshëm ndërtimi i një objekti plotësues ndihmës. Lokacionin e saktë për impiantin e ri të kanalizimit dhe mundësia e lidhjes së tërë komunës në këtë impiant gjithashtu duhet të promovohet.

Me zgjerimin e sistemit të kanalizimit, do të jetë i nevojshëm një menaxhim më gjithëpërfshirës i ujit. Elementi kryesor i menaxhimit modern të ujit është ndarja e grumbullimit të ujërave nga reshjet dhe ujërat e zeza. Përderisa ujërat e zeza duhet të grumbullohen dhe trajtohen brenda një sistemi të mbyllur, ujërat e reshjeve duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë sikurse cikli i ujërave natyrorë. Kjo i përfshinë ruajtjen dhe infiltrimin e ujërave nga reshjet brenda zonave banuese dhe komerciale. Ruajtja dhe infiltrimi i urave nga reshjet e redukton shkarkimin e ujërave të zeza gjatë kohëve të rënies dhe ndihmon në reduktimin e investimeve të nevojshme. Këtë masë janë shumë të nevojshme në zonat e dendura të ndërtesave siç është qyteti i Gjilanit.



## Energjia elektrike

Reduktimet shpeshta te energjisë elektrike janë dukuri e përditshme dhe ne çdo sezone ne Kosove si edhe në Gjilan.

Problemi kryesorë në këtë komunë është gjendja e keqe e rrjetit për furnizim me energji elektrike. Shumë ekonomi familjare furnizohen nga linjat mbitokësore, disa prej tyre në gjendje të shkatërruar. Përmirësimi i këtyre linjave duhet të ketë prioritet. Mundësia e eksploatimit të burimeve të energjisë elektrike alternative brenda komunës gjithashtu duhet të provohet.

Humbjet elektrike janë dukuri që përfshinë çdo sistem elektroenergjetik. Sidoqoftë humbjet e energjisë për Gjilan dhe rrethinë të llogaritura si humbje teknike evidentohen me një përqindje prej (10.2-10.6) % sipas shënimeve në distribucion duke mos i marr parasysh humbjet komerciale që paraqet një dukuri negative në menaxhimin e KEK

Fytet e ngushta, të furnizimit me energji elektrike, janë prezentë pothuajse ne tere SEE të Kosovës, pra edhe ne komunën e Gjilanit. Furnizimi kualitativ dhe kuantitativ i Anamoravës me energji Elektrike do të sigurohet atëherë kur të ndërtohet edhe një trafostacion i ri, TS 110kV së bashku me Largpërçuesin e dyfishtë 110kV (në gjatësi 2x0.8 km) dhe kyçjen e linjave kabllobike 10(20)kV në rrjetin lokal. Linjat 20kV, neper qytet duhet te jene kabllore, ndërsa ato për vendbanimet rurale , ajrore.



Fig. 34: Trafostacionet e reja ne Kosove



Burimi: KEK


TS e ri 110/20(10) kV

§ TS\_2002-2005

§ TS\_2006-2010

§ TS\_2011-2015

Fig. 35: Renjet e Tensionit



Burimi: KEK

#### Rëniet e tensionit (%)

2000 - # 0-5

2005 - # 5-10

2010 - # 10-15

2015 - # 15-30

KEK-u ka paraparë ndërtimin e TS 110/20 kV, Gjilani(GL V), që do të ndërtohet në zonën të tregu i Automjeteve dhe TS 110/20 kV, Gjilani(GL-IV), respektivisht do të shëndrrohet TS 35/10 kV në TS 110/20kV, zona afër varrezave.

Shndërrimi- Rikonstruimi i rrjetit 10 kV ne atë 20kV në tërë Kosovë pra edhe për komunën e Gjilanit, paraqet investim kapital në energjetikë. Kështu do te eliminohen fytet e ngushta, do të zvogëlohen humbjet teknike, do te rritet aftësia bartëse e linjave dhe do te mundësohet furnizimi cilësor dhe sasior me energji elektrike.



## Menaxhimi i mbeturinave

Zvogëlimi i ndotjes së mjedisit përmes grumbullimit të mbeturinave është parësorë për mbrojtjen e ambientit. Mu për këtë, e që grumbullimi i mbeturinave të përfshihet edhe në pjesët rurale, duhet të favorizohet sistemi institucional i grumbullimit të tyre. Ai është gjithashtu i rëndësishëm për ngritjen e vetëdijesimit të popullsisë në lidhje me rrezikun nga hedhja e mbeturinave vend e pa vend, të cilat mund të shkaktojnë edhe paraqitjen e ndonjë epidemie në mjedise të tilla.

Momentalisht, mbeturinat janë grumbulluar në pjesë të mëdha të Kosovës jugore dhe janë transportuar në deponon rajonale në Gjilan, ku mbeturinat ruhen pa asnjë trajtim të mëtutjeshëm. Në të ardhmen, kur të rregullohet menaxhimi i mbeturinave nga rregulloret e BE-së, mbeturinat do të kallen dhe vetëm hiri do të depozitohet. Vetëm disa deponi të tilla për djegien e mbeturinave do të jenë të nevojshme në tërë Kosovën, dhe me sa duket ato do të ndërtohen në kombinim me deponit rajonale të sotme. Një zgjerim i deponisë ekzistuese të Gjilanit megjithatë mund të pritet.

Prioriteti i parë për menaxhimin e mbeturinave si pasoj duhet që shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të zgjerohen në tërë komunën dhe të pastrohen pjesët e depozitimit ilegal të mbeturinave. Në hapin e dytë, pajisjet dhe metodat e deponimit të mbeturinave ekzistuese duhet të adoptohen me standardet e BE.

## Telekomunikacioni

Shumica e pjesëve të komunës janë të mbuluara me rrejt të telefonisë mobile. Nuk kanë qasje në telefoni fikse të gjitha pjesët e komunës. Prioritet duhet tu jepet të gjithë banorëve që të kenë qasje edhe në telefoninë me kablo edhe atë mobile.




Rrjetit i ujësjellësit






Rrjetit i kanalizimit



Transporti publik



Rrjetit i telefonisë fikse



**Kufiri i zonës urbane**  
Urban zone boundary

**rrugë magjistrale**  
magistral road

**rrugë rajonale**  
regional road

**rrugë përreth qendrës**  
city centre by pass

**rrugë kryesore**  
main thoroughfare

**rrugë lokale me prioritet të lartë**  
local road with high priority

**rrugët lokale**  
local streets

**Qendra e mobilitetit (opsioni 1)**  
Qendra e mobilitetit (opsioni 2)

**hekurudha**  
railway

**deponi / qendër reciklimi**  
landfill / recycling centre

**impjanti i kanalizimit**  
sewage plant

**Kuvendi Komunal Gjiçan**  
Municipal Assembly Gjiçan

**Plani zhvillimor urban i Gjiçanit**  
Urban development plan and of Gjiçan

**Trafiku dhe infrastruktura teknike**  
Traffic and Technical Infrastructure

14.04.2008

**Plan 9**  
Plan 9

**Peprjesa:**  
Scale:  
0 100m 500 1km

**DIREKTORIA PER URBANIZIM, RINDERTIM DHE AMBIENT**  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

**planingsgruppe 4**



### 3.2.3 Popullsia, banimi, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgimia kulturore

#### Bazat për vlerësimin e kërkesave për banim në të ardhmen

Vlerësimi i kërkesave për të ardhmen është i bazuara në këto të dhëna:

Tab. 39: Kërkesat për banim në të ardhmen në Gjilan, bazat e vlerësimit

Artikulli	2002	2020	increase
Numri i banorëve, komunë	139.558		
Zhvillimi nga shtimi natyral		161.395 max	21.837 max
Zhvillimi me migrim negativ (-100)		159.396 (-100)	19.838 (-100)
Zhvillimi me migrim (-250)		156.430 (-250)	16.872 (-250)
Numri i banorëve Qyteti	79.000	91.361 max	12.361 max
Numri i banorëve Fshatrat	60.558	70.034 max	9.476 max
Numri i ekonomive shtëpiake - Komuna	23.723	32.279 max	8.500 max
Numri i ekonomive shtëpiake - Qyteti	14.364	20.302 max	6.000 max
Numri i ekonomive shtëpiake - Fshatrat	9.359	11.672 max	2.300 max
Persona/Familje - Komuna	5,9	5,0	
Persona/Familje - Qyteti	5,5	4,5	
Persona/Familje - Fshatrat	6,5	6,0	
m <sup>2</sup> /për person (Kosova)	18,658	23	
Përqindja e të ardhurave të kryefamiljarëve	not known	increasing	
Numri i njësisve banesore ekzistuese	not known	increasing	
Kostot e banimit	not known	increasing	

#### Legjenda

Te dhena te ndryshme statistikore	
Llogaritjet	
Te dhenat statistikore per Kosoven	
Kalkulimi i parashikimeve	
Kalkulimet	

<sup>8</sup> Cf. MMPH / Instituti për Planifikim Hapësinor: Plani Hapësinor i Kosovës, dokument pune, 2005.



## Struktura urbane dhe shfrytëzimi i tokës

Qendra e qytetit të Gjilanit është e rrethuar me qendrat shkollore në perëndim, spitalin në jug dhe rrugën e re anësore në lindje. Një unazë e zonave për përdorim të përzier e rrethon qendrën e qytetit. Rrugët kryesore nga periferitë për në qendër, si dhe një pjesë të rrugës unazore në jugperëndim, janë të rrethuara kryesisht nga zonat për përdorim të përzier. Dy qendra rajonale e plotësojnë qendrën e qytetit dhe atë: një në Dardani dhe një në Arbëri.

Ekzistojnë kryesisht zona banuese në të tri anët e qendrës së qytetit. Zonat komerciale dhe industriale janë të koncentruar në pjesën verilindore të qytetit, përgjatë rrugës M25-3.

Struktura urbane e ardhshme për qytetin e Gjilanit, përbëhet nga zgjerimet e mëdha urbane. Furnizimi i përcaktuar i tokës për të ardhmen është i paraqitur në detale në kapitullin për demografinë. Llojet e ndryshme të përdorimit të tokës janë paraparë si në vijim:

### Qendra e qytetit

Qendrat kryesisht po sigurojnë hapësirë të pajisjeve qendrore për biznes tregti, administratë dhe sport kulturë. Qendrat rajonale plotësojnë qendrën e qytetit me shërbime lokale. Janë paraparë përdorimet si në vijim:

1. Biznes, zyra dhe administratë,
2. Tregtia me pakicë, tregtia e furnizimit të ushqimeve, tregtia e akomodimit,
3. Përdorimet tjera jo shqetësuese komerciale,
4. Pajisjet për fenë, kulturën, pajisjet sociale , të kujdesit shëndetësorë, dhe çështje sportive,
5. Pompat e karburantit në kombinim me parkingjet e automjeteve,
6. Për banim.



## Zonat për përdorim të përzier

Zonat për përdorim të përzier, kryesisht sigurojnë hapësirë për banim dhe për çështje komerciale të cilat nuk po e pengojnë njëra tjetrën, e të paraparë për përdorimet si :

1. Ndërtesat e banimit,
2. Ndërtesat për biznes dhe zyra,
3. Tregtia me pakicë, tregtia e furnizimi të ushqimeve, tregtia e akomodimit,
4. Përdorimet tjera jo shqetësuese komerciale,
5. Ndërtesat për administratën si dhe ato për fenë, kulturën , sociale, kujdesje shëndetësore dhe çështje sportive,
6. Ndërmarrjet kopshtare,
7. Pompat e karburantit ,
8. Pajisjet për argëtim.

## Përdorimi kryesisht për banim

Shumica e zonave të banimit sigurojnë hapësirë të duhur për banim, si në vijim:

1. Ndërtesat për banim,
2. Furnizimi i zonave të nevojshme për tregti me pakicë, të furnizimit të ushqimit, dhe përdorimet komerciale jo shqetësuese,
3. Pajisjet për fenë, kulturën, pajisjet sociale të kujdesit shëndetësorë, dhe çështje sportive.

Përdorimet si në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Tregtia e akomodimit ,
2. Përdorimet tjera jo shqetësuese komerciale,
3. Ndërtesat për administratë,
4. Ndërmarrjet kopshtare,
5. Pompat e karburantit.



## Zonat për përdorim të përbashkët

Zonat për përdorim të përbashkët sigurojnë hapësirë për pajise publike si: shkollat, çerdhet e fëmijëve dhe qendrat e kujdesit shëndetësorë. Gjithashtu janë paraparë edhe objekte tjera publike.

## Zonat komerciale/industriale

Zonat komerciale dhe industriale sigurojnë hapësirë për të gjitha llojet e çështjeve komerciale, kryesisht përdorimet që nuk janë të lejuara në zonat tjera. Janë paraparë përdorimet si në vijim:

1. Të gjitha llojet e ndërmarrjeve komerciale dhe industriale, ndërtesat e dyqaneve, depot dhe ndërmarrjet publike,
2. Biznes, zyra dhe administratë,
3. Pompat e karburantit,
4. Objekte sportive.

Përdorimet në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Objektet për fenë, kulturën, pajisjet sociale dhe kujdesit shëndetësorë,
2. Banimin për stafin mbikëqyrës, menaxherët ose pronarët e prodhimeve,
3. Objektet e ndërmarrjeve.

## Edukimi

Planifikimi i objekteve të reja ndihmëse për shkolla dhe shërbime tjera edukative duhet të bazohen në një program, i cili duhet të përpunohet në emër të Drejtorisë të Arsimit në komunë.

Shkollat e mesme dhe fillore ekzistuese në qytet janë të stërmunduara nga numri i madh i nxënësve, dhe shkollat e reja do të jenë të domosdoshme. Pesë shkolla fillore dhe një shkollë e mese në pjesën perëndimore të qytetit tanimë janë paraparë në Planin Rregullues Qarku. Drejtoria Komunal e Arsimit duhet të provojnë nëse këto shkolla të reja do



të jenë të mjaftueshme për ti plotësuar nevojat për vitet e ardhshme. Shkollat fillore ekzistuese duhet të përkrahen, rinovohen dhe të pajisen sipas numrit të nxënësve.

Institucionet parashkollore 30 - 40 m<sup>2</sup>/fëmijë

Shkollat fillore dhe të mesme 35 - 60 m<sup>2</sup>/fëmijë

Edukimi i lartë, si p.sh. Fakultetet e Universitet të Prishtinës si dhe trajnimet profesionale duhet të ofrohen në qendrën shkollore të përcaktuar në afërsi të ish kampit Montith. Lokacioni i sakët duhet të përcaktohet me plane rregulluese.

Përcaktimi i lokacioneve të sakta për shkollat potenciale për të ardhmen duhet të vendosen në planet rregulluese. Afër zonave të përcaktuar për përdorim nga komunitetet, shkolla dhe objekte tjera ndihmëse të edukimit, janë lejuar në qendër të qytetit edhe zonat për përdorim të përzier edhe zonat kryesisht për banim.

### Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor në qytet është i furnizuar nga një numër i qendrave për kujdesin shëndetësor. Meqenëse popullsia është rritur në mënyrë thelbësore në vitet e fundit, dhe do të vazhdon të rritet, edhe nevoja për kujdesin shëndetësor rritet. Nevoja për të ndërtuar ambulanca të reja dhe qendra të kujdesit shëndetësor familjar në qytet, si dhe nevoja për zgjerimin e spitalit rajonal duhet të praktikohet nga Drejtoria i Shëndetësisë.

Lokacioni i saktë i objekteve ndihmëse të kujdesit shëndetësor për të ardhmen duhet të vendoset në planet rregulluese urbane. Afër zonave të përcaktuar për përdorim nga komunitetet, objektet tjera ndihmëse të kujdesit shëndetësor, zonat për përdorim të përzier dhe zonat kryesisht për banim janë lejuar në qendër të qytetit.

### 3.3 SHËNJIMI I NDËRTIMEVE, ZONAVE APO PROJEKTEVE STRATEGJIKE TË APROVUAR NE PLANET PËR RAJONE ME TE GJERA

Si projekte strategjike të aprovuara në plane për rajone më të gjëra janë:

- Bashkëpunimi ndërkuftarë i cili e definojnë Gjilanin si qendër të "treëndëshit të dyfishtë "
- Deponia Rajonale,
- Impianti rajonal,
- Hekurudha.

	Kufiri i zonës urbane	Urban zone boundary
	Kufiri kadastral	Cadastral border
	qendra e qytetit	city centre, existing / planned
	shfrytëzim kryesisht i përzier, ekzistues / i planifikuar	mainly mixed use, existing / planned
	hapësira me shfrytëzim kryesisht banimi, ekzistues / e planifikuar	mainly residential area, existing / planned
	hapësira me shfrytëzim kryesisht shqetësor, ekzistues / e planifikuar	school / care centre / university hospital / health care centre
	shkolle / qendër / universitet	school / care centre / university hospital / health care centre
	hapësira me shfrytëzim komercial / industrial ekzistues / e planifikuar	commercial / industrial area, existing / planned
	hapësira të rrizhviluara	redeveloped areas
	zonë rurale ekzistues / e planifikuar	village zone, existing / planned
	Park/zona për rekreim dhe shëndetësi	recreation and health zone
	fushë sporti / sallë sporti	sportsfield / sports hall
	bazen i hapur / vend vështrimi	open air bath / viewpoint
	pyll	forest
	lum me rrafshinë të krijuar nga vërshimet / hapësirat mbrojtëse	river with flood plain / retention areas
	rrugë megjistrate	magistral road
	rrugë rajonale	regional road
	rrugë lokale me prioritet të lartë	local road with high priority
	rrugë lokale	local road
	hekurdhja	Market
	Qendra e mobilitetit (opsioni 1)	Market
	Qendra e mobilitetit (opsioni 2)	Market

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor urban i Gjilanit**  
Urban development plan and of Gjilan

**Plani i zhvillimit hapësor**  
Qyteti i Gjilanit  
Spatial Development Model Gjilan Town

14.04.2008

Plan 10  
Plan 10


Përpjesa:  
Scale:  
0 100m 500 1 km

DIREKTORIA PËR URBANIZIM, RINDERTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

**TECH**  
INSTITUTE FOR URBANISM AND ENVIRONMENT

**WU**  
INSTITUTE FOR URBANISM AND ENVIRONMENT

planungsgruppe 4





### 3.4 VLERËSIMI I NDIKIMIT TE KORNIZËS SE PROPOZUAR

Planifikimet kanë ndikime në jetën e njerëzve si dhe në zhvillimet sociale dhe ekonomike. Këto ndikime doemos reflektohen edhe në hapësirë në këto dy forma:

- Okupimi i territorit të ri,
- Ndërrimi i destinimit të territoreve me funksione të reja.

Këto ndikime mund të jenë pozitive dhe negative në jetën e njeriut, në zhvillimet ekonomike, sociale si dhe në mjedis. Meqenëse planifikimet bëhen me qëllim të përmirësimit të kualitetit jetësorë, atëherë nënkuptohet që këto ndikime duhet të jenë pozitive në të gjitha aspektet. Ndikimet negative duhet të minimizohen.

Korniza e paraparë e zhvillimit është orientuar kah veprimi. Ajo parasheh zhvillime të cilat banorëve të Gjiçanit duhet të t'i sjellin përparim social dhe ekonomik. Zhvillimi i mbështetur në katër shtylla e tij, tenton t'i mobilizojë të gjitha resurset e zhvillimit ekonomik, për të shtuar numrin e vendeve të punës, për të rritur kualitetin e prodhimeve dhe për t'i dhënë një identitet rajonit. Zhvillimi ekonomik duhet të përkrahet nga një zhvillim social i përparuar në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit. Zhvillimi ekonomik dhe social duhet të mbështetet nga një infrastrukturë funksionale si dhe shërbime më të mira për qytetarët.

Ndikimet e mundshme negative ekonomike dhe sociale nga strategjia e paraparë mund të jenë fragmentare duke pasur parasysh se në komunën e Gjiçan janë paraparë edhe projekte të nivelit qendror – si psh. hekurudha, e cila mund të ndikojë në zhvillimet lokale nëpër vendbanime apo jashtë tyre – siç janë ekspropriimi i tokës, ndarja e ngastrave të tokës bujqësore.

Përveç ndikimeve ekonomike dhe sociale, ndikimet e mundshme në mjedis të cilat duhet të merren parasysh gjatë implementimit të planit Zhvillimor Urban janë cekur si më poshtë.

#### NDIKIMI NË TOKË – ZËNIA E TOKËS BUJQËSORE

Njëri nga prioritetet e planit është mbrojtja e tokës kualitative bujqësore dhe ndalimi i ndërtimit në tokat e kategorisë I-IV. Strategjia parasheh ndalimin e ndërtimit në tokën kualitative bujqësore, përveç në rastet e përshkruara me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor. Zgjerimi i paraparë në principet e dendësisë ndërtimit megjithatë nuk do të ishte i mjaftueshëm





për parashikimet aktuale të rritjes së popullsisë, prandaj zhvillimet në anën lindore të qytetit duken të pashmangshme.

#### NDIKIMI NË AMBIENT

Ndotja e ajrit kryesish shkaktohet nga:

- Trafiku
- Industria
- 

**Trafiku** - Ndotja e ajrit nga trafiku parashihet të zvogëlohet me shkarkimin e trafikut kryesor transit në Unazën e jashtme dhe atë të brendshme. Rrjeti i ri i trafikut me strategjinë e propozuar ka paraparë përmirësimin e kualitetit të rrugëve gjë që ndikon edhe në zvogëlimin e ndotjes.

**Prodhimtaria industriale** - Ndikimet negative nga prodhimtaria industriale do të zvogëlohen pasi që strategjia parasheh zhvillimin e prodhimitarisë jo shqetësuese dhe ndërrimin e destinimit nga ajo e rëndë në industrinë e lehtë. Po ashtu zonat industriale klasike parashihen të transformohen në zona mikse (industri+tregti). Sipas rregullores së MMPH, çdo prodhim i ri, si pjesë e kërkesës për leje ndërtimi dhe operimi, duhet të përgatishë Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis me çka bëhet i mundur kontrolli i ndikimeve në mjedis sipas kriterëve ligjore aktuale.

#### NDIKIMI NË UJË

Ndikimet negative në ujëra janë kryesisht nga derdhjet e kanalizimeve të ujërave të zeza të cilat nuk janë të trajtuara paraprakisht. Me planin e ri parashihet integrimi i infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe ndarja e kanalizimit atmosferik i cili mund të derdhet në lumenj. Po ashtu është paraparë ndërtimi i kolektorëve përgjatë lumit si dhe një impianti lokal si nënstation, para lidhjes së impiantit kryesor që parashihet të ndërtohet. Gjithashtu strategjia parasheh mbrojtjen e lumenjve nga ndërtimet si në zonën urbane ashtu edhe jashtë sajë, që do të ketë ndikime pozitive në mjedis.

#### NDIKIMI NË VEGJETACION

Ndikimi në vegjetacion do të jetë plotësisht pozitiv pasi që parashihet që në qendër të lejohet ndërtimin në shumë etazhe, banimit në lartësi me çka lirohet toka ndërtimore për gjelbërim. Gjithashtu edhe formimi i "gishtërinjve të gjelbër" do të ndikoj pozitivisht edhe në mikroklimën e qytetit.



## 4 STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

### 4.1 STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANET E VEPRIMIT TE SHOQËRUARA ME KONCEPTET HAPËSINORE OSE PARIMET

#### Instrumentet e rëndësishme për implementim

##### PLANET RREGULLUESE URBANE

Në lidhje me implementimin e projekteve të vendbanimeve – projekteve kyçe, është i nevojshëm mbulimi i zonës urbane me Plane Rregulluese (cf. Neni 15 Ligji për Planifikimin Hapësinor). **Planet Rregulluese Urbane**, “i përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave si dhe rregullat për lokacionin e ndërtesave në ngastrat urbane”. Përmes themelimit të bazës ligjore për ndërtimin e ndërtesave, ato e vendosin kornizën për investime private. Si rrjedhim Planet Rregulluese Urbane janë si mjete kyçe për implementimin e zonave të përcaktuara ndërtimore.

#### Definicionet udhëzuese për planet rregulluese – Parametrat Urban

- Definicioni për “Etazhe të Plotë”  
“Etazh i Plotë “ është etazhi, përdhesi me lartësi jo më pak se 1.4m mbi sipërfaqen e tokës dhe i cili ka në max. 2/3 e sipërfaqes së dyshemesë së etazhit nën te dhe nuk kalon lartësinë e pastër prej max 2.3m. Sipërfaqja e dyshemesë në etazhit që nuk janë etazhe të plota nuk do të konsiderohen ISD.
- Definicioni i indeksit të shfrytëzueshmërisë së ngastrës (ISHN)  
Indeksi i shfrytëzueshmërisë së ngastrës përcakton raportin në mes të ngastrës dhe ndërtimit që bëhet në Përdhes. Vlera numerike e ISHN është 1, nëse e tërë ngastra është e mbuluar me ndërtim.
- Definicioni i indeksit për sipërfaqe të dyshemesë (ISD)  
Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë përcakton se sa sipërfaqe të dyshemesë së ndërtuar lejohet për 1m<sup>2</sup> të ngastrës. Sipërfaqja e tërësishme e dyshemesë kalkulohet me gabaritin e etazheve të plota (bodrumi nuk konsiderohet në ISD).

**Tabela e Parametrave Urban**

Zonat	Etazhiteti	Indeksi ISHN		Indeksi ISD
		Banim/zonat mikse	Industria	
<b>1</b>	I - III	0.2 – 0.3	0.6	Max 0.8
<b>2</b>	II - IV	0.3 – 0.4	0.6	Max 1.2
<b>3</b>	II - VI	0.3 – 0.5		Max 1.8
<b>4</b>	III - VIII	0.4 – 0.6		Max 2.5
<b>5</b>	Mbi III	0.6 – 0.8		Max 4.0

**Tabela e Planeve të nevojshme rregulluese(shih planin 11):**

Numri rendor	Emri i planit	Aksioni	Zonat
1	Qendra e vjetër e Qytetit	Revidim	<b>5</b>
2	Qendra e vjetër e Qytetit	Revidim	<b>5</b>
3	Qendra e vjetër e Qytetit	Revidim	<b>5</b>
4.1	Dheu i bardhë	Revidim	<b>4</b>
4.2	Dheu i bardhë	Revidim+zhvillim	<b>4</b>
5.1	Dardania 1	Revidim	<b>4</b>
5.2	Dardania 2	Revidim	<b>4</b>
6	Parku i epërm"lliria"	Revidim	<b>5</b>
7	Nën kodra e dëshmorëve	Revidim+zhvillim	<b>3</b>
8	Kodra e dëshmorëve	Revidim	<b>5</b>
9.1	Arbëria 1	Revidim	<b>3+4</b>
9.2	Arbëria 2	Revidim	<b>3+4</b>
10	Kosova Petroll	Revidim+zhvillim	<b>5</b>
11	Banja	Revidim+zhvillim	<b>3+4</b>
12	Zona Industriale	Revidim+zhvillim	<b>1+3</b>
13 <sub>(a,b,c,d,f)</sub>	Qarku	Revidim	<b>3</b>



14	Iliria	Revidim	<b>4</b>
15	Varrezat e reja	Zhvillim i Ri	<b>1</b>
16	Rregullimi i shtratit të I. Mirusha	inkorporim	<b>-</b>
17	Pjesa verilindore e qytetit	Zhvillim i ri	<b>1+5</b>
18	Ish kampi Montith	Planifikim	<b>2+5</b>
19	Livadhet e Arapit	Planifikim	<b>3+4</b>
20	Zabeli i Sahit agës	Planifikim	<b>3+4</b>
21	Zona lindore e qytetit	Planifikim	<b>2+3</b>
22	Parku mbi Hallën e Sporteve	Revidim	<b>3+4</b>
23	Livadhet e Koretishtit	Zhvillim i ri	<b>3</b>
24	Livadhet te Mullini i Arapit	Revidim	<b>4</b>
25	Zona perëndimore e qytetit	Planifikim	<b>3</b>

- Vendbanimet joformale**
- ④ Plane Ekzistuese
  - ④ Plane të reja
  - ① Qendra e vjetër e qytetit-Revidim
  - ② Qendra e vjetër e qytetit-Revidim
  - ③ Qendra e vjetër e qytetit-Revidim
  - ④ Dheu i bardhë-Revidim
  - ④ Dheu i bardhë-Revidim dhe zhvillim i ri
  - ⑤ Dardania 1-Revidim
  - ⑤ Dardania 2-Revidim
  - ⑥ Parku i epërm "Iliria"-Revidim
  - ⑦ Nën kodra e dëshmorëve-Revidim+Zhvillim
  - ⑧ Kodra e dëshmorëve-Revidim
  - ⑨ Arbëria 1-Revidim
  - ⑨ Arbëria 2-Revidim
  - ⑩ Kosova petroll-Revidim+zhvillim i ri
  - ⑪ Banja-Revidim+zhvillim i ri
  - ⑫ Zona industriale-Revidim+zhvillim i ri
  - ⑬ (13a) (13b) (13c) (13d) (13e) Qarku-Revidim
  - ⑭ Iliria-Revidim
  - ⑮ Varrezat dhe z. industriale-Zhvillim i ri
  - ⑯ Mirusha-Inkorporimi projektit Mirusha
  - ⑰ Pjesa verilindore e qytetit-Zhvillim i ri
  - ⑱ Ish kampi Montith-Planifikim
  - ⑲ Livadhet e arapit-Planifikim
  - ⑳ Zabeli i Sahit agës-Planifikim
  - ㉑ Zona lindore e qytetit-Planifikim
  - ㉒ Parku mbi hallën Sportive-Revidim
  - ㉓ Livadhet e Koretisë-Zhvillim i ri
  - ㉔ Livadhet te Mullini i Arapit
  - ㉕ Zona perendimore e qytetit-Planifikim

**Kuvendi Komunal Gjilan**  
Municipal Assembly Gjilan

**Plani zhvillimor urban i Gjilanit**  
Urban development plan and of Gjilan

**Planet rregulluese**  
Regulatory Plans

14.04.2008

Plan 11  
Plan 1


Përpjesa:  
Scale:  
0 100m 500 1 km

DIREKTORIA PER URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT  
THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT

TECH  
INSTITUT FÜR URBANISME UND UMWELT

UWJ  
UNIVERSITÄT WÜRZBURG

planungsgruppe 4





## PROJEKTET KYÇE

Projektet kyçe i tregojnë masat e zhvillimit të cilat janë qenësore për implementimin e fazave të lartpërmendura të tij. Lista e projekteve kyçe përmban një përzierje masash në fushën e vendbanimeve, peizazhit, trafikut dhe infrastrukturës, drejt zhvillimit të qëndrueshëm të zonës urbane.

Projektet e propozuara kyçe janë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Gjilanit. Ato janë ndarë në projekte për vendbanim, peizazh, trafik dhe infrastrukturë teknike. Radhitja e projekteve kyçe nuk e përcakton prioritetin e tyre.

### Vendbanimet

- Plani Rregullues Qarku

Zona e planit ekzistues Qarku ka pësuar ndërrime të konsiderueshme zhvillimore. Mu për këtë është e nevojshme që ky plan të revidohet, me qëllim të orientimit me të mirë për ndërtim të mëtutjeshëm.

- Planet Rregulluese "Arbëria 1" dhe "Arbëria 2"

Zonat Arbëria 1 dhe 2 të qytetit momentalisht janë në presion të lartë të zhvillimit. Zhvillimi i pakontrolluar që ka zënë vend tani është duke e shkaktuar përdorim jo efektiv të tokës ndërtimore. Për ta rregulluar zhvillimin e ardhshëm duhet të bëhet plani rregullues urban për këto zona.

- Revidimi i planit "Qendra e vjetër e qytetit"

Nevoja e transformimit të qendrës së qytetit është e dukshme. Prandaj duhet të bëhet plani rregullues për qendrën e qytetit.

- Plani Rregullues për pjesën veriore të Gjilanit (Dheu i bardhë dhe Banja).

Për ti parashikuar nevojat për tokë të banimit, pjesa veriore e Gjilanit do të zhvillohet si zonë banuese. Kjo pjesë e qytetit është mirë e lidhur me rrugën anësore ekzistuese, dhe ndërtimet do të vazhdojnë pa investime të mëdha për rrugë të reja.



- Revidimi i planit "Parku mbi hallën e Sporteve"

Hyrja në qytet nga ana e Ferizajt është nën presion të dukshëm zhvillimorë, prandaj ndihet nevoja e revidimit të planit ekzistues.

- Plani rregullues për zonat mikse industriale dhe komerciale (ish kampi Montith).

Për të pasur mundësi për ta drejtuar zhvillimin komercial në qytet në mënyrë të dëshirueshme, duhet të përgatitet pjesa e parë e zonës komerciale. Për ta siguruar këtë zhvillim pa e bllokuar çfarëdo ri-zhvillimi për të ardhmen të rrugës M25-3 ose rrugës unazore, ndërtimet në këtë zonë duhet të rregullohen në planin rregullues.

- Vendbanimet Joformale ( VBJF)

VBJF duhet të zyrtarizohen- formalizohen. Forma e formalizimit të tyre është dhënë në Udhëzuesin për formalizimin e VJ të MMPH-së.

Preferohet që komuna të bëjë profilizimin e të gjitha VBJF në qytet dhe krijimin e një baze të dhënave për qytetin. Komuna duhet të përgatis profilin e gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në territorin e tyre. Kjo do t'u shërbente për të përcaktuar prioritetet e rregullimit të vendbanimeve joformale, kurse donatorëve të mundshëm do t'u ofronte informata të nevojshme për nevojën e përkrahjes financiare, humane dhe teknike në rregullimin e tyre.

Shërbimet e kadastrit dhe pronës duhet të sigurojnë planet gjeodezike dhe shënimet pronësore në mënyrë që saktësia e informatave të mos paraqesë problem për planifikim.

Çështja e pronës: nevojitet një angazhim intensiv i Komunës për të përcaktuar të drejtat pronësore. Të gjitha dokumentet e nevojshme pronësore duhet të mblidhen dhe verifikohet vlefshmëria e tyre.

Çështjet e pazgjidhura pronësore duhet të zgjidhen në mënyrë që të krijohet baza ligjore për fillimin e procesit të planifikimit.

Procesi i planifikimit - Rregullimi i vendbanimeve joformale duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë mundësi të artikulojnë kërkesat e tyre dhe marrja e vendimeve të



jetë transparente. Për këtë qëllim duhet të organizohen banorët e vendbanimeve të tilla, që të jenë të gatshëm të kyçen në proces, përmes të zgjedhurve të komunitetit apo pjesëmarrjes së të gjithëve. Kostoja dhe kohëzgjatja e formalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale duhej të jete komponentë e obligueshme e strategjisë afatmesme dhe afatgjate të rregullimit të vendbanimeve joformale në qytet.

### Infrastruktura e trafikut dhe teknike

Implementimi i projekteve të caktuar për trafik dhe infrastrukturë kërkojnë një **studim të realizueshmërisë** teknike në detaje. Ato kanë nevojë që ti grumbullojnë të gjitha informatat e tyre për ta vlerësuar nevojat e sakta teknike për implementimin e tyre si dhe koston e tyre.

- Studimet e realizuara për rrugë unazore

Për ta liruar brendinë e qytetit nga trafiku përmes, është propozuar një rrugë unazore me disa pjesë në këtë plan. Kompletimi i rrugës unazore është një projekt i madh, dhe ndërtimi i saj do të jetë i mundshëm vetëm në disa faza. Linja e rrugës unazore është vendosur afër qytetit, dhe duhet të koordinohet me disa projekte tjera. Për ta siguruar ndërtimin e suksesshëm të rrugës unazore, duhet të bëhet një studim i arsyeshëm dhe një korridor duhet të mbahet i lirë nga ndërtimet.

### Korridori për linjën hekurudhore dhe stacioni kryesor

Linja hekurudhore e lartpërmendur do të kalojë përmes periferisë së qytetit. Me sa duket kjo linjë hekurudhore nuk do të ndërtohet në një të ardhme të afërme. Për ta siguruar mundësin e realizimit në të ardhmen, një korridor përgjatë linjës së planifikuar duhet të mbahet i lirë nga ndërtimet. Gjithashtu vendi për stacionin e ardhshëm hekurudhor duhet të sigurohet.

### Peizazhi dhe mjedisi

- Rekreacioni i sistemit të lumit

Disa lumenj dhe përrenj kalojnë përmes qytetit të Gjiçanit. Mbeturinat hedhen dhe kanalizimi derdhet drejtpërdrejt në këtë lum. Pjesë të lumenjve dhe përrenjve kalojnë përmes gypave në sipërfaqe.





Lumenjtë dhe përrenjtë duhet të pastrohen dhe rigjallërohen. Përrenjtë dhe lumenjtë që i përshkojnë pjesët e qytetit e që kanë shtratin e hapur, ku duket rrjedhja e ujit të tyre, krijon pamje të mrekullueshme për mjedisin.


– Kanalet e gjelbra

Kanalet e gjelbra luajnë një rol të rëndësishëm për strukturën e gjelbër të Gjilanit. Një nga kanalet e para që duhet të zhvillohet është i vendosur ndërmjet rrugës M25-3 drejt Ferizajt dhe rrugës M25-2 drejt Preshevës, në mes të një zone e cila për momentin është në një shtypje të lartë të zhvillimit.

Në lidhje me përgatitjen e planit rregullues urban, në pjesën veriore të Gjilanit duhet të zhvillohet një kanal i gjelbër përgjatë rrugës R213.

■■■■ Kufiri i zonës urbane  
 ■■■■ Plani rregullues i sheshit  
 VENDBANIMET SETTLEMENTS  
 ① Revidimi i planit QARKU  
 ② Revidimi i "Arbëria 1 dhe Arbëria 2"  
 ③ Revidimi i "Qendra e vjetër e qytetit"  
 ④ PRU Dheu i Bardhë  
 ⑤ PRU Banja  
 ⑥ Revidimi i "Parku mbi hallën sportive"  
 ⑦ PRU Ish Kampi Montith  
 MJEDISI  
 ① sistemi i lumëjve  
 ② gishti i gjelbër dhe rinatyrimi i parkut jugor  
 ③ gishti i gjelbër dhe rinatyrimi i parkut veriperendimor  
 ④ gishti i gjelbër dhe rinatyrimi i parkut lindor  
 TRAFIKU DHE INFRASTRUKTURA TEKNIKE  
 ① Plani i fizibilitetit për caktimin unazës së jashtme rrugore  
 ② Plani i fizibilitetit për caktimin unazës së jashtme rrugore  
 ③ Plani i fizibilitetit për caktimin e vijës hekurudhore

Kuvendi Komunal Gjilan  
 Municipal Assembly Gjilan  
 Plani zhvillimor urban i Gjilanit  
 Urban development plan and of Gjilan  
 Projektet Kyqe  
 Key Projects  
 14.04.2008  
 Plani 12  
 Plan 12  
 Përpljesa:  
 Scale:  
 0 100m 500 1 km  
 DREKTORIA PËR URBANIZEM, RINDERTIM DHE AMBIENT  
 THE DEPARTMENT OF URBANISM, RECONSTRUCTION AND ENVIRONMENT  
 ITECH  
 INSTITUTI I PLANIMIT DHE URBANIZIMIT  
 IWI  
 INSTITUTI I PLANIMIT DHE URBANIZIMIT  
 planingsgruppe 4





## FAZAT E ZHVILLIMIT

Shtylla e implementimit të strategjisë janë **fazat e zhvillimit**. Përmes fazave identifikohet korniza kohore si dhe ndërvaresinë ndërmjet masave, kritereve dhe mundësive për realizim të projekteve përkatëse.

Struktura urbane e Gjiçanit e bënë zhvillimin e tij të ndryshueshëm, ku duhet ndërmarr veprime dhe disa hapa të mundshëm. Zhvillimi duhet ta marr qytetin si pikë fillestare dhe pastaj të fillohet me rregullimin e infrastrukturës së re.

**Në fazën e parë**, zonat e pa-ndërtuara përgjatë rrugëve ekzistuese. Kjo i jep mundësi komunës që të siguroj zona të reja pa investime të mëdha në infrastrukturë. Zonat banuese dhe për përdorim të përzier janë zhvilluar përgjatë rrugëve magjistrale M25-2 dhe M25-3 si dhe pjesët ekzistuese të rrugës unazore. Një zone me rreth 30 hektar për përdorim komercial dhe industrial është zhvilluar në udhëkryqin ndërmjet rrugës M25-3 dhe rrugës unazore.

Hapat e parë të konceptit të gjelbërimit janë realizuar: lumenjtë që kalojnë përmes qytetit janë të pastra dhe zonat e gjelbra përreth janë zhvilluar në parqe të ngushta. Hapësira në mes të varrezave dhe fushat e sportit në pjesën jugore të Gjiçanit, është e lidhur me peizazhin e hapur me korridorin e parë të gjelbër. I tërë korridori nuk duhet të zhvillohet domosdo në park publik, por ndërtimi i ndërtesave është i ndaluar dhe mundësia për të shëtitur përmes zonës është e siguruar. Edhe hapi i parë në strategjinë e ripyllëzimit të komunës është ndërmarrë duke planifikuar ripyllëzimin me drunjë të kodrës përreth deponisë rajonale.

Një hap tjetër i rëndësishëm në fazën e parë është themelimi i korridoreve për rrugët e ardhshme dhe hekurudha. Për ta bërë ndërtimin e së ardhmes të mundur duhet të bëhet një studim i realizueshëm i rrugëve dhe korridoret duhet të mbahen të lira nga çfarëdo ndërtimi.

**Në fazën e dytë**, linja perëndimore ndërmjet rrugës M25-2 në drejtim të Prishtinës dhe M25-3 dhe në drejtim të Ferizajt është ndërtuar, si zonë banuese e planifikuar në planin rregullues Qarku. Linja ndërmjet M25-3 në drejtim të Ferizajt dhe M25-2 në drejtim të Preshevës dhe rruga anësore në brendinë e qytetit janë ndërtuar, dhe ndërtimet në Arbërisë janë shpeshuar. Në pjesën veriore është ndërtuar rruga unazore, dhe zonat fqinje komerciale dhe industriale janë zhvilluar.



Në zonat perëndimore në lindje të qytetit, ku bashkohen dy lumenjtë, është ndërtuar parku më i madh i qytetit. Programi i ripyllëzimit ka filluar në veriperëndim në kodër afër gurores.

Në fazën e tretë, linja lindore ndërmjet M25-2 drejtë Preshevës dhe rruga për Malisheve është ndërtuar. Zonat për përdorim të përzier dhe banuese përgjatë kësaj rruge janë shpeshtuar. Në perëndim pjesa e fundit e Planit Rregullues Qarku është ndërtuar. Pjesa e fundit e zonës industriale dhe komerciale përgjatë rrugës M25-3 në drejtim të Bujanovcit është ndërtuar.

Dy parqe janë zhvilluar: në Qarku në jug-perëndim dhe në Arbëri në jug-lindje. Pjesa më e madhe e malit në lindje të qytetit është planifikuar në kombinim me Parkun Arbëria.

Disa zhvillime nuk mundë të kontrollohen dhe të planifikohen nga Komuna. Kur të mbyllet kampi bazë i KFOR-it Monteith, kjo zonë mund të zhvillohet në zonë për banim për përdorim të përzier dhe komercial.

**Linjat hekurudhore janë projekte të rëndësishme për tërë Kosovën. Këto mundë të realizohen vetëm në kombinim me drejtorin të ndryshme, komunat fqinje dhe hekurudhën e Kosovës.**

#### 4.2 VLERËSIMET E STRATEGJIVE BAZUAR NE KRITERET E PËRCAKTUARA ME PARIME, POLITIKA DHE LIGJE

##### Monitorimi dhe Rishikimi

Gjilani, si edhe shumë komuna tjera në Kosovë, e ka eksperiencën e zhvillimit dinamik socio-ekonomik. Si rrjedhojë, nevojat për tokë ndërtimore dhe furnizim të infrastrukturës mund të ndryshojnë në mënyrë të papritur. Për këtë arsye, është e nevojshme që të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme zhvillimi i komunës – nëse është e nevojshme – të rishikohet përmbajtja e PZHU.

#### 4.3 AFATET KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZA INSTITUCIONALE

##### Hapat e përshtatshëm të zhvillimit

Projektet e treguara kyçe janë projekte me prioritet. Ato duhet të implementohen sa më shpejtë që të jetë e mundur, sipas kapaciteteve



financiare të komunës. Për shkak të ndryshimeve politike dhe ekonomike të pritura në periudhën afatshkurta dhe afatmesëm, kapacitet e investimeve të komunës mbeten të pasigurta. Duke qenë në dijeni për këtë fakt, është e nevojshëm që të adoptohet një **qasje hap pas hapi**, e cila e bën përdorimin maksimum të fondeve që janë në dispozicion për vitin buxhetor komunal.

Pasi që kapacitet e investimeve në komunën e Gjilanit janë të limituara për momentin, **faza e parë e zhvillimit** i përfshinë masat që mund të implementohen pa investime të mëdha. Investimet e mëdha janë të nevojshme në fazat e mëvonshme, që i lejojnë komunës për të grumbulluar fonde të nevojshme.

Duke marr parasysh **burimet e pakta financiare**, administrata e komunës duhet të kërkoj fonde shtesë nga programet kombëtare ose ndërkombëtare, në këtë mënyrë komuna mund ta nxitoj procesin e zhvillimit dhe ti arrij qëllimet e saja të zhvillimit në kuptimin më të hershme të kohës.

### Bashkëpunimi – instrument kyç për implementim

Në implementimin e PZHU i cili është i gatshëm, është e rekomandueshme që gjithashtu të merren përfitime nga **partneritetet publik-privat**. Kompanitë private mund të luajnë rol të rëndësishëm në modelet e financimit dhe të ofrojnë njohuri përkatëse dhe të specializuar.

Si shtesë është rekomanduar që të vlerësohet partneritetet strategjike me komunat fqinje ose autoritetet tjera publike (**partneritet publik-publik**) veçanërisht në ngritjen e shërbimeve publike dhe pajisjeve të infrastrukturës.

Përfundimisht, komuna duhet ti filloj përpjekjet e saj për **ti futur qytetarët** e saj në proceset e planifikuara. Kjo do të përfshihet në studimin e realizueshëm në Planin Rregullues Urban.

**SHTOJCA Nr. 1 – Propozim Për Planin e Veprimit**

*Vërejtje: Ky propozim duhet të trajtohet dhe harmonizohet me politikat Komunale*

Ky propozim i Planit Zhvillimor Urban të Gjilanit ofron kalimin në mes të gjendjes ekzistuese dhe kornizës hapësinore. Është formuluar pako e strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet e caktuara dhe rrjedhat tjera në proces

- Strategjitë për zbatim dhe planet e veprimit të shoqëruara me konceptet hapësinore ose parimet;
- Vlerësimi i strategjive bazuar në kriteret e përcaktuara me parimet për mbrojtje dhe zhvillim, politika dhe ligje;
- Afatet kohore, implikimet financiare, kornizën institucionale.

Strategjitë tona për zbatimin e Planit Zhvillimor Urban do të jenë përgatitja e planeve të nevojshme përkatëse, intervenimet konkrete në hapësirë për mbrojtje dhe zhvillim, përgatitja dhe harmonizimi i politikave komunale, krijimi i partneriteteve të nevojshme, menaxhim i informatave, hulumtime të vazhdueshëm dhe monitorim të zhvillimeve të gjitha këto duke u bazuar në kornizën ligjore.

Duke u bazuar në vizionin e komunës pakoja e strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore do të zbërthehet në plane veprimi për prioritete strategjike

Fig. 36: Plani i Veprimit për prioritetin – Hartimi i Planeve Përkatëse

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Plani Rregullues Qarku	3 muaj	20 000 €	Drejtoria e Urbanizimit Kompani Private	Revidim
Planet Rregulluese "Arbëria 1" dhe "Arbëria 2"	4 muaj	30 000€	Drejtoria e Urbanizimit Kompani Private	



Revidimi i planit "Qendra e vjetër e qytetit"	6 muaj	25 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani Private	
Plani Rregulluese për pjesën veriore të Gjiçanit (Dheu i bardhë dhe Banja).	1 vit	20 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani Private	
Revidimi i planit "Parku mbi hallën e Sporteve"	2 muaj	15 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani Private	
Plani rregullues për zonat mikse industriale dhe komerciale (ish kampi Montith)	5 muaj	100 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani të specializuara Private	
Vendbanimet Joformale ( VBJF)	1 vit	50 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani Private	

Fig. 37: Plani i Veprimit për prioritetin – Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Rekreacioni në sistemet të lumenjve	1 vit	20 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani të specializuara Private	
Kanalet e gjelbra	1 vit	5 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani të specializuara Private	
Trajtimi i mbeturinave	1 vit	10 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani të specializuara Private Miinistría Përkatesë	



Fig. 38: Plani i Veprimit për prioritetin – Infrastruktura Teknike

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Studimet për rrugë unazore	2 vite	15 000€	Kompani të specializuara Private	
Korridori për linjën hekurudhore dhe stacioni kryesor	1 vit	10 000€	Drejtoria e Urbanizmit Ministria Përkatëse	
Trajtimi i ujërave të zeza dhe atmosferike	2 vite	20 000€	Drejtoria e Urbanizmit Ministria Përkatëse	
Trajtimi i rrugëve unazore me pëmbajtje përcjellëse	2 vite	30 000€	Drejtoria e Urbanizmit Kompani të specializuara Private	
Përmirësim i rrjetit rrugor me infrastrukturë përcjellëse	6 muaj	50 000€	Kuvendi Komunal	
Burimet dhe furnizimet me ujë	2 vite	10 000€	Kuvendi Komunal Ministria Përkatëse	

Fig. 39: Plani i Veprimit për prioritetin – Demografia dhe çështjet Sociale

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Krijimi i infrastrukturës për edukim të ulët dhe të mesëm	6 muaj	5 000€	Kuvendi Komunal	
Sigurimi i lokacionit për edukim të lartë	3 muaj	20 000€	Kuvendi Komunal Ministria Përkatëse	
Krijimi i infrastrukturës për objektet kulturore dhe sportive	1 vit	30 000€	Kuvendi Komunal Sektori privat	
Krijimi i infrastrukturës shëndetësore	1 vit	10 000€	Kuvendi Komunal Sektori privat	





Fig. 40: Plani i Veprimit për prioritetin – Zhvillimi Ekonomik

Aktiviteti	Afati kohor	Implikimet financiare	Pjesëmarrësit	Vërejtje
Zonat e reja Industriale	2 vite	10 000€	Kuvendi komunal	
Funksionalizimi dhe rizhvillimi i hapësirave ekonomike aktive, gjysmë aktive dhe pasive	3 vite	30 000€	Kuvendi Komunal Sektori Privat	
Zhvillimi i zonave rekreative—sportive	2 vite	10 000€	Kuvendi Komunal Sektori Privat	



## 5 DISPOZITAT PËR ZBATIM

### 5.1 UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TE PLANIT ZHVILLIMOR URBAN GJATE HARTIMIT TE PLANEVE RREGULLUESE DHE PLANEVE TJERA

Komuna mund të fillojë me zbatimin e planit menjëherë pas aprovimit të tij. Një numër i elementeve të përfshira me plan duhet të sqarohen me Plane Rregulluese. PZHU nuk ka definuar në tërësi përkufizimet, rregullat e ndërtimit, parametrat urban kështu që një numër i madh i aspekteve të ndryshme duhen të specifikohen më hollësisht. Për çdo zonë urbane duhet të hartohen plane rregulluese. Të gjitha hulumtimet e nevojshme si psh. Studime mjedisore, studime në zona të veçanta arkeologjike si dhe studime rreth rregullimit të trafikut, janë të nevojshme dhe duhet zbatuar. Përveç rolit udhëzues për zhvillimin e zonës urbane, PZHU definon kushtet e zhvillimit të pjesëve të qytetit – planeve rregulluese për lagjet dhe blloqet urbane. Planet rregulluese nuk duhet të jenë në konflikt me dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal.

Dispozitat:

- PZHU duhet të jetë i bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe vendimet për zhvillimet me rëndësi për nivelin e Kosovës duhet të respektohen në tërësi,
- PZHU duhet të jetë i bazuar në PZHK dhe vendimet për zhvillimet me rëndësi për nivelin Komunal duhet të respektohen në tërësi.
- PZHU do të jetë plan bazë për çfarëdo plani rregullues që do të hartohet për zonat urbane. Planet rregulluese nuk duhet të cenojnë dispozitat e PZHU.
- Nëse ndonjë pjesë e planit rregullues urbane nuk është në harmoni me PZHU, duhet rishikim adekuat dhe miratim në Asamblenë Komunale.



## 5.2 KUSHTE TE PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TE RËNDËSISHME PER ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NE ZONA URBANE

### 5.2.1 Kushtet për përcaktimin dhe përkufizimin e sipërfaqeve publike si dhe atyre me destinime tjera

Hapësirë publike do të duhej të definohej bregu përgjatë lumit, ai do të duhej të zbulohet pasi që këtë veprim e ka konfirmuar edhe plani rregullues ekzistues për rregullimin e shtratit të lumit i cili është aprovuar nga Asambleja Komunale.

Ne çdo vendbanim ekzistues, me theks në vendbanime joformale, nevoja dhe mundësia e vendosjes së përmbajtjeve publike sikur janë fushëlojat, zonat e gjelbëruara, tregjet, hapësirat sportive dhe hapësira për parkim do të mbështeten me plane rregulluese. Ne këto vendbanime ku hartimi i PRRU është prioritet, ky vlerësim do të jetë pjesë e procesit të hartimit të këtyre planeve.

Ne zonat e reja të planifikuara për zhvillimin e banimit, rezervimi i hapësirës publike do të jetë udhëzimi kryesor në planifikim.

Përmes këtij riorganizimi dhe planifikimi të lagjeve duhet të rritet përqindja e gjelbërimit. Ekziston edhe mundësia e mbjelljes së drunjtëve dekorativ në të gjitha rrugët e qytetit.

### 5.2.2 Kushtet për rregullimin e hapësirës për objekte me rendësi për Kosovën dhe Komunën

Ndërtimi do të jetë i lejuar vetëm në zonat e destinuar për ndërtim të përcaktuara me PZHU.

- Zhvillimi në Gjilan të rregullohet me Plane Rregulluese Urbane
- Infrastruktura publike do të ofrohet vetëm në zonat e destinuar për ndërtim. Në zonat ku Planet Rregulluese Urbane nuk janë të miratuara, duhet zbatuar hulumtimin për kërkesat, mundësitë dhe ofrimin e infrastrukturës.
- Zhvillimet në hapësirën e lirë (gishtërinjtë) duhet bazuar në rregullat mjedisore për mbrojtjen e natyrës. Në mungesë të planit rregullues urban, komuna duhet të nxjerrë udhëzimet përkatëse të karakterit obligues.
- Në zonat ku zhvillimi është i lejuar, kushtet e lokacionin duhet të përcaktojnë me sa vijon:



- a. Formën dhe madhësinë e zonës së zhvillimit;
- b. Mënyrën e shfrytëzimit apo përdorimit e autorizuar për ngastrën tokësore;
- c. Rregullat e ndërtimit dhe distancën në mes të ndërtesave në ngastër;
- d. Rregullat për kyçje të ndërtesës në rrjetin e infrastrukturës;
- e. Masat për mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.
- f. Përgatitja e lokacionit si: largimi i ndërtesave dhe rehabilitimi i dheut (tokës), hulumtimet gjeo-mekanike të dheut.

### 5.2.3 Kushtet për vendosjen e objekteve të veprimtarive ekonomike

Komuna do të alokoj tokë të mjaftueshme që të përkrahë zhvillimin e biznesit i cili është i bazuar në shfrytëzimin e fuqisë punëtore vendore.

Komuna do të përkrahë themelimin e Këshillit Komunal për Zhvillim për ofrimin e hapësirës për zhvillim ekonomik, lokacion të biznesit dhe menaxhim.

#### Këshilli Komunal për Zhvillim

Një parakusht tjetër për implementimin e suksesshëm të këtij plani është një këshill komunal i cili do të udhëheqë një numër të projekteve zhvillimore. Ata këtë mund ta bëjnë përmes dhënies së tokës në shfrytëzim, me ndërtimin e rrugëve dhe infrastrukturës tjetër dhe me krijimin e kushteve më të mira për shitjen e parcelave individëve privat dhe biznesit.

Ky Këshill gjithashtu do ta bënte ndërlidhjen planeve dhe programeve zhvillimore Evropiane dhe të Qeverisë qendrore me qëllim të thithjes së investimeve dhe donacioneve të ndryshme të dedikuara për zhvillim në nivele të ndryshme organizative.

Gjithashtu, Këshilli do ta organizonte informimin dhe këshillimin e investuesve privat gjatë promovimit të partneritetit privat/shoqëror.

Aktivitetet ekonomike-tregtare dhe ato të industrisë së lehtë jo shqetësuese deri në 1500m<sup>2</sup> do të lejohen edhe në zonat banuese-mikse në pjesën urbane.



### Zonat komerciale/industriale

Zonat komerciale dhe industriale sigurojnë hapësirë për të gjitha llojet e çështjeve komerciale, kryesisht përdorimet që nuk janë të lejuara në zonat tjera. Janë paraparë përdorimet si në vijim:

1. Të gjitha llojet e ndërmarrjeve komerciale dhe industriale, ndërtesat e dyqaneve, depot dhe ndërmarrjet publike,
2. Biznes, zyra dhe administratë,
3. Pompat e karburantit,
4. Pajisje sportive.

Përdorimet në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

1. Objekte për fenë, kulturën, pajisjet sociale dhe kujdesit shëndetësorë,
2. Banimin për stafin mbikëqyrës, menaxherët ose pronarët e prodhimeve
3. Objektet e ndërmarrjeve.

#### 5.2.4 Kushtet për vendosjen e objekteve te veprimtarive publike

- Themelimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i shërbimeve ekzistuese publike për qytetin e Gjilanit do të jenë të përqendruara në zonën urbane.
- Plani Zhvillimor Urban duhet të siguroj tokë rezervë për kërkesa të veçanta (banimi për të moshuarit, institucionet për persona me aftësi të kufizuara, jetimore etj.), dhe zgjerimin e zonave të aktivitetit publik në përputhej me funksionin e Vendbanimit.
- Komuna duhet të siguroj hapësirë për shkolla të reja dhe institucione parashkollore. Ato duhet rregulluar me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik.
- Komuna mund të siguroj një ngastër të përbashkët për ndërtimin e një objekti me destinim për: edukimi, kultura, shëndetësia dhe shërbimet sociale, qendra të komunitetit.
- Zonat e destinuar për sporte dhe rekreacion duhet të jone të furnizuara me shtigje , infrastrukturë dhe gjelbërim. Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane që shërbejnë pajisje sportive rekreative.



### 5.2.5 Kushtet dhe mënyra e ndërtimit të objekteve të banimit

Dendësimi në vendbanimet ekzistuese, pas përcaktimit të hapësirës për fushëloja, hapësirave publike dhe parkingjeve do të jetë i stimuluar. Në këto zona ku hartimi i PRrU është prioritet, një vlerësim i mundësive për dendësim do të përfshihet në procesin e hartimit të këtyre planeve. Shumica e zonave të banimit kryesisht sigurojnë hapësirë për banim. Në këto zona janë paraparë përdorimet si në vijim:

4. Ndërtesat për banim,
5. Furnizimi i zonave të nevojshme për tregti me pakicë, të furnizimit të ushqimit, dhe përdorimet komerciale jo shqetësuese,
6. Objekte për fenë, kulturën, pajisjet sociale të kujdesit shëndetësorë, dhe çështje sportive,

Përdorimet si në vijim janë paraparë vetëm në raste të veçanta:

6. Tregtia e akomodimit ,
7. Përdorimet tjera jo shqetësuese komerciale,
8. Ndërtesat për administratë,
9. Ndërmarrjet kopshtare,
10. Pompat e karburantit.

### 5.2.6 Kushtet për përcaktimin e rrjetit të sipërfaqeve të korridoreve apo trasave telekomunikuese dhe rrjetit të infrastrukturës urbane

- Gjatë definimit të zonave të ndërtimit, duhet të dëshmohet se është shmangur kostoja e lartë për ndërtim dhe mirëmbajtje. Ndërtimi duhet të respektojë rregulloret për ndërtim të qëndrueshëm – orientimi, kushtet klimatike etj.
- Koncepti detal i mobilitetit, përfshirë edhe transportin publik, trafikun për këmbësor dhe trafikun çiklistë duhet të elaborohet më tutje me plane detale dhe plane rregulluese.
- Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve duhet të shmangen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.
- Qasjet direkt në rrugët kryesore nuk do të lejohen.
- Të gjitha rrugët duhet të dimensionohen në mënyre që të lejojnë rrjedhë të sigurt të komunikacionit për të gjitha automjetet në çfarëdo kushte atmosferike. Shtigjet e këmbësorëve duhet të respektojnë



rregulloret ekzistuese. Shtigjet duhet të jenë të gjera më së paku 2.0m'. Aty ku ka barriera fizike, shtigjet mund të ngushtohen.

- Te gjitha udhëkryqet duhet të sigurojnë pamje në të gjitha drejtimet.
- Shtigjet për çiklistë të një drejtimi duhet të jenë 0,9m' të gjëra.
- Në zonat për parkim që shërbejnë për transportin publik, shtegu i ndaljeve të autobusëve duhet të jetë 2.0m' i gjerë.
- Standardet për parkim do të përcaktohen me rregullore të dala nga planet e veçanta rregulluese

### 5.2.7 Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlerë të veçante

Do të rregullohen me Plane Hapësinore për zona të veçanta

### 5.2.8 Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike

- Duhet bërë përzgjedhjen e elementeve të trashëgimisë kulturore të cilat duhet mbrojtur, dhe duhet miratuar rregullore përkatëse.
- Asnjë ndërtim nuk do të lejohet në zonat të cilat në PZHU janë të përcaktuara si zona të gjelbërimit.
- Prera e drunjtëve nuk do të lejohet përderisa nuk të mbjellën fidanët e rinj si zëvendësim për ta. Në zona të caktuara ku ekziston rreziku nga erozioni, prerja e drunjtëve do të ndalohej.

### 5.2.9 Mënyra e trajtimit të hedhurinave (përpunimi, deponimi dhe bartja)

Po të ndalohej ndotja e mjedisit nga hedhja e mbeturinave, nëse mbledhja (vendosja ilegale dhe e paautorizuar e mbeturinave) do të vazhdon të mbështetet mirë nga një sistem funksional dhe organizim i mirë i grumbullimit të tyre, mjedisi do të ruhet dhe një proces i tillë i grumbullimit të mbeturinave do të zgjerohet në të gjitha pjesët e komunës. Kjo do të ndikoj gjithashtu në ngritjen e vetëdijesimit të popullsisë në lidhje me rrezikun për jetesë nga hedhja e mbeturinave dhe ta inkurajoj kontrollin shoqërorë.

Momentalisht, mbeturinat janë grumbulluar në pjesë të mëdha të Kosovës jugore dhe janë transportuar në deponon rajonale në Gjilan, ku mbeturinat ruhen pa asnjë trajtim të mëtutjeshëm. Në të ardhmen, kur të rregullohet menaxhimi i mbeturinave nga rregulloret e BE-së, mbeturinat



do të digjen dhe vetëm hiri do të depozitohet. Vetëm disa deponi të tilla për djegien e mbeturinave do të jenë të nevojshme në tërë Kosovën, dhe me sa duket ato do të ndërtohen në kombinim me deponit rajonale të sotme. Një zgjerim i deponisë ekzistuese të Gjilanit megjithatë mund të pritët.

Prioriteti i parë për menaxhimin e mbeturinave ka si imperativ formimin e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave i cili duhet të zgjerohet në tërë komunën dhe të pastrohen pjesët e depozitimit ilegal të mbeturinave. Në hapin e dytë, pajisjet dhe metodat e deponive ekzistuese duhet të adoptohen me standardet e BE.

#### 5.2.10 Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis

- Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.
- Projektet Zhvillimore në shkallë prej 5 hektarëve duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë ndikime negative në mjedis.
- Gjatë dhënies së lejeve për planifikim për objekte zhvillimore ekonomike, nëse është e nevojshme, në pajtim me rregullat mjedisore, të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis si ndotja e ajrit dhe zhurma, vibrimet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese.

#### 5.2.11 Masat për parandalimin e ndikimit negativ social

- Trajtimi i Vendbanimeve Joformale,
- Zgjidhja e problemeve të ndërtimeve pa leje,
- Sigurimi social dhe shëndetësorë.

#### 5.2.12 Masat për zbatimin e planit

##### 5.2.12.a Detyrimi për hartimin e planeve detale rregulluese

Plani Zhvillimor Urban duhet të revidohet çdo 5 vite, ndërsa rishikimi i tij duhet të bëhet çdo 2 vite.

Ndonëse hartimi i PRrU duhet të mbulon tërë territorin urban, është e qartë se prioritet duhet ti jepet për ato zona ku problemet hapësinore janë të asaj natyre që duhet reaguar me shpejtësi.





Posaçërisht zonat si në vijim:

- Për zona të cilat konsiderohen vendbanime joformale, që në vete kanë ndërtime me një status të paqarte,
- Zonat të cilat me ndërtimet e veta nuk janë në pajtim me PGJU (I cili është ende në fuqi dhe vetëm pjesërisht i aplikueshëm), mirëpo të cilat nuk janë në konflikt me PZHU,
- Aty ku ridizajnimi dhe rekonstruimi i hapësirës publike kërkon zgjidhje të shpejt.

#### 5.2.12.b Masat për rregullimin dhe mbrojtjen e tokave

- Ndërtesat ekzistuese në zonat e gjelbra nuk duhet të rriten.
- Problemet specifike në lidhje me vendbanimet joformale do të vlerësohen dhe do të propozohen zgjidhje sipas direktivave IPH dhe DPH. Prandaj duhet të krijohet një bazë e të dhënave me informata detale për çdo ndërtesë.
- Rrënimi i ndërtesave mund të konsiderohet në ato raste ku ndërtimet ilegale nuk mund të legalizohen sipas Ligjit mbi ndërtimet ilegale.
- Komuna do të ofrojë një lokacion për ndërtimin e shtëpive të reja për njerëzit që duhen të lëshojnë shtëpitë e tyre në rast të rrënimëve. Gjatë zbatimit të planit nëse kërkohet, ndërtesat e ndërtuara legale mund të largohen pas shpronësimit apo marrëveshjes me pronarin. Në këtë rast komuna duhet të ofrojë kompensim të mirëfilltë.

### 5.3 DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN

#### *Përmirësimi i pjesëmarrjes, përfshirjes dhe vetëdijesimit*

Jetësimi dhe zbatimi i PZHK dhe PRU-ve është i mundshëm vetëm atëherë kur komuna krijon përkrahje dhe besim të qytetarëve për këto aktivitete, besim i cili do të arrihet me kontakte të drejtpërdrejta dhe fushata mediale me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve.

#### *Centralizimi i informatave hapësinore*

Shënimet dhe informatat duhet të centralizohen në një sistem të GIS-it.



### *Lejet e ndërtimit*

Lejet e ndërtimit duhet të qartësohen si procedura dhe të përmirësohen. Baza e të dhënave dhe sistemi i GIS-it duhet ti asistojnë kësaj procedure.

### *Monitorimi dhe Rishikimi*

Gjiçani-si edhe shumë komuna tjera në Kosovë – e ka eksperiencën e zhvillimit dinamik socio-ekonomik. Si rrjedhojë, nevojat për tokë ndërtimore dhe furnizim të infrastrukturës mund të ndryshojnë në mënyrë të papritur. Për këtë arsye, është e nevojshme që të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme zhvillimi i komunës – nëse është e nevojshme – të rishikohet përmbajtja e PZHK së paku njëherë në 2 vite. Rishikimi i tërësishëm i planit bëhet pas pesë vitesh.

### *Mandati i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit*

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18). Neni 5.1 i Rregullores 2005/18 përkufizon se “Agjencia duhet të ketë kompetenca t’i administroj Ndërmarrjet në pronësi Publike dhe Ndërmarrjet në pronësi Shoqërore të regjistruara në Kosovë që nga 31 dhjetori 1988 apo ndonjë date pasuese (pavarësisht a i është nënshtruar Ndërmarrja Transformimit apo jo)”. Ne bazë të kësaj Rregulloreje, prona të shumta në komunën e Gjiçanit, bien nën mandatin e AKM-së. Patundshmëria urbane dhe bujqësore e natyrës Publike ose Shoqërore nën mandatin e AKM-së mbase paraqet një përqindje të konsiderueshme.

Ne mes të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe AKM-së është akorduar e ashtuquajtura “procedura për shkëmbimin e tokave”, në lidhje me kërkesat komunale për të siguruar pronë shoqërore për projektet “te interesit të përgjithshëm”. Kjo politike kërkon që kërkesat të vlerësohen “rast për rast”, ku Ndërmarrja ne Pronësi Shoqërore do të kompensohet në mënyrë të duhur për cilëndo prone të tyre që do ti transferohet komunës

## 5.4 DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E ZBATIMIT

### *Buxheti i shpenzimeve komunale bazuar në PZHK dhe PZHU*

Planifikimi i investimeve komunale, posaçërisht ato me komponentë hapësinore (përfshirë aktivitetet e planifikimit, punëve publike, shpërndarjen e shërbimeve publike, banimi dhe ndërtimi tjetër), do të realizohet në përputhje me veprimet e theksuara në të dy planet PZHK



dhe PZHU.

Tre muaj pas miratimit të dy planeve (PZHK dhe PZHU), Asambleja Komunale do të miratoj planin e buxhetit me të cilin do ceket qartë se si do të financohet zbatimi i të dy planeve për se paku tri vitet e para. Ky plan shtesë i buxhetit do të definoj mes tjerash se si do të hartohen PRRU-të, se si do të zbatohen hulumtimet e domosdoshme dhe si do të financohet hartimi i dokumenteve politike zhvillimore sikur janë të përcaktuara me plane zhvillimore.

#### *Sigurimi i përputhshmërisë me dokumentet ekzistues politike*

Tre muaj pas miratimit të dy planeve (PZHK dhe PZHU), komuna duhet të rishikoj politikat sektoriale në mënyrë që ato të jenë në harmoni me dispozitat e PZHK dhe PZHU.

### 5.5 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TE MËTUTJESHËM

Planet dhe politikat që duhet hartuar:

1. Plani i politikave mjedisore, në veçanti mbrojtja e ujërave, pyjeve dhe tokës bujqësore,
2. Plani i infrastrukturës teknike,
3. Politikat e mobilitetit
4. Hulumtimi i energjisë për ngrohje,
5. Studimi i fizibilitetit të kalimit të hekurudhës përmes qytetit nën tokë,
6. Zonat arkeologjike
7. Studimi i mundësive dhe i një furnizimi të qëndrueshëm me ujë të pijes
8. Eko-Prodhimet.



## **Referencat:**

European Commission and International Management Group (EU/IMG):

**Damage Assessment Kosovo.** Assessment of Damaged Housing and Local / village Infrastructure in Kosovo. July 1999

Raportet Sektoriale

- Administratë Komunale
- Kulturë, Rini dhe Sport
- Buxhet, Financa dhe Investime
- Arsim
- Shërbime Publike
- Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient
- Ekonomi dhe Menaxhment
- Shëndetësi dhe Çështje Sociale
- Siguri dhe Emergjencë
- Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi
- Bujqësi dhe Pylltari
- Zyra për Komunitete Lokale

European Commission Damage Assessment Kosovo / International Management Group (EU/IMG):

**Building Assessment.** Municipality: Gjilan / Prishtine. IMG Kosovo, April 2000

Raportet e Grupeve punuese

- Demografia dhe Çështjet Sociale
- Zhvillimi Ekonomik
- Mjedis dhe Shfrytëzimi i Tokës
- Infrastruktura

Federal Republic of Yugoslavia (FRY) / Federal Statistical Office (FSO) / Savezna Republika Jugoslavija / Savezni Zavod za Statistiku:

**Popis '91 Stanownischtwo.** Belgrad 1993

Government of Kosovo:

**The Kosovo General Government 2003 Budget.** Prishtina 2003

Government of Kosovo:

**The new Kosovo Government. 2002 Budget.** Prishtina 2002

International Monetary Fund:

**Kosovo. Institutions and Policies for Reconstruction and Growth.** Prepared by Dimitri G. Demekas, Johannes Herderschee, Davina F. Jacobs, 2002

International Organisation for Migration / IOM:

**Kosovo. Demographic, socio-economic and reproductive health survey.** Basic Results. May 2000



Ministry of Environment and Spatial Planning / Department of Spatial Planning:

**Report on present situation in urban management and planning in municipalities of Kosovo.** Prepared by: Municipalities, Road Directorate, Kosovo Cadastral Agency, Urban Institutions, Kosovo Statistical Office and Institute for the Protection of Monuments, 2002

Ministry of Environment and Spatial Planning (MESP) / Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor (MMPH):

**Kosovo State of the Environment** / Raport Mbi gjendjen ambientale në Kosovë April / Prill 2003

Ministry of Environment and Spatial Planning / Department of Housing and Construction / Reconstruction Section:

**Kosovo Profile. Kosovo Spatial Development.** Working document. Prishtina June 2004

Ministry of Environment and Spatial Planning / Institute for Spatial Planning:

**Report on present situation in urban management and planning in municipalities of Kosovo.** Prepared by: Municipalities, Road Directorate, Kosovo Cadastral Agency, Urban Institutions, Kosovo Statistical Office and Institute for the Protection of Monuments, 2002

Ministry of Health, Provisional Self-Government of Kosovo:

**Demographic Transition and Health Insurance in Kosovo.** Report prepared by Manoj Mohanan, Harvard School of Public Health Boston MA; Prishtina 2003

National Board of Housing, Building and Planning, Sweden; Ministry for Regional Development of the Czech Republic, editors:

**Housing Statistics in the European Union 2004**

Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce) and UNHCR:

**Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo** (October 2000 to February 2001) OSCE Mission Fact sheet March 2001

Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce) and UNHCR:

**Ninth Assessment of the Situation of Ethnic Minorities in Kosovo** (Period covering September 2001 to April 2002) 27 May 2002,  
[http://www.osce.org/documents/mik/2002/05/1110\\_en.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2002/05/1110_en.pdf) Prishtina 2002

Organization for Security and Co-Operation in Europe (osce):

**Municipal Profile Gjilan / Gnjilane.** November 2005

Osmani, Dr. Jusuf

**Kosova dwellings 6 Gjilani,** Prishtina 2004

RIINVEST:

**Post-War Reconstruction of Kosova. Strategy and Policies.** Prishtina, March 2000

RIINVEST:

**Labour Market and Unemployment in Kosova.** Prishtina, January 2003



Simpson, David; and Bajram Maxhuni:

**Kosovo Health Profile**. Supported by DFID, UNICEF and Open Society Institute, June 2003

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Kosovo and its Population. A brief description**. 5th Version, June.2003

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Kosovo Demographic and Health Survey 2003**. Preliminary results. Draft chapters, [http://www.sok-kosovo.org/publications/dhs\\_2003.htm](http://www.sok-kosovo.org/publications/dhs_2003.htm); April 2004.

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Kosovo Labour Force Survey 2001**. Methodological report. August 2002

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Labour Market Statistics 2004**. Series 5: Social Statistics. Prishtina 2005

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Vital statistics of Kosovo 2002 - 2003**. Bulletin Number 3. Prishtina 2004 / Statistikat Vitale të Kosovës 2002 - 2003. Buletini Numër 3. Prishtinë 2004

Statistical Office of Kosovo (SOK):

**Vital statistics of 2004**. Bulletin Number 4. Prishtina 2005 / Statistikat Vitale të Kosovës për Vitin 2004. Buletini Numër 4. Prishtinë 2005

Statistical Office of Kosovo (SOK); United Nations Population Fund (UNFPA) and International Organization for Migrations (IOM):

**Demographic, social, economic situation and reproductive health in Kosovo following the 1999 conflict**. Results of a household survey November 1999 – February 2000. Report prepared by Chantal Blayo, Christophe Bergouignan, Marine Llopart, Nicodème Okobo and Nancy Stiegler, Institute of Demographic Studies of the University Montesquieu – Bordeaux IV (IEDUB), France, January 2001

United Nations Development Programme (UNDP):

**The Kosovo Mosaic: Perceptions of local government and public services in Kosovo**; results of the "Local Authorities and Public Services Survey"; study performed by Index Kosova and BBSS Gallup International; Prishtina 2003;

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK): Energy sector.

Technical assistance project (ESTAP) Kosovo. World Bank Grant No. TF-027791 Module A

**Electricity Demand** (Draft Report: V3b). Supported by: CESI, EIW, Ramboll, RE; pp. 22 ff. Demographic Analysis; Prishtina, April 2002

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK):

**Energy Sector. Technical assistance project / ESTAP** World Bank Grant No. TF-027791. Supported by CESI, EIW, Ramboll, RE; **Executive Summary. Final Report**; pp. 14 ff.: Demographic Development; [http://www.ks.gov.net/mem/pdf/estap1/Executive\\_Summary.pdf](http://www.ks.gov.net/mem/pdf/estap1/Executive_Summary.pdf); Prishtina, September 2002

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK):

**Fact Sheet Kosovo**, 2002



United Nations, Development Programme (UNDP):

**Human Development Report Kosovo 2004.** The Rise of the Citizen: Challenges and Choices. Core team of writers: Mytaher Haskuka, Leon Malazogu, Nita Luci, Ilir Dugolli; Prishtina 2004

World Bank:

**Kosovo, Poverty Assessment.** (In two volumes) Volume I: Main report; Volume 2; Based on Living Standard Measurement Survey / LSMS 2001; December 20, 2001

World Bank:

**Kosovo, Labor Market Study: Policy Challenges of Formal and Informal Employment.** Human Development Unit Europe and Central Asia Region. June 2003